



MANUAL

• • • • •

LIGJI I RI PËR NDIHMËN JURIDIKE





EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

DEUTSCHE STIFTUNG FÜR
INTERNATIONALE RECHTLICHE
ZUSAMMENARBEIT E.V.



Projekt i zbatuar nga:



MANUAL

LIGJI I RI PËR NDIHMËN JURIDIKE

Janar 2021

Design & Layout: Adelajda Alla
Shtypur në shtypshkronjën MORAVA

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Opinionet e shprehura në këtë Manual janë opinione të ekspertëve të Misionit EURALIUS, të mbështetura në praktikat më të mira të Shteteve Anëtare të BE-së/acquis-në e BE-së/të drejtën europiane dhe ndërkombëtare/praktikën gjyqësore të GJEDNJ/ose standardet e tjera referencë. Ai përmban konsiderata dhe rekomandime për vëmendjen e grupeve të interesit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të interpretohet si udhëheqës në vendimmarrjen e pavarur dhe autonome të autoriteteve shqiptare.

Manuali parashikon edhe një publikim jozyrtar të akteve ligjore në lidhje me ndihmën juridike. Publikimi ka vetëm qëllime informuese. Ai nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk parashikon asnjë detyrim tjetër përveç atyre të dhëna apo të parashikuara nga legjislati i miratuar dhe publikuar zyrtarisht në gjuhën shqipe. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe heq dorë nga përgjegjësia për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit në vijim.

EURALIUS
Ministria e Drejtësisë
Blvd Zogu I-rë
Tiranë
E-mail: info@euralius.eu
Web: www.euralius.eu

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
Rr. Barrikadave, Nd. 18
Hyrja 6, Zyra nr. 10 - III
Tiranë
dnjf@drejtesia.gov.al
www.ndihmajuridike.gov.al

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie	5
I. Hyrje	11
II. Kuadri ligjor	14
III. Institucionet e përfshira	23
IV. Kriteret e Ndhmës Juridike	28
V. Ndhma Juridike Parësore.....	38
VI. Ndhma Juridike në Procedurat Gjyqësore: Ndhma Juridike Dytësore dhe Përrjashtimi nga Shpenzimet Gjyqësore dhe Tarifat Gjyqësore.....	43
VII. Përrjashtimi nga Tarifat dhe Shpenzimet e Gjykatës.....	81
VIII. Rimbursimi	86
Aneks 1	
Ligj Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti	90
Aneks 2	
Udhëzim nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” ...	114
Aneks 3	
Udhëzim nr. 1, date 06.03.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”	117
Aneks 4	
Vendim nr. 55, date 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”	118
Aneks 5	
Udhëzim nr. 1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”	122

Udhëzim nr. 2 25.03.2019	Aneks 6 Udhëzim nr. 2, datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”126
Urdhër nr. 59 25.03.2019	Aneks 7 Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së ndihmës juridike falas”128
Urdhër nr. 225 25.03.2019	Aneks 8 Urdhër nr. 225, datë 25.03.2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”131
Urdhër nr. 226 25.03.2019	Aneks 9 Urdhër nr. 226, datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”165
Udhëzim nr. 6 20.08.2019	Aneks 10 Udhëzim nr. 6, datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtim në rastin e dhënies së ndihmës juridike”177
Vendim nr. 231 12.11.2019	Aneks 11 Vendim nr. 231, datë 12.11.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”179
Urdhër nr. 531 25.11.2019	Aneks 12 Urdhër nr.531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga drejtoria e ndihmës juridike falas të shërbimeve të ndihmës juridike”192
Vendim nr. 110 06.03.2020	Aneks 13 Vendim nr. 110, date 06.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”243
Udhëzim nr. 17 05.08.2020	Aneks 14 Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”249
Udhëzim nr. 18 05.08.2020	Aneks 15 Udhëzim i përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”256

PARATHËNIE

Garantimi i aksesit në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike falas

Reforma në drejtësi dhe ndryshimet ligjore që u ndërморën në këtë kuadër kanë pasur në fokus garantimin e të drejtës së aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë, veçanërisht me fokusin tek qytetarët në nevojë dhe kategoritë e veçanta të përfituesve të parashikuara në ligj.

Kjo riafirmoi angazhimin e Shtetit Shqiptar dhe Ministrisë së Drejtësisë për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për një sistem të ndihmës juridike të drejtë, transparent dhe eficient.

Aksesi në sistemin e drejtësisë është një parim themelor i shtetit të së drejtës. Në mungesë të tij, qytetarët nuk janë në gjendje të përcjellin zërin e tyre, të ushtrojnë të drejtat, të sfidojnë diskriminimin dhe të bëjnë përgjegjës vendimmarrësit.

Në vlerësim të rëndësisë së aksesit në drejtësi, Ministria e Drejtësisë e ka prioritetuar këtë të drejtë të garantuar si në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar, por edhe në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, duke u angazhuar maksimalisht me qëllim zbatimin në praktikë dhe në mënyrë efektive të kësaj të drejte.

Tashmë qytetarët mund të drejtohen gjykatës, institucioneve të administratës publike, të përjashtohen nga tarifat apo nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor dhe të kenë mundësi të përfitojnë shërbime jo-diskriminuese, dhe gjithëpërfshirëse të cilat promovojnë aksesin në drejtësi, si dhe orientojnë fokusin tek qytetari.

Këto janë fillesat e objektivave që kemi si qeveri për sa i përket aksesit në drejtësi, të cilat fokusohen në zbatimin e ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti nga të gjithë aktorët, në zgjerimin e shërbimeve

të ndihmës juridike parësore në të gjithë Shqipërinë dhe specializimin e avokatëve ofrues të ndihmës juridike dytësore.

Një tjetër risi e sjellë nga ky ligj është krijimi i një rrjeti institucional të cilët ngarkohen me përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike për secilën formë të ndihmës juridike, përmendim këtu ndihmën juridike parësore, dytësore, përjashtimin nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor deri në ekzekutimin e vendimit.

Fokusi dhe prioriteti aktual qëndron në dhënien e një shërbimi ligjor cilësor dhe efektiv, duke synuar që parimi i barazisë së armëve midis palëve të garantohet efektivisht jo vetëm në formë por dhe përmbajtje. Ky objektiv shihet ngushtësisht i lidhur me një tjetër komponent shumë të rëndësishëm të ofrimit të ndihmës juridike falas që është cilësia dhe mbikqyrja e këtij shërbimi. Garantimi dhe ofrimi i shërbimit, rastet e trajtuara, cilësia dhe profesionalizmi që shoqëron këto shërbime janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit

Instrumentet e mësipërme kanë për qëllim dhe në fokus shërbimin kundrejt qytetarëve por njëkohësisht na shërben edhe ne për të përmirësuar institucionin tonë, mjetet ligjore dhe me një qëllim final, sistemin e drejtësisë.

Në këtë fjalë të shkurtër, gjej rastin të falënderoj të gjithë aktorët e përfshirë me mbështetjen e pakursyer të të cilëve ja kemi dalë mbanë të garantojmë shërbime ligjore falas për të gjithë qytetarët në nevojë. Një falënderim i veçantë i kushtohet Misionit të EURALIUS V për publikimin e këtij manuali i cili do të jetë padyshim një vlerë e shtuar për të gjithë praktikuesit e ligjit.

Me bindjen dhe besimin se të gjithë aktorët e përfshirë do të vijojnë bashkëpunimin me të njëjtën energji dhe përkushtim, iu uroj punë të mbarë në këtë mision të rëndësishëm!

Znj. Etilda Gjonaj (Saliu), Ministre e Drejtësisë

Të dashur lexues,

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi kushtetues qeverisës i sistemit gjyqësor, ka përgjegjësinë kushtetuese dhe morale për të garantuar të drejtën e individëve për të pasur akses në gjykata të pavarura, eficiente dhe të paanshme.

Këshilli vlerëson se ndihma juridike falas dhe garantimi i saj nga shteti, është një nga mekanizmat lehtësues për të rritur aksesin në drejtësi. Kjo veçanërisht për grupet në nevojë, të cilat nuk kanë mundësi financiare për të paguar tarifatat gjyqësore pranë gjykatave dhe njëkohësisht për të mundësuar këshillim dhe mbrojtje ligjore efektive.

Decentralizimi i skemës së ofrimit të ndihmës juridike falas, përmes përfshirjes së gjykatave në këtë proces, krijoi premisa për një rritje të aksesit në drejtësi të qytetarëve. Megjithatë, një premisë e tillë nuk do ishte e mundur pa ndërveprimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, që formësojnë mozaikun e skemës së ndihmës juridike falas.

Një bashkëpunim të tillë, kam kënaqësinë ta shoh të materializuar në hartimin e Manualit të Ndhmës Juridike Falas, që publikojmë sot! Manuali ofron një përmbledhje të sistemit të ndihmës juridike falas, kornizën ligjore dhe institucionet e përfshira. Me qëllimin për të qënë një produkt praktik, i cili i vjen në ndihmë praktikuesve të ligjit, manuali përshkruan të gjithë hapat procedural që kërkohen të ndërmerren në procedurat gjyqësore në lidhje me garantimin e ndihmës juridike falas.

Përmes kësaj parathënie, gjej rastin, të falenderoj Misionin e Euralius V, Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, të cilët kanë dëshmuar vazhdimisht për një frymë positive bashkëpunuese në kuadër të garantimit të aksesit të publikut në drejtësi.

Rruga jonë e përbashkët është e gjatë, por falë angazhimit reciprok, përgjegjshmërisë morale e profesionale dhe bashkëpunimit të pa

kursyer, jam e bindur që kjo rrugë do të na orientojë më pranë nevojave të qytetarëve. Shërbimet gjyqësore janë shërbime publike dhe si të tilla ato duhet të garantohen për të gjithë qytetarët, pa dallim, duke siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës, ku liritë dhe të drejtat e njeriut janë kryefjala!

Ju uroj një lexim të këndshëm.

Znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të dashur lexues,

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, si institucioni i dedikuar mirëadministrimit dhe mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, ka përgjegjësinë të garantojë akses të barabartë në drejtësi përmes shërbimeve ligjore falas.

Me inicimin e Reformës në Drejtësi, një reformë e thellë që preku në tërësi çdo element të sistemit të drejtësisë, pati edhe një reformim të thellë të sistemit të ndihmës juridike falas, duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Tashmë, është detyrë e institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike për të siguruar implementimin efektiv në praktikë të këtij ligji, por mbi të gjitha e punonjësve dhe avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike, të cilët duhet të mbajnë në konsideratë që misioni i tyre përveçse i karakterit profesional mbi të gjitha është një mision moral dhe humanitar.

Publikimi i këtij manuali sot, është fryt i një pune të madhe dhe një bashkëpunimi i cili ka nisur që prej fillimit të funksionimit të drejtorisë. Manuali ofron një përmbledhje mbi mënyrën si funksionon dhe është i strukturuar sistemi i ndihmës juridike, legjislacioni në fuqi dhe të gjithë aktorët e përfshirë në këtë sistem. Qëllimi i këtij manuali është përdorimi i gjerë në praktikë nga të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e ndihmës juridike por edhe nga të gjithë praktikantët e ligjit. Manuali shërben si një udhëzues që analizon në detaj kuadrin ligjor dhe pasqyron aspekte të ndryshme të zbatimit në praktikë.

Përmes kësaj parathënie, gjej rastin të falenderoj Misionin e Euralius V, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor por edhe Gjykatat me të cilat Drejtoria ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi, si bashkëpunëtorë dhe mbështetës të fortë në përmbushjen e misionit të përbashkët të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi përmes shërbimeve ligjore falas.

Jam i bindur se jemi tashmë në rrugën e duhur në përmbushje të qëllimit dhe misionit tonë të përbashkët.

Të gjithë bashkë, mund të jemi sa më afër qytetarëve në nevojë dhe grupeve vulnerabël!

Ju uroj një lexim të këndshëm.

**Z. Ergys Qirici, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike
Falas**

I. Hyrje

1. Vështrim i përgjithshëm

Ligji nr. 111/2017 për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti (Ligji për Ndhimën Juridike) hyri në fuqi më 1 qershor 2018.¹ Ai parashikon një **sistem gjithëpërfshirës të**

- Ndhimës Juridike Parësore (“mbështetje jashtë gjyqësore”)
- Ndhimës Juridike Dytësore (përfaqësimi nga një avokat në procedurën gjyqësore), dhe
- Përrjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore.

Ligji për Ndhimën Juridike realizohet me anë të një sërë **Aktesh nënligjore**.

Dispozita të rëndësishme në lidhje me zbatimin e Ligjit për Ndhimën Juridike mund të gjenden gjithashtu në një sërë **ligjesh të tjera**.

Qëllimi i këtij manuali është t’u ofrojë ofruesve dhe përdoruesve të **ndihmës juridike një përmbledhje të parë sistematike** mbi sistemin e ri të ndihmës juridike dhe udhëzime për zbatimin praktik të sistemit të ri të ndihmës juridike.

Manuali përcakton ndër të tjera kornizën institucionale dhe legislative, kushtet për ndihmë juridike, tre llojet e ndihmës juridike, procedurën për të kërkuar dhe dhënë ndihmë juridike, duke përfshirë procedurat e ankimit, zgjedhjen dhe zëvendësimin e avokatit individual dhe rimbursimin. Kur është e nevojshme, manuali gjithashtu i referohet dispozitave përkatëse të ligjeve të tjera, siç janë Kodet për Procedurën Civile, Penale dhe Administrative. Zgjidhjet e mundshme praktike duhet të sigurohen për hapat dhe situatat më të zakonshme procedurale.

Meqenëse në disa situata, korniza ligjore nuk është plotësisht e qartë dhe lë hapësirë për interpretim, manuali për shumë situata mund të shtjellojë vetëm zgjidhje të mundshme, por jo të pretendojë të dalë me të vetmet zgjidhje të mundshme.

¹ Përderisa, në këtë pikë, dispozitat tranzitore (Neni 36, Ligji për Ndhimën Ligjore) nuk ka ndikim praktik, ato nuk do të përpunohen më tej.

2. Objekti i përgjithshëm i Ligjit për ndihmën juridike

Ligji për ndihmën juridike (Neni 1)² rregullon:

- **format, kushtet, procedurën dhe rregullat** për
- **organizimin dhe administrimin** e ndihmës juridike të garantuar nga shteti,
- me **qëllim** mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe interesave të tij legjitime.

3. Parimet (Neni 4)

Parimet janë (shkrimet fundore u referohen dispozitave specifike të Ligjit për Ndihmën Juridike ku zbatohen këto parime)

- Aksesi i barabartë
- Mos-diskriminimi
- Profesionalizmi dhe barazia³
- Efikasiteti dhe efektiviteti i kostos⁴
- Konfidencialiteti
- Mbrojtja e personave të pambrojtur⁵ dhe
- Shmangia e konfliktit të interesit⁶

4. Ndihma Juridike Dytësore

Kapitulli V trajton Ndihmën Juridike Dytësore. Kjo është, e thënë thjesht, **përfaqësimi i një personi për përgatitjen e një padie dhe më pas në procedurë gjyqësore** nga një avokat falas.

5. Përrjashtimi nga Shpenzimet dhe Tarifat Gjyqësore

Kapitulli VI rregullon përrjashtimin nga shpenzimet e tarifave gjyqësore. Personat mund të përrjashtohen nga detyrimi për të paguar Tarifave Gjyqësore dhe Shpenzimet Gjyqësore

2 Nenet me referencë të mëtejshme janë nenet e Ligjit për Ndihmën Juridike.

3 Zbatuar ndër të tjera me anë të Nenit 15 (2) (c) për OJQ-të, të cilat ofrojnë ndihmë juridike, Neni 24 (1) (c) për avokatët, trajnimin e avokatëve (Neni 9 (d) dhe për punonjës me trajnim të posaçëm (Neni 8 (g)), dhe mbikëqyrja, mbledhja e të dhënave, vlerësimi dhe gjykimi i cilësisë nga Drejtoria (Neni 8 (b), (d), (i), (ii), (o)).

4 Zbatuar ndër të tjera me anë të mundësisë për rimbursim (Kapitulli VII, Ligji për Ndihmën Ligjore) dhe Aktet Nënligjore për shpërblimin e avokatëve, ekspertëve dhe dëshmitarëve.

5 Shih Nenin 11 për kategori të caktuara përfituesish

6 Shih Nenin 17/5 për ndihmën juridike parësore dhe Nenin 24/5 për ndihmën dytësore

6. Ndhurma Juridike Parësore

Kapitulli IV parashikon institucione që ofrojnë, e thënë thjesht, **mbështetje juridike jashtëgjyqësore**

7. Burimet e informacionit

Formularët, Aktet nënligjore dhe OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore janë publikuar në faqet e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës së Avokatëve dhe Drejtorisë (Neni 35).

II. Kuadri ligjor

1. Vështrim i përgjithshëm

Ndihma Juridike rregullohet me **Ligjin për Ndihmën Juridike** dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

Këto burime ligjore megjithatë nuk i përfshijnë të gjitha aspektet. Për disa çështje zbatohet **korniza e përgjithshme juridike** (në disa dispozita Ligji për Ndihmën Juridike u referohet në mënyrë të qartë dispozitave të tjera, p.sh. Neni 3 (c) në lidhje me ndihmën juridike dytësore në procedurën penale)), si për çështjet procedurale

- Kodi i Procedurës Civile,
- Kodi i Procedurës Penale,
- Kodi i Procedurës Administrative,
- Ligji i Avokatëve
- Ligji për Tarifat Gjyqësore dhe për çështje të caktuara organizative
- Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe
- Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore.

Kapitujt specifikë të këtij manuali u referohen këtyre ligjeve për detaje të mëtejshme.

2. E drejta e BE-së

Neni 47 Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European ka tekstin e mëposhtëm:

“Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën të paraqesë një mjet ligjor të efektshëm në një gjykatë sipas kushteve të parashikuara në këtë nen. (..)

Personave të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme u jepet **ndihmë juridike**, në masën që kjo ndihmë është e nevojshme për të garantuar në mënyrë të efektshme aksesin në gjykatë.”

GJED(C-279/09DEB Deutsche Energiehandels- und Beratungsgesellschaft mbH kundër Bundesrepublik Deutschland) ka nxjerrë përfundimin bazuar në Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, ndër të tjera si më poshtë:

Në bërjen e këtij vlerësimi, gjykata e brendshme duhet të marrë parasysh

- përmbajtjen e- gjykimit;
- nëse kërkuesi ka një perspektivë të arsyeshme suksesi;
- rëndësinë e asaj që diskutohet për kërkuesin në gjykim;
- kompleksitetin e ligjit dhe procedurës përkatëse; dhe
- aftësinë e kërkuesit për të përfaqësuar veten në mënyrë efektive.

Për të vlerësuar proporcionalitetin, gjykata kombëtare mund të marrë parasysh shumën e kostove të procedurave në lidhje me të cilat duhet të bëhet pagesa e paradhënies, dhe nëse ato kosto mund të paraqesin një pengesë të pakapërcyeshme për të aksesuar gjykatën.

3. E drejta ndërkombëtare

1. Këshilli i Europës

i. Vështrim i përgjithshëm

Aktet e mëposhtme ligjore të Këshillit të Evropës janë veçanërisht të rëndësishme:

- Neni 96 i KEDNJ-së
- Rezoluta (78) 8 për Ndihmën Juridike dhe Këshillimin
- Rekomandimi R (93) 1 për qasjen efektive në ligj dhe drejtësi për shumë të varfrit

ii. Neni 6 i KEDNJ-së - Vështrim i përgjithshëm

Neni 6 i KEDNJ-së ka këtë tekst:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të ndonjë akuze penale kundër tij, kushdo ka të drejtën e shqyrtimit të drejtën dhe me dyer të hapura (...)

Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë”.

Kjo do të thotë që ekziston një dispozitë e qartë në Nenin 6 të KEDNJ-së për ndihmën juridike në të drejtën penale, por jo për të drejtën civile. E drejta e aksesit tek një avokat në procedimet penale zbatohet gjatë gjithë procedimit, nga marrja në pyetje nga policia deri tek apeli (Salduz kundër Turqisë).

iii. Neni 6 i KEDNJ-së - Procedurat Penale

Përcaktimi nëse ‘interesat e drejtësisë’ (themeli) kërkojnë dhënien e ndihmës juridike në të drejtën penale përfshin marrjen parasysh të tre faktorëve, përkatësisht:

- rëndësinë e veprës penale dhe ashpërsinë e dënimit të mundshëm; Kur bëhet fjalë për lirinë e një individi, interesat e drejtësisë në parim kërkojnë përfaqësim ligjor (*Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Ky detyrim lind edhe nëse ekziston vetëm një mundësi e një dënimi me burgim (*Perks dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*).
- kompleksitetin e çështjes; Kur “gjykimi ishte qartazi i ngarkuar me pasoja për kërkuesin” dhe çështja është komplekse, ndihma juridike duhet të jepet (*Pham Hoang kundër Francës*).
- situatën shoqërore dhe personale e të pandehurit (*Quaranta kundër Zvicrës*). Kërkuesit nuk duhet të tregojnë se mungesa e ndihmës juridike i ka shkaktuar “dëm faktik” mbrojtjes së tyre; ata vetëm duhet të tregojnë se duket “e besueshme në rrethana të veçanta” se një avokat do të ishte ndihmë (*Artico kundër Italisë*).

Shembull: Në çështjen *Zdravko Stanev kundër Bullgarisë*, kërkuesi ishte i papunë. Ai u ankua se iu refuzua ndihma juridike në procedimin penal për falsifikim të dokumenteve në një gjykim civil. Ai u dënua për këtë vepër penale dhe u gjobit me 250 €. Ai gjithashtu u urdhërua të paguante 8,000 € si dëmshpërblim.

GJEDNJ-ja vuri në dukje se kërkuesi fillimisht ishte në rrezik të një dënimi me burg; megjithëse kjo nuk u vendos, shpërblimi i dëmit ishte domethënës duke pasur parasysh situatën e tij financiare. Kërkuesi kishte një diplomë universitare, por pa trajnim juridik. Gjykimi nuk ishte me ndonjë nivel të lartë të kompleksitetit, por përfshinte çështje në lidhje me rregullat për pranueshmërinë e provave, rregullat procedurale dhe kuptimin e qëllimit. Për më tepër, vepra penale për të cilën u akuzua kërkuesi përfshiu përjashtimin e një anëtari të lartë të gjyqësorit dhe vuri në pikëpyetje integritetin e procesit gjyqësor në Bullgari. Një avokat i kualifikuar padyshim do të kishte qenë në gjendje të mbronte çështjen

me qartësi më të madhe dhe të kundërshtonte në mënyrë më efektive argumentet e ngritura nga prokuroria. Prandaj, GJEDNJ-ja përfundimisht jeti një shkëlqe të Nenit 6 (3) të KEDNJ-së.

iv. Neni 6 i KEDNJ-së - Procedurat Civile

Nuk ka asnjë detyrim për të siguruar ndihmë juridike për të gjitha gjykimet që përfshijnë të **drejtat dhe detyrimet civile** (*Del Sol kundër Francës*).

Sidoqoftë, edhe në procedurat e së drejtës civile, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në rrethana të caktuara, ndihma juridike duhet të sigurohet:

Airey kundër Irlandës: “E drejta për një gjykim të drejtë mund të përfshijë një të drejtë të nënkuptuar për ndihmë juridike në çështjet civile nëse është e domosdoshme për një qasje efektive në drejtësi, p.sh. atëherë kur procedura ose çështja është shumë e ndërlikuar ose kur përfaqësimi ligjor është i detyrueshëm”.

Steel and Morris kundër MB-së: “Në varësi të rëndësisë, kompleksitetit të çështjes dhe aftësive të kërkuesit për të përfaqësuar veten e tij”.

P., C. and S. kundër MB-së: “Nuk ka asnjë të drejtë automatike (...) për ndihmë juridike ose përfaqësim juridik” në gjykimet që shqyrtojnë të drejtat civile. Dy rrethana kërkojnë ndihmë juridike ose përfaqësim:

1) domosdoshmëria e ndihmës (për shkak të përfaqësimit të detyrueshëm ligjor ose kompleksitetit të procedurës) ose

2) drejtësi në lidhje me atë që është në diskutim.”

Mund të ketë raste kur mundësia e paraqitjes para Gjykatës së Lartë personalisht, edhe pa ndihmën e avokatit, do të përmbushë kërkesat e Nenit 6 § 1 (edhe nëse kërkuesi ishte përballur me barrën e provës së vërtetësisë së pretendimeve të bëra ndaj palës tjetër) (*McVicar kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

Në raste që kanë të bëjnë me çështje me rëndësi të veçantë për një individ (të tilla si kontakti me fëmijët e tyre), mund të kërkohet ndihmë juridike, veçanërisht nëse një individ është i preکشëm (për shembull, ka probleme të shëndetit mendor) (*Nenov kundër Bullgarisë*).

Refuzimi i ndihmës juridike me arsyetimin se një ankesë, në kohën e paraqitjes, nuk dukej e bazuar, në disa rrethana mund të dëmtojë thelbin e të drejtës së një kërkuesi në një gjykatë (*Aerts kundër Belgjikës*).

iv. Neni 6 i KEDNJ-së - Çështje të Përgjithshme

Ndihma juridike është një e drejtë individuale dhe jo një detyrim që duhej të ushtrohej nga *palë* (*Černius dhe Rinkevicius kundër Lituanisë*). Fakti që një palë nuk ka aplikuar për ndihmë juridike për t'i mundësuar asaj përfaqësimin nga avokatë të specializuar, nuk do të thotë se ata kanë hequr dorë nga disa të drejta të tjera procedurale (në rastin konkret: e drejta për garancitë e procesit kontradiktor) (*Meftah dhe të tjerët kundër Francës*).

Ndihma juridike nuk ka pse të marrë një formë të veçantë; shtetet janë të lira të vendosin si të përmbushin detyrimet e tyre ligjore (*Airey kundër Irlandës*). Megjithatë duhet të jetë efektive: Kërkesat e një gjykimi të drejtë nuk plotësohen nëse avokati i ndihmës juridike nuk e ka vizituar asnjëherë palën (të shtruar në spital, me sëmundje mendore) që ai përfaqëson (*A.N. kundër Lituanisë*).

Shtetet **nuk janë të detyruara të shpenzojnë fonde publike për të siguruar barazinë e plotë të armëve** midis personit të asistuar dhe palës kundërshtare, “për sa kohë që secila palë do të ketë një mundësi të arsyeshme për të paraqitur çështjen e tij ose të saj në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh thelbësor përkundrejt kundërshtarit” (*Steel dhe Morris kundër MB-së*).

Për të shmangur arbitraritetin, një sistem i ndihmës juridike duhet të krijojë një **mekanizëm të drejtë** për përzgjedhjen e çështjeve që mund të përfitojnë (*Gnahoré kundër Francës*). U takon shteteve të krijojnë sisteme që të përputhen me KEDNJ-në. Mosmarrja e një vendimi zyrtar mbi një kërkesë për ndihmë juridike mund të shkelë Nenin 6 (1) (*A.B. kundër Sllovakisë*).

Vendime të mëtejshme përkatëse të GJEDNJ-së përmenden në kapitujt përkatës të këtij manuali.

2. OKB

Ekzistojnë dy akte tepër të rëndësishme:

- **Parimet dhe Udhëzimet e OKB për Qasjen në Ndihmën Juridike në Sistemet e Drejtësisë penale 2012** (UN Doc. A / C.3 / 67 / L.6, at) dhe
- **Konventa Ndërkombëtare e OKB-së mbi të Drejtat Civile dhe Politike (“KNDCP”)** (Neni 14 (3) (d)), i cili parashikon si në vijim:
 “3. Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale:

(d) Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të

informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t'i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar;'

- Neni 16 i Konventës së vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve (**Konventa e Gjenevës**) (e cila mund të ketë njëfarë rëndësie në zbatimin e Nenit 10 ç) parashikon si në vijim:
 “Aksesi në gjykata 1. Një refugjat do të ketë qasje lirisht në gjykatat sipas së drejtës së territorit e të gjitha Shteteve Kontraktuese. 2. Një refugjat gëzon në Shtetin Kontraktues në të cilin ai ka vendbanimin e tij të zakonshëm të njëjtin trajtim si një shtetas në çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në Gjykata, duke përfshirë ndihmën juridike dhe përjashtimin nga cautio judicatum solvi. 3. Një refugjati do t'i jepet çështjeve të përmendura në paragrafin 2 në vende të ndryshme nga ai në të cilin ai ka vendbanimin e tij të zakonshëm trajtimi që i është dhënë një shtetasi të vendit të vendbanimit të tij të zakonshëm”.

4. Ligji i ri për ndihmën juridike

a. Vetë Ligji.

Ligji për ndihmën juridike është i strukturuar si më poshtë:

- Kapitulli I: Dispozita të **përgjithshme**
 - o Neni 1: Objekti i ligjit
 - o Neni 2: Objektivi i ligjit
 - o Neni 3: Përkufizime
 - o Neni 4: Parimet e ndihmës juridike
 - o Neni 5: Format e ndihmës juridike
- Kapitulli II: Organizimi i Ndihmës Juridike
 - o Neni 6: Institucionet e përfshira
 - o Neni 7: Ministria e Drejtësisë
 - o Neni 8: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
 - o Neni 9: Dhoma Kombëtare e Avokatisë
- Kapitulli III: **Përfituesit** e Ndihmës Juridike
 - o Neni 10: Kriteret e tjera të përshtatshmërisë
 - o Neni 11: Kategori të posaçme të përfituesve
 - o Neni 12: Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme
- Kapitulli IV: Ndihma Juridike **Parësore**
 - o Nenet 13 deri 16: Institucionet që ofrojnë ndihmë juridike parësore
 - o Neni 17: Kërkesa dhe procedura

- Kapitulli V: Ndihma Juridike **Dytësore**
 - o Neni 18: Vështrim i përgjithshëm
 - o Nenet 19 deri 23: Kërkesa dhe procedura
 - o Neni 24: Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët
- Kapitulli VI: Përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet
 - o Neni 25: Vështrim i përgjithshëm
 - o Nenet 26 deri 27: Kërkesa dhe procedura
 - o Neni 28: Realizimi
- Kapitulli VII: **Rimbursimi**
 - o Neni 30: Rimbursimi nga pala gjyqumbëse
 - o Neni 31: Rimbursimi nga përfituesi
 - o Neni 32: Rimbursimi nga përfituesi në rastin e informacionit të rremë
- Kapitulli VIII: Dispozitat e fundit dhe kalimtare
 - o Neni 34: Aktet nënligjore
 - o Neni 35: Publikimet
 - o Neni 36: Dispozitat kalimtare
 - o Neni 38: Hyrja në fuqi

b. Aktet nënligjore

Ekzistojnë aktet nënligjore vijuese:

- **Në lidhje me Drejtorinë:** Urdhri i Kryeministrit Nr. 59, datë 25.03.2019, për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas
- **Në lidhje me ndihmën juridike parësore**
 - o Vendimi Nr. 55, datë 6.2.2019, i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti
 - o Vendimi Nr. 110 datë 6.3.2019, nga Këshilli i Ministrave që përcakton procedurat dhe rregullat për zgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuarra për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe mënyrën e metodës së tyre të financimit
 - o Shtojca 1 e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për ‘Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti’

- **Formularët (Urdhri Nr. 225, datë 25/3/2019, për Miratimin e Formave të Ndhmës Juridike të garantuara nga Shteti):**
 - o Kërkesë dhe vetë-deklarim
 - Shtojca I: Formulari i kërkesës dhe vetë-deklarimi për ndihmë juridike parësore
 - Shtojca II: Formulari i kërkesës për ndihmë juridike dytësore
 - Shtojca III: Formulari i kërkesës për përjashtim nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore
 - Shtojca IV: Formulari i vetë-deklarimit në lidhje me të ardhurat dhe pronat
 - Shtojca V: Formulari i vetë-deklarimit në lidhje me kategoritë specifike
 - o Formularë e regjistrimit
 - Shtojca VI: Formulari i regjistrimit për regjistrimin e kërkesave dhe vetë-deklarimeve sipas formularëve
 - Shtojca VII: Formulari i regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore
 - o Ankimimi
 - Shtojca VIII: Forma e ankesës kundër vendimit që refuzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore
- **Në lidhje me avokatët:**
 - o Kontratat model me avokatët (Shtojca 2 e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për 'Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti' dhe Vendimi i Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal)
 - o Parimi i rotacionit (Vendimi i Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal)
 - o Listat e avokatëve
 - o Vendimi i Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal, dhe

- o **Udhëzim i përbashkët Nr. 17, i datës 05.08.2020 për rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, dhe në proceset administrative**
 - Kriteret e shpërblimit dhe procedura e pagesës (Udhëzim i Përbashkët Nr. 18, i datës 5.8.2020, për miratimin e kriterëve për përfundimin e pagesave dhe tarifave të shpërblimit për avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore)
- **Në lidhje me përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet**
 - o Tarifat e shpërblimit për ekspertët dhe dëshmitarët (Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë gjykimit” dhe Udhëzimi për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit”)
 - o Procedurat për pagimin e shpenzimeve gjyqësore (Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr.6, datë 20/08/2019, për rregullat dhe procedurat e bërjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për këtë arsye është vendosur përjashtimi në rast të dhënies së ndihmës juridike)
- **Në lidhje me rikuperimin e tarifave dhe shpenzimeve**
 - o Akt nënligjor për procedurën, periodicitetin dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave (Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat e Verifikimit të Rrethanave për Kthimin e Fitimeve)
- **Në lidhje me mbledhjen e të dhënave**
 - o Udhëzimi Nr. 1, datë 08/03/2019, i Ministrisë së Drejtësisë për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave në regjistra”.

5. Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi për Gjykatat Administrative dhe disa ligje të tjera kombëtare

Këto ligje përmbajnë, nga njëra anë dispozita, që kanë të bëjnë me ndihmën juridike, nga ana tjetër, dispozitat e përgjithshme që janë të rëndësishme kur Ligji për Ndihmën Juridike zbatohet në një procedurë konkrete. Këto dispozita janë përgatitur për të treguar se si hapat e ndryshëm në procedurën e kërkesës, vendimit dhe zbatimit të ndihmës juridike funksionojnë në një procedurë konkrete.

III. Institucionet e përfshira

1. *Vështrim i përgjithshëm*

Institucionet e mëposhtme janë të përfshira në organizimin, administrimin dhe zbatimin e sistemit të ndihmës juridike:

- Ministria e Drejtësisë (Nenet 6 dhe 7)
- Drejtoria e Ndhmës Juridike (Nenet 6 dhe 8) përfshirë punonjësit me trajnim të posaçëm (Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore) (Neni 14)
- Dhoma Kombëtare e Avokatëve (Nenet 6 dhe 9)
- Dhoma lokale e avokatëve (Neni 24 (2))
- Gjykatat (Neni 6)
- Organet e Procedurale (Neni 21)
- OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore (Neni 15)
- Klinikat ligjore prane Institucioneve të Arsimit të Lartë që ofrojnë ndihmë juridike parësore (Neni 16)

2. *Ministri i Drejtësisë (Neni 7)*

Ministri i Drejtësisë është kryesisht përgjegjës për çështjet buxhetore dhe mbikëqyrëse, hartimin e politikave dhe ligjeve dhe raportimin. Këto detyrat dhe përgjegjësi mund të grupohen si më poshtë:

- i propozon Ministrisë së Financave **projekt-buxhetin vjetor** për ndihmën juridike
- raporton çdo vit në Kuvend për situatën e sistemit të ndihmës juridike;
- në lidhje me **hartimin e ligjeve**
 - o miraton dhe boton formularë të ndryshëm
 - o miraton kontratat model
 - o miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e informacionit të regjistrit të kërkesave dhe të vetë-deklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të regjistrit të dhënies së ndihmës juridike parësore
 - o bën propozimin për organizimin e brendshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (Neni 8 (1))

- o miraton rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore dhe tarifave (Neni 28 (4))
 - o miraton procedurën, periodicitetin dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave (Neni 31 (1))
 - o miraton aktet nënligjore të tjera të përmendura në Nenin 34 (1) deri (3) dhe (5)
- miraton **krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore**, pasi të ketë marrë mendimin paraprak të Këshillit të Lartë Gjyqësor
 - **autorizon OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore** (Neni 15)
 - miraton (pasi të ketë marrë mendimin paraprak të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë) kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria për Ndihmë Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore
 - lidhur me **pagesat**
 - o miraton (me një udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për Financat, pasi të ketë marrë mendimin paraprak të Dhomës Kombëtare të Avokatisë), kriteret për marrjen e pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit për avokatët, të cilët ofrojnë shërbime dytësore të ndihmës juridike;
 - o miraton procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Pa pagesë në lidhje me pagesat për shpenzimet gjyqësore
 - **publikon** në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë
 - o listën e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, dhe
 - o listën e organizatave të autorizuara jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore;

3. *Gjykata dhe Organi Procedues*

Gjykatat (Neni 6) dhe organi procedues (Neni 21) janë kompetentë për miratimin e **ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga tarifave dhe shpenzimet gjyqësore**.

Organi i procedurës (Neni 21) emëron dhe zëvendëson gjithashtu avokatin konkret (Neni 24 (1) (c), (3) dhe (6); shih gjithashtu Vendimin e Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal).

4. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (Drejtoria)

a. Vështrim i përgjithshëm

Drejtoria është **aktori kryesor** në administrimin dhe zbatimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Është një person juridik publik nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Detyrat e saj mund të grupohen si më poshtë:


- Organizimi dhe administrimi i sistemit të ndihmës juridike si i tillë
- Hartimi i akteve nënligjore
- Përgjegjësi të caktuara në administrimin e rasteve specifike të ndihmës juridike

Është krijuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr 59, datë 25.03.2019, për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

b. Organizimi i Brendshëm i Drejtorisë

Struktura e detajuar është vendosur me Urdhrin e Kryeministrit Nr 59, datë 25.03.2019, për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Numri i punonjësve të Drejtorisë në total do të jetë 25 persona (Neni 3 i Urdhrit).

Struktura e saj do të jetë si më poshtë:



c. Administrimi dhe zbatimi i sistemit të ndihmës juridike si i tillë

Detyrat e saj mund të përmbliken si më poshtë:

- Raportimi në Ministrinë e Drejtësisë;
- Zbatimi i politikës për ndihmën juridike;

- Menaxhimi dhe propozimi (planifikimi) i buxhetit për ndihmë juridike;
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i cilësisë;
- Lidhja e kontratave me organizatat Jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe me avokatë që ofrojnë ndihmë juridike dytësore
- Menaxhimi i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore
- Menaxhimi i të dhënave përfshirë regjistrin e kërkesave dhe vetë-deklarimin.

Kjo detyrë specifikohet më tej në Udhëzimin Nr. 1, datë 08/03/2019, i Ministrit të Drejtësisë për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave në regjistra”. Ai vlen për a) kërkesat dhe vetë-deklarimet e përfituesit, dhe b) të dhënat e regjistrin të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

- Publikime / Marrëdhënie me publikun
Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukimit ligjor
- Publikimi i listës së avokateve për ndihmë juridike dytësore (Neni 8/2 (h));
- Hartimi i akteve nenligjore

d. Përgjegjësi në administrimin e rasteve specifike të ndihmës juridike

Detyrat e Drejtorisë janë:

- Pagesa e avokatëve dhe shpenzimet gjyqësore
- Realizimi i rimbursimit
- Në ndihmën juridike dytësore dhe në lidhje me përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet Drejtorisë
 - o i njoftohen vendimet për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtimet, sipas kapitullit VI (Neni 23 (ç), Neni 21 (3) dhe Neni 27 (4)) dhe
 - o shqyrton dhe bën dhe ankesat e mundshme (Neni 22 (9) dhe Neni 27 (3))

e. Hartimi i projekteve

Drejtoria është përgjegjëse për hartimin e disa akteve nënligjore.

5. Dhoma Kombëtare dhe ato Lokale të Avokatëve

a. Vështrim i përgjithshëm

Disa detyra kryhen nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve dhe disa nga Dhomat Lokale e Avokatëve.

b. Dhoma Kombëtare e Avokatëve (Neni 9)

Dhoma Kombëtare e Avokatëve miraton, në të tjera, në lidhje me avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore,

- kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e tyre,
- parimin e rotacionit dhe
- listën e avokatëve (shiko për të gjitha: Nenet 3 deri 10) të Vendimit të Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal dhe Udhëzimin e Përbashkët Nr. 17, datë 05.08.2020 mbi rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative).

c. Dhoma lokale e avokatëve (Neni 24 (2))

Në rastet kur avokati nuk emërohet ose zëvendësohet nga organi procedues (Neni 21), Dhoma Lokale e Avokatëve

- emëron nga lista e avokatëve (hartuar nga dhoma kombëtare) sipas parimit të rotacionit avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe
- i zëvendëson në rrethana të caktuara.

6. Ofruesit e Ndihmës Juridike Parësore

Shihni kapitullin për ndihmën juridike parësore.

IV. Kriteret e Ndhmës Juridike

1. Vështrim i përgjithshëm

Nenet 10 deri 12 parashikojnë **kritere të përgjithshme** që duhet të përmbushen si për t'u kualifikuar për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, ashtu edhe për përjashtimin e shpenzimeve dhe tarifave. Paragrafët e mëposhtëm shqyrtojnë se cili prej këtyre Neneve zbatohet në cilat rrethana.

Dispozitat për ndihmën juridike parësore dhe dytësore kërkojnë **kushte të tjera specifike** (shiko pikat 6 dhe 7).

Neni 10 trajton kushtet e përgjithshme, Neni 11 kategoritë e veçanta të përfituesve dhe Neni 12 personat me të ardhura dhe pronë të pamjaftueshme.

2. Neni 10 (Kriteret e Përgjithshme Personale)

a. Vështrim i përgjithshëm

Neni 10 rregullon kushtet e përgjithshme që çdo kërkues duhet të plotësojë në mënyrë që të kualifikohet për ndihmë juridike. (Shih gjithashtu pikën për ndihmën juridike dytësore dhe rimbursimin për hollësi.)

Personat e mëposhtëm mund të kualifikohen për ndihmë juridike:

- Qytetarët shqiptarë me vendqëndrim ose vendbanim në Shqipëri
- Qytetarë të huaj (ose persona pa shtetësi) me
 - o qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm në Shqipëri dhe lejë qëndrimi, ose
 - o të cilët hyjnë legalisht në Shqipëri dhe përfitojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ose bazuar në parimin e reciprocitetit, dhe
- Disa "refugjatë" ose azilkërkues

b. Qytetarët shqiptarë

Vetëm shtetasit shqiptarë me **vendqëndrim ose vendbanim** në Shqipëri

kualifikohen për ndihmë juridike. Pyetja nëse dikush ka një vendqëndrim ose vendbanim në Shqipëri përcaktohet sipas parashikimeve përkatëse për vendqëndrimin dhe vendbanimin. Këto janë parashikuar në ligjin 10129/2009 për statusin civil, të ndryshuar në vitin 2018.

c. Qytetarë të huaj dhe persona pa shtetësi (siç përmendet në Paragrafët b dhe c)

Neni 10 trajton **dy kategori** të shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, përkatësisht ata të përmendur në paragrafët b dhe c, nga njëra anë, dhe “refugjatët” në paragrafin ç, nga ana tjetër.

Qytetarët e huaj sipas paragrafëve b dhe c (ose persona pa shtetësi) kualifikohen për ndihmë juridike nëse ata

- qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe kanë një leje qëndrimi, ose
- hyjnë legalisht në Shqipëri dhe përfitojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ose bazuar në parimin e reciprocitetit.

Paragrafi b (ndryshe nga paragrafi a) nuk ka të bëjë me kushtet e vendqëndrimit ose vendbanimit, por i referohet qëndrimit “për një periudhë të përkohshme ose të përhershme” në kombinim me një “leje qëndrimi në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt”.

d. “Refugjatët” (siç përmendet në Paragrafin ç)

Paragrafi përcakton grupet e mëposhtme të personave:

- azilkërkuesit,
- personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe
- personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

Shprehjet e përdorura në paragrafin ç) duhet të interpretohen në përputhje me ligjet përkatëse.

e. Personat juridikë

Sipas formulimit personat juridikë, siç janë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, nuk kualifikohen për ndihmë juridike.⁷

Sipas GJED-së (C-279/09 DEB *Deutsche Energiehandels- und Beratungsgesellschaft mbH v Bundesrepublik Deutschland*)⁷ ndihma juridike

⁷ Shihni GJEDNJ-në në formë më të diferencuar:: Trajtimi i ndryshëm i personave fizikë

nuk mund të përjashtohet në asnjë rrethanë për personat juridikë dhe është shprehur ndër të tjera si vijon:

Parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore, siç parashikohet në Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit European, duhet të interpretohet në kuptimin se nuk është e pamundur që personat juridikë të mbështeten në atë parim dhe atë ndihmë të dhënë në përputhje me atë parim që mund të mbulojë, ndër të tjera, caktimin nga paradhënia e shpenzimeve gjyqësore dhe / ose ndihmën e një avokati. Në lidhje me këtë, gjykatës së brendshme i takon të konstatojë nëse kushtet për dhënien e ndihmës juridike përbëjnë një kufizim të së drejtës së aksesit në gjykata që dëmton thelbin e kësaj të drejte; nëse ndjekin një qëllim legjitim; dhe nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit legjitim i cili synohet të arrihet. Në lidhje më specifikisht me personat juridikë, gjykata e brendshme mund të marrë parasysh situatën e tyre. Prandaj, gjykata mund të marrë në konsideratë, ndër të tjera, formën e personit juridik në fjalë dhe nëse është fitimprurës apo jofitimprurës; kapacitetin financiar të ortakëve ose aksionarëve; dhe aftësinë e atyre ortakëve ose aksionarëve për të marrë shumat e nevojshme për të filluar procedimet ligjore.’

f. Praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ-së dhe Konventa e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve (Konventa e Gjenevës)

Në procedurat penale ndihma juridike duhet t’u ofrohet emigrantëve të paligjshëm pa dokumente qëndrimi. Në këtë rast, kërkuesi nuk fliste gjuhën amtare (*Biba kundër Greqisë* (2000)).

Kur bëhet fjalë për çështje serioze të së drejtës familjare, të cilat prekin jo vetëm kërkuesin - për shembull kur kundërshtohet atësia e fëmijëve - vetëm arsyet veçanërisht bindëse do të justifikonin ndryshimin në trajtim midis banorëve të ligjshëm dhe të paligjshëm (*Anakomba Yula kundër Belgjikës* (2009)).

Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (C-391/16, C-77/17 und C-78/17) një person pa shtetësi ose shtetas i vendit të tretë, i cili i plotëson kriteret e **Konventës së Gjenevës**, duhet të konsiderohet refugjat në kuptimin e Nenit 14 (4) deri (6) të Direktivës 2011/95 / BE dhe Konventës së Gjenevës, pavarësisht nëse ai është shpallur zyrtarisht refugjat dhe në këtë mënyrë i përshtatshëm për të drejtat (gjithashtu Nenin 16 të Konventës së Gjenevës) të dhëna për çdo refugjat sipas Konventës së Gjenevës. Ajo gjithashtu ka

dhe juridikë justifikohet nga domosdoshmëria për të kontrolluar përdorimin e fondeve publike; ndihma juridike për personat juridikë (të huaj) mund t’i nënshtrohet reciprocitetit (*Granos Organics Naçionales S.A. kundër Gjermanisë* (2012)).

theksuar se Direktiva nuk cenon detyrimin e Shtetit Anëtar të interesuar të respektojë dispozitat përkatëse të Kartës së të Drejtave Themelore.

Këto parime zbatohen në Nenin 10.

3. Neni 11 (Grupet Specifike të Përfituesve)

a. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

Rrethanat personale të të akuzuarit ose personit të dyshuar janë të rëndësishme. Interesat e testimin të drejtësisë tregojnë se ndihma juridike falas mund të kërkohet për personat që konsiderohen të prekshëm, të tilla si fëmijët, personat me probleme të shëndetit mendor dhe refugjatët (Quaranta kundër Zvicrës).

Neni 11 zbaton parimin e Nenit 4 (e). Ai përmend grupet e personave që kualifikohen për ndihmë juridike, pavarësisht nga të ardhurat dhe / ose pronat e tyre. Disa nga këto grupe kanë të drejtë për ndihmë juridike vetëm në disa procedura të caktuara, p.sh. procedurat penale; disa kanë të drejtë për ndihmë juridike në të gjitha procedurat e mundshme. Disa prej këtyre grupeve tashmë kanë të drejta të veçanta në disa procedura, siç është, sipas Nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale (mbrojtja e detyrueshme). Lidhja e Ligjit për Ndihmën Juridike me këto dispozita specifike do të shtjellohet tek pikat përkatëse të këtij manuali. Grupet e përfshira në Nenin 11 mund të ndahen në nëngrupe si më poshtë:

- Viktimat në procedimin penal:
 - o viktimat e dhunës në familje;
 - o viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
 - o viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- Fëmijët:
 - o fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
 - o fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- Personat me aftësi të kufizuar:
 - o personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
 - o personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në

- o institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
 - o personat, të cilët i nënshtrohen trajtimin vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
 - o personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
 - o personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- personat, të cilët janë **përfitues të skemave të mbrojtjes sociale**;
 - personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën **diskriminim**, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

4. Neni 12 (Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme)

a. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

GJEDNJ-ja nuk ka dhënë një përkufizim të 'mjeteve të mjaftueshme' (si kusht për ndihmë juridike). Rrethanat e veçanta të secilës çështje do të merren parasysh për të përcaktuar nëse rrethanat financiare të një pale justifikojnë dhënien e ndihmës juridike. Kërkuesi mban barrën e provës së mjeteve të pamjaftueshme (Croissant kundër Gjermanisë). Të gjitha provat duhet të merren në konsideratë, duke përfshirë provat e statusit të kërkuesit (të tilla si nëse ai/ajo ka kaluar kohë në paraburgim), informacionin e siguruar nga individit dhe çdo provë që bie në kundërshtim me kërkuesin (Pakelli kundër Gjermanisë).

Zgjidhja e kësaj pyetje është një çështje e gjykatave të brendshme, të cilat duhet të vlerësojnë provat në përputhje me kërkesat e Nenit 6 (1) (R. D. kundër Polonisë).

GJEDNJ-ja ka vendosur që nuk do të ketë shkelje të Nenit 6 (1) nëse një kërkues del jashtë skemës së ndihmës juridike sepse të ardhurat e tij/saj tejkalojnë kriteret financiare, me kusht që thelbi i të drejtës së hyrjes në gjykatë të mos dëmtohet (Glaser kundër Mbretërisë së Bashkuar).

b. Pasqyra dhe Objekti i zbatimit të Nenit 12

Neni 12 përcakton se në cilat rrethana personat që **përfshihen nga Neni 10, por që nuk janë përfshirë tashmë nga Neni 11**, mund të kualifikohen për ndihmë juridike. Ata plotësojnë kushtet e Nenit 12 nëse **nuk kanë as të ardhura të mjaftueshme dhe as pronë të mjaftueshme**. Të dy termat përkufizohen në këtë ligj.

Formulimi i Nenit 12 duket se i referohet vetëm ndihmës juridike dytësore pasi thotë se “ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile”. Formulimi i qartë i Kapitullit III (që nuk kufizohet në ndihmën juridike dytësore), Neni 17 (2) (“(...) nënshkruan një vetë-deklarim që ai / ajo i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj (...)” dhe Neni 25 tregon se **gjithashtu që për ndihmën juridike parësore dhe përjashtimin nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore** kërkuesit duhet të përfshihen nga Neni 11 ose 12.

Kriteret e Nenit 12 zbatohen **pavarësisht nga vlera e kërkesës dhe sasia e shpenzimeve dhe tarifave të mundshme.**

c. Barra e Provës - Përcaktimi i të ardhurave ose pasurive të pamjaftueshme

Neni 12 (1) parashikon që kërkuesi “**provon** se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme”. Nuk ka ndonjë formulim përkatës në Nenet 10, 11 ose 17. Sipas Nenit 25 (5) (a) kërkesa për ndihmë juridike dytësore refuzohet kur “nuk plotësohen kushtet e parashikuara në Nenin 11 dhe 12 të këtij ligji”. Në këtë drejtim lindin dy pyetje:

1. Cilat deklaratat dhe prova duhet të paraqesë kërkuesi? dhe
2. Çfarë hapash duhet / mund të ndërmerret organi vendim-marrës për të verifikuar këto deklaratat dhe prova?

Këto pyetje mund të përgjigjen si më poshtë:

Ligji për Ndihmën Juridike e ka qartësisht idenë se pjesa kryesore e provave për të “vërtetuar” se kushtet e Neneve 11 dhe 12 janë përmbushur, janë formularët përkatës të vetë-deklarimit (shiko Nenet 17 (2), 18, 19 (4) dhe 26 (1)). Kjo do të thotë se **Ligji për Ndihmën Juridike tashmë rregullon në mënyrë shteruese se cilat deklaratat dhe prova** (dokumentacion) kërkuesi duhet të sigurojë.

Këto dispozita që lexohen së bashku me Nenin 22 (3) tregojnë gjithashtu se në përgjithësi, organi vendim-marrës mund (dhe duhet) të kontrollojë vetëm nëse **formularët dhe dokumentet e kërkuara me ligj janë të plota** dhe nuk zbatojnë ndonjë procedurë të hollësishme nëse deklaratat dhe dokumentacioni janë të sakta. Neni 32 rregullon pasojat nëse më vonë rezulton se deklaratat dhe dokumentacioni ishin të pasakta ose jo të plota: Nëse informacioni i dhënë ishte i gabuar mund të kërkohet rimbursimi nga përfituesi.

Një interpretim i tillë është gjithashtu në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së mbi Nenin 6 të KEDNJ-së. Ajo është shprehur

që “I pandehuri mbart barrën e provës që nuk mund të paguajë për asistencë juridike, por ai nuk ka pse të dëshmojë pamundësinë e tij “përtej çdo dyshimi”. (Pakelli kundër Gjermanisë, Vendim i GJEDNJ-së, i datës 25 prill 1983).

d. Të ardhura të pamjaftueshme

i. Përkufizimi i termit “Të ardhura”

Neni 3 (f) përcakton termin “të ardhura” si vijon:

‘Të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Në këto të ardhura nuk përfshihet ndihma ekonomike, pensioni social, pagesat e papunësisë, përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.’

Duke thënë këtë, është e rëndësishme mbajtja parasysh **se jo të gjitha burimet e të ardhurave konsiderohen të ardhura në kuptimin e Nenit 12.**

Përkufizimi i “të ardhurave” është mjaft i ngushtë dhe lë të hapur nëse edhe burime të tjera (jo të përmendura shprehimisht në Nenin 3 (f)) të të ardhurave mund të mbulohen në rrethana të caktuara, p.sh. siç janë pagesat nga amnistitë fiskale. Qëllimi i ligjit (që personat me mjete të përshtatshme financiare të mos kualifikohen për ndihmë juridike) do të mbështeste një kuptim më të gjerë të termit “të ardhura”.

ii. Të ardhura të pamjaftueshme - Vështrim i përgjithshëm

Për përcaktimin se kur të ardhurat janë të pamjaftueshme, Neni 12 bën diferencimin nëse një person **jeton në një familje apo jo**. Neni 3 (g) përkufizon termin “Familje”.

iii. Përkufizimi i termit “Familje” (Neni 3 (g))

“Familje është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore ose bashkëjetese, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë dhe që kontribuojnë bashkërisht, financiarisht ose në mënyra të tjera për përballimin e kostos së jetesës.”

Duke thënë këtë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se jo në çdo rast

të ardhurat e të gjithë personave që jetojnë në një shtëpi duhet të merren parasysh kur llogariten të ardhurat përkatëse në kuptimin e Neni 12.

iv. Të ardhurat (Neni 3 (f)) e një personi që jeton në një familje (Neni 3 (g))

Një person që jeton në një familje (Neni 3 (g)) kualifikohet për ndihmë juridike nëse

- të ardhurat totale të të gjithë anëtarëve të familjes,
- të ndara me numrin e tyre,
- janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore.

Ky rregull nuk zbatohet nëse ndihma juridike aplikohet për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje. Pastaj kërkuesi kualifikohet për ndihmë juridike, nëse të ardhurat e tij janë më të ulëta se paga minimale mujore.

v. Të ardhurat (Neni 3 (f)) e një personi që nuk jeton në një familje (Neni 3 (g))

Në këtë rast kërkuesi kualifikohet për ndihmë juridike, nëse të ardhurat e tij janë më të ulëta se paga minimale mujore. Paga minimale mujore (2018) ishte 26,000 lekë.

e. Pasuri e pamjaftueshme

i. Përkufizimi i termit “Pasuri” (Neni 3 (gj))

“(…) është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore.

Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile⁸ nuk

8 “Neni 529 Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestroja Përfshihen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit:

1. sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiljet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
2. ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
3. dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
4. librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
5. deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
6. ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në

konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji.”

Prandaj është e rëndësishme të mbani në mend se **jo çdo pronë që i përket palës** konsiderohet se është pronë në kuptimin e Nenit 12.

ii. Pasuri e pamjaftueshme

Prona vlerësohet të jetë e pamjaftueshme në këtë kontekst nëse vlera totale nuk tejkalon vlerën e **36 pagave minimale mujore**, d.m.th. (duke marrë pagën minimale mujore 2018) 936.000 lekë.

Nuk ka ndonjë dispozitë në Ligjin për Ndhimën Juridike se si **vlerësohet vlera e pasurisë**, p.sh. si të vlerësohet vlera e pasurive të paluajtshme. Ekzistojnë akte nënligjore që parashikojnë çmime reference për një metër katror të një prone në zona të ndryshme të qyteteve dhe zonave rurale. Ky është Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 132 / 2018, i ndryshuar me Vendimin nr. 168 / 2019 “Për metodologjinë e vlerësimit të vlerës së tregut të pasurive të paluajtshme dhe përcaktimin e kriterëve dhe rregulloreve mbi detyrimin tatimor”. Për pasuritë, kur nuk ekzistojnë akte nënligjore, duke marrë në konsideratë qëllimin e Ligjit për Ndhimën Juridike, i takon kërkuesit që të tregojë vlerën e pasurisë së tij, pa pasur nevojë të sigurojë dokumente specifike, si dëshmi për vlerën e pasurisë.

5. Kriteret shitesë për ndihmën juridike parësore

Sipas Nenit 17(4), një person ka të drejtën të marrë shërbimet e ndihmës juridike parësore **për të njëjtën problematikë ose çështje vetëm një herë**, me përjashtim të rasteve kur rrethana të reja të caktuara justifikojnë dhënien e shërbimeve të mëtejshme të ndihmës juridike parësore për të njëjtin person, rreth së njëjtës problematikë ose çështje. Prandaj, kërkuesi duhet të sigurojë informacionin përkatës në formularin e kërkesës (Pika 3.3 dhe 3.4 e formularit të kërkesës për ndihmë juridike parësore).

6. Kriteria shitesë për ndihmën juridike dytësore dhe përjashtimi nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore

Neni 22 (5) (b) dhe Neni 27 (2) rregullojnë që kërkesa për ndihmë juridike dytësore ose përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore refuzohet kur **“është dukshëm abuziv ose qartazi i pabazuar”**. Ky kusht është në përputhje me KEDNJ-në, pasi GJEDNJ-ja deklaroi se ‘Refuzimi për të ofruar ndihmë juridike në gjykimin e faktit - për shkak të perspektivave

këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës; 7. frutat natyrore një muaj para se ato të piqen.

8. sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

të pamjaftueshme të suksesit, ose për shkak të natyrës joserioze ose shqetësuese të një kërkesë (për shembull, kërkesa paraqitet thjesht për të shkaktuar shqetësim) - mund të jetë legjitime' (*Staroszczyk kundër Polonisë, Steel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

7. Ndryshimi i rrethanave - Rimbursimi

Neni 31 i mundëson shtetit (Drejtorisë) të kërkojë kompensim nga personi që ka marrë ndihmë juridike nëse rrethanat kanë ndryshuar.

V. Ndhimja Juridike Parësore

1. Çfarë është Ndhimja Juridike Parësore?

Ndhimja juridike parësore përkufizohet në Nenin 3 (b) dhe gjithashtu në Nenin 3 të Shtojcës 1 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, 'Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti'. Ajo përbën

- sigurimin e informacionit në lidhje me sistemin juridik dhe aktet ligjore,
- ofrimin e këshillimit,
 - o që është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike. (Neni 3 (ç).
- dhënia e këshillave për procedurat e ndërmjetësimit dhe mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,
- ofrimin e ndihmës në hartimin dhe krijimin e dokumentacionit për të
 - o vënë në lëvizje administratën shtetërore ose
 - o për kërkimin e ndihmës juridike dytësore
- përfaqësimin para organeve të administratës,
 - o Ndhimja juridike dytësore ofrohet vetëm para gjykatave (administrative dhe civile), dhe
- dorëzimi i të gjitha formularëve të tjerë të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

2. Ofruesit e Ndhimës Juridike

a. Vështrim i përgjithshëm

Ofruesit e mundshëm të ndihmës juridike parësore janë

- Punonjës të trajnuar posaçërisht në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (ose mjedise të tjera) (Neni 14)
- OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore (Neni 15)
- Klinikat ligjore prane institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë ndihmë juridike (Neni 16)

Nuk ka ndonjë dispozitë në Ligjin për Ndhimën Juridike që rregullon se cili nga këto institucione siguron në cilat vende dhe në çfarë mase ndihmë juridike parësore.

b. Struktura e ndihmës juridike parësore sipas akteve nënligjore

Sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr 59, datë 25.03.2019, për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas, do të ketë kater qendra të ndihmës juridike parësore te financuara nga buxheti i DNJF-se , por do te kete nen administrim edhe qendra te tjera te hapura me mbeshtetjen e donatoreve.

Për më tepër do të ketë OJQ dhe klinika ligjore që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

c. Punonjës të trajnuar posaçërisht në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (Neni 14)

Ndihma juridike parësore do të jepet në

- qendrat e shërbimit të ndihmës juridik⁹ ose
- në ambiente të tjera të përshtatshme nga punonjës të trajnuar posaçërisht¹⁰ të punësuar në këto qendra.

Aktualisht DNJF administron qendra të ndihmës juridike parësore në Tiranë, Elbasan, Lezhë, Durrës, Lushnje, Fier, Pogradec, Gjirokastrë, Shkodër dhe Dibër.

d. OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore (Neni 15)

OJQ-të që janë të autorizuar nga shteti (Neni 15 (1)) sipas kushteve dhe procedurës së parashikuar në Nenin 15 (1) dhe (2) mund të japin ndihmë juridike parësore.

Akti nënligjor mbi autorizimin e OJQ-ve është Vendimi Nr. 55, datë 6.2.2019, i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti

⁹ Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore (Neni 3(d)) është një njësi e specializuar për ofrimin e ndihmës parësore juridike si 'njësia e drejtpërdrejtë që ofron shërbime për publikun' sipas parashikimeve të ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

¹⁰ "punonjës me trajnim të posaçëm" është një zyrtar (Neni 3/dh) i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, dhe i cili është nënshtruar një trajnimi të posaçëm, dhe është caktuar me detyrën për të ofruar ndihmë juridike parësore në qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Në të rregullohet

- Publikimi i informacionit përkatës për aplikime nga Drejtoria (Neni 4)
- Informacioni dhe dokumentacioni që duhet të sigurohet nga OJQ-të që aplikojnë (Neni 5)
- Dorëzimi i informacionit dhe dokumentacionit nga OJQ-ja aplikuese dhe ekzaminimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria (Neni 6 deri 10) dhe
- Vendimi për autorizimin e OJQ-së nga Ministri i Drejtësisë (Neni 11 deri 12) dhe ankesa kundër këtij vendimi (Neni 13)
- Vlefshmëria (dy vjet) dhe publikimi i autorizimit (Neni 14 dhe 15)
- Revokimi i autorizimit (Neni 16 deri 17)
- Regjistrimi i të dhënave të OJQ-ve të autorizuara (Neni 18) me të dhënat e përcaktuara në Nenin 8 të Udhëzimit Nr. 1, datë 08/03/2019, i Ministrisë së Drejtësisë për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave në regjistra”, dhe
- Detyrimet e njoftimit nga OJQ-të (Neni 19)

Përzgjedhja dhe financimi i OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike parësore përcaktohet më tej në aktin nënligjor, Vendimi Nr. 110 datë 6.3.2019, nga Këshilli i Ministrave që përcakton procedurat dhe rregullat **për zgjedhjen e organizatave** jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit dhe mënyrën e metodës së tyre të financimit. Ai përcakton

- parimet (Neni 2)
- alokimi i një buxheti vjetor për OJQ-të (Neni 3)
- publikimi i atij buxheti (Neni 4), dhe
- thirrja për aplikime për ndihmë financiare (Neni 5)
- kriteret e përgjithshme dhe specifike që OJQ-të duhet të plotësojnë (Neni 6)
- përmbajtja e aplikacioneve (Neni 7)
- organizimi i komitetit të vlerësimit dhe komiteti i apelimit që vlerësojnë këto aplikime (Neni 8 deri 13)
- procesi i vlerësimit të këtyre aplikacioneve (Neni 14 deri 17)
- procesi i lidhjes së kontratave me OJQ-të (Neni 19) dhe përmbajtja e këtyre kontratave (Neni 20)
- shuma e mundshme e mbështetjes financiare për OJQ (Neni 21)
- detyrimet e NGO-ve (Neni 22) dhe mbikëqyrja e tyre nga Drejtoria (Neni 23) dhe pasojat në rast të shkeljes së kontratës (Neni 24)
- raportimi nga Drejtoria (Neni 25)

Kontratat model rregullohen nga Shtojca 1 e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për 'Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti'

Me urdher të Ministrit të Drejtësisë në Shtator të 2020 janë autorizuar 12 OJF për ofrimin e ndihmës juridike paresore si me poshte:

1. "Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza"
2. "Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat"
3. "Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara"
4. "Intelektualët e rinj shpresë"
5. "Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijeve në Shëqipëri (CRCA)"
6. "Forumi i Gruas Elbasan"
7. "Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)"
8. "Të ndryshëm dhe të barabartë"
9. "Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)"
10. "Qendra për nisma ligjore qytetare"
11. "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët"
12. "Qendra Konsumatori Shqiptar"

e. Klinikat ligjore që ofrojnë ndihmë juridike parësore (Neni 16)

Klinikat juridike (të krijuara në institucionet e arsimit të lartë) mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore. Ata mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë.

"Klinikë ligjore", sipas përkufizimit të Nenit 3 (ë) është "njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë. "

Ekzistojnë klinikat ligjore të mëposhtme:

- Universiteti Luarasi
- Universiteti European i Tiranës
- Universiteti Wisdom
- Universiteti Alexander Moisiu, Durrës
- Universiteti Ismail Qemali, Vlora
- Universiteti "Beder"
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë
- Universiteti "Qirjazi"
- Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
- Klinika e Ligjit Shkodër

3. Si përftohet ndihma juridike parësore? Procedura (Neni 17)

Shihni kushtet për të marrë ndihmë juridike: pika IV.

Kërkesa për ndihmë juridike parësore mund të bëhet **me gojë ose me shkrim**.

Kërkuesi duhet të plotësojë një **vetë-deklaratë me formularin** përkatës dhe të bashkëngjisë dokumentacionin e kërkuar (siç parashikohet nga akti nënligjor). Formulari i kërkesës mund të gjendet në Shtojcën 1 të Urdhrit Nr. 225, datë 25/3/2019, për Miratimin e Formave të Ndhmës Juridike të garantuara nga Shteti. Formulari dhe **vetëdeklarimi janë të mjaftueshme për të dëshmuar** se kërkuesi plotëson kushtet për ndihmë juridike parësore. Ofruesi i ndihmës juridike parësore nuk ka për qëllim të kryejë hetime të mëtejshme nëse informacioni i dhënë është i saktë.

Nëse plotësohen kushtet (shiko pikën IV) ndihma juridike parësore **jepet menjëherë** (nëse është e mundur) ose palës i jepet një datë për dhënien e ndihmës juridike parësore.

Një **procesverbal** mbahet me përmbajtjen siç parashikohet në Nenin 17 (7) që specifikohet më tej në Udhëzimin Nr. 1, datë 08/03/2019, i Ministrisë të Drejtësisë për "Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave në regjistra".

Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon në mënyrë periodike Drejtorisë çdo muaj të dhënat e kërkesave dhe vetë-deklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të marrë ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pas muajit të referencës (Neni 3, Udhëzimi Nr. 1, datë 08/03/2019, i Ministrisë të Drejtësisë për "Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave në regjistra".)

Sipas Nenit 4, germa d, të Shtojcës 1 të Urdhrit të Ministrisë të Drejtësisë Nr. 226 datë 25/3/2019 për 'Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti - ofruesit e ndihmës juridike parësore duhet të **raportojnë** çdo tre muaj ose me kërkesë të Drejtorisë në lidhje me çështjet dhe përparimin në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike, duke bashkangjitur dokumentacionin përkatës që vërteton përmbushjen e shërbimeve të ofruara.

4. Lidhja me Ndhmën Ligjore Dytësore (Neni 17 (6) dhe Neni 3 (b) (iv))

Nëse gjatë dhënies së ndihmës juridike parësore bëhet e dukshme se ekziston nevoja për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, pala duhet të informohet dhe të ndihmohet në përputhje me rrethanat.

VI. Ndihma Juridike në Procedurat Gjyqësore: Ndihma Juridike Dytësore dhe Përrjashtimi nga Shpenzimet Gjyqësore dhe Tarifat Gjyqësore

1. Vështrim i përgjithshëm mbi Ndihmën Juridike Dytësore dhe Përrjashtimi nga Shpenzimet Gjyqësore dhe Tarifat Gjyqësore

Dispozitat për ndihmën juridike dytësore dhe përrjashtimi nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore **janë pjesërisht identike ose pjesërisht të ngjashme, por gjithashtu ndryshojnë në aspekte të caktuara:**

- Neni 25, fjalia e parë, (për kushtet e përrjashtimit nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore) është e ngjashme me Nenin 22 (5) (a) (që rregullon rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore nëse kushtet e përcaktuara në Nenin 11 dhe 12 të këtij ligji nuk përmbushen).
- Neni 27 (2) dhe (3) i referohen procedurës së përrjashtimit nga shpenzimet gjyqësore dhe tarifat gjyqësore në Nenin 22 (që rregullon procedurën e aplikimit dhe dhënies së ndihmës juridike dytësore).

Për këtë arsye, në këtë kapitull do të përrfshihen disa **pyetje të përgjithshme që vlejné si për ndihmën juridike dytësore**, ashtu edhe për përrjashtimin nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore. Disa aspekte që janë të rëndësishme vetëm në lidhje me përrjashtimin nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore, do të trajtohen në kapitullin tjetër për përrjashtimin nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore.

Nenet 49 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale merren me forma të caktuara dhe specifike të përfaqësimit juridik në procedurat penale. Rregullat për ndihmën juridike dytësore në procedurat penale (psh. Neni 21) ndryshojnë nga dispozitat për ndihmë juridike dytësore në procedurat civile dhe administrative (shiko pikën 13 për detaje).

2. Vështrim i përgjithshëm mbi Ndhimën Juridike Dytësore

Ndihma juridike dytësore (shih Nenin 18)

- jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë,
- në bazë të kërkesës (sipas formularit) së
- personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas Neneve 11 ose 12, të këtij Ligji.

Ndërsa ndihma juridike dytësore miratohet me vendim të gjykatës ose organit procedues. Avokati individual në parim emërohet dhe zëvendësohet nga dhoma lokale e avokatëve. Vetëm në rastet e trajtuara në Nenin 21, organi procedues (dhe jo dhoma e avokatëve) emëron dhe zëvendëson avokatin individual (Neni 21 (2))= Të drejtat dhe interesi i shtetit mbrohen nga Drejtoria: ajo mund të apelojë vendime dhe të kërkojë kompensim.

3. Çfarë është Ndihma Juridike Dytësore?

Në bazë të Nenit 3(c), “Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për

- përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën d.m.th., faza paragyqësore),
- ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në
 - o çështjet administrative,
 - o civile dhe
 - o në çështjet penale,
- për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal. Kjo do të thotë që në këtë drejtim Ligji për Ndihmën Juridike i nënshtrohet Kodit të Procedurës Penale. Lidhja midis Ligjit për Ndihmën Juridike dhe Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitat e tij specifike do të shtjellohen nën pikën 13.

Kontratat model (shih Nenin 5.2 të Kontratave model në Vendimin e Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal, dhe kontratat model me avokatët dhe Nenin 5.1 të Shtojcës 2 të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për ‘Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti’) specifikojnë detyrimet e avokatit në këtë kuptim.

4. Kushtet - Përfituesit e mundshëm

a. Vështrim i përgjithshëm

Shihni pikën IV mbi kushtet në përgjithësi.

b. Neni 10 (Kriteret e përgjithshme)

Si rregull i përgjithshëm, vetëm personat që plotësojnë kushtet e Nenit 10 (1) do të përfitojnë nga ndihma juridike (Neni 10 (2)).

c. Jo abuzive / jo qartazi e pabazuar

Sipas **Nenit 22 (5) (b)**, kërkesa (për ndihmë juridike dytësore) rrëzohet në rastet kur “është dukshëm abuzive ose qartazi e pabazuar”.

Nuk ka donjë formulim të krahasueshëm në **Nenin 25 (1)** për përjashtimin nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore. Neni 25 (1) u referohet “Personave, që kanë të drejtën e ndihmës juridike dytësore, sipas Neneve 11 ose 12 të këtij ligji”. Referenca tek “Personat, të cilët kanë të drejtën e ndihmës juridike dytësore” dhe një interpretim sistematik tregon se gjithashtu lirimi nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore jepet vetëm nëse kërkesa nuk është dukshëm abuzive ose qartazi e pabazuar. Vetëm personat që kualifikohen për ndihmë juridike dytësore kanë të drejtën e përjashtimit nga shpenzimet dhe tarifat gjyqësore.

Shprehja “është dukshëm abuzive ose qartazi e pabazuar” duhet të lexohet me kuptimin se hapi procedural për të cilin kërkohet ndihma juridike “është dukshëm abuziv ose qartazi i pabazuar”, d.m.th që një deklaratë pretendimi është “është dukshëm abuzive ose qartazi i pabazuar”. Pika 3.1.3 e formularit për kërkesën për ndihmë juridike dytësore kërkon që kërkuuesi të sigurojë të dhëna në lidhje me rastin për të cilin kërkohen shërbime juridike, siç janë “Çfarë ndodhi? Kush janë palët / personat e përfshirë në konflikt me ju? Rrethanat shtesë të rëndësishme për rastin?”. Në rastet në vijim, pretendimi dhe kërkesa për ndihmë juridike dytësore mund të jenë dukshëm abuzive ose dukshëm të pabazuara:

- Nëse kërkuuesi pretendon diçka që është juridikisht e pamundur (p.sh. çmimi i blerjes për shitjen e hënës),
- Nëse periudha e parashkrimit ka kaluar,
- Nëse një palë që nuk përfiton nga ndihma juridike në rrethanat e dhëna nuk do të merrte riskun e një proces gjyqësor dhe nuk do të fillonte një proces gjyqësor, p.sh. sepse mundësia për të rikuperuar përfundimisht paratë e kërkuara nga i pandehuri është shumë e ulët (p.sh. për shkak të gjendjes së tij të keqe ekonomike të njohur),
- Nëse kërkuuesi e di se pozicioni i tij është i gabuar.

5. Organet kompetente për të vendosur për Ndhimën Juridike Dytësore dhe Përrjashtimi nga Shpenzimet Gjyqësore dhe Tarifat Gjyqësore

a. Ligji i ri për ndihmën juridike

Kërkesa duhet t'i adresohet

- gjykatës që është kompetente për shqyrtimin e themelit (Neni 19 (1), 20 (1), 22 (2) dhe 27 (1) për përrjashtimin e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore) ose
- (nëse Neni 21 është i zbatueshëm) organi procedues që fillon hetimin (Neni 19 (1), 20 (2), 21 (1))

b. Gjykata kompetente

i. Vështrim i përgjithshëm

Sipas Nenit 22 (4) gjykata, “në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e legjislacionit procedural”, pas shqyrtimit të kërkesës, do të pranojë (paragrafi a) ose pushojë (paragrafi b) kërkesën. Kërkesa mund të hidhet poshtë kur kërkuesi nuk përrfshihet në kushtet e Nenit 10 (1) (shiko Nenin 10 më lart), “kriteret e përrcaktuara në Nenin 11 dhe 12 të këtij ligji nuk janë përrmbushur;” ose “b) është dukshëm abuziv ose qartazi i pabazuar”. Kjo do të thotë se **fakti që kërkuesi bën kërkesën e tij në gjykatën e gabuar nuk është arsye për të hedhur poshtë kërkesën.**

Ligji për Ndhimën Juridike në kontekstin e ndihmës juridike nuk rregullon më tej

- kompetencën territoriale ose funksionale, ose
- nëse dhe në çfarë mase gjykata duhet dhe mund të shqyrtojë kompetencën e saj, dhe
- si duhet të procedojë gjykata kur nuk është kompetente.

Këto çështje rregullohen nga ligjet përkatëse procedurale (shiko Nenin 22 (1)).

ii. Kodi Civil

Shqyrtimi i Kompetencës

Sipas **Nenit 61** (1) të Kodit të Procedurës Civile, gjykata mund të shprehet kryesisht si jo kompetente dhe ta transferojë dosjen në gjykatën kompetente vetëm në lidhje me kompetencën e subjektit, funksionin ose kompetencën ekskluzive të çështjes, ndërsa për kompetencën territoriale vetëm me kërkesën e palës. Nëse kërkohet ndihmë juridike përpara fillimit të procedurës gjyqësore, asnjë palë (tjetër) nuk mund të kërkojë

transferimin në gjykatën kompetente nëse kërkesa për ndihmë juridike ishte paraqitur në gjykatë e gabuar (jo kompetente).

Zbatimi i Nenit 61 (1) të Kodit të Procedurës Civile në situatat kur bëhet kërkesa, përpara fillimit të procedurës aktuale, mund të shkaktojë problemet e mëposhtme: Nëse gjykata e gabuar (jo kompetente) miraton ndihmën juridike, dhoma e avokatëve të këtij rrethi emëron avokatin nga lista e avokatëve të atij rrethi. Kjo do të çojë në probleme praktike kur deklarata e pretendimit paraqitet në gjykatën e duhur (kompetente). Kjo do të çonte në rezultatin që avokati i ndihmës juridike duhej të udhëtonte në gjykatën kompetente, ku zhvillohet procedura aktuale.

Duke marrë parasysh këto diskutime dhe rrethanat e veçanta të procedurës së ndihmës juridike, mund të konsiderohet të lejohen gjykatat në atë situatë (kërkesa për ndihmë juridike bëhet para fillimit të procedurës) të kontrollojnë kryesisht kompetencën e tyre territoriale dhe të transferojnë kërkesën në gjykatën kompetente.

Kompetenca Funksionale

Ligji për Ndihmën Juridike nuk përcakton nëse vendimet për ndihmën juridike merren nga një gjyqtar i vetëm ose një trup gjykues i përbërë nga tre (ose më shumë) gjyqtarë.

Gjithashtu në Kodin e Procedurës Civile nuk ka ndonjë dispozitë specifike për këtë çështje. Neni 35 dhe Neni 158 dhe 158 / a janë dispozitat e përgjithshme përkatëse.

“Neni 35

Gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë nga **një gjyqtar ose tre gjyqtarë**.

Me trup gjykues të përbërë nga **tre gjyqtarë** gjykohen këto çështje:

- a) Paditë me vlerë më shumë se 50 milionë lekë.
- b) *Shfuqizuar*, paditë që kundërshtojnë aktet administrative që tejkalojnë vlerën e 20 milion lekëve vetëm nëse njëra nga palët e kërkon këtë në seancën paraprake, sipas Nenit 158 / a të këtij Kodi.
- c) Paditë për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së personit.
- ç) Paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave.

Çështjet e tjera gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

Gjykata e apelit shqyrton çështjen me trup gjykues të përbërë nga **tre gjyqtarë**. Gjykata e apelit shqyrton me **gjyqtar të vetëm** paditë me

vlerë deri në 150 000 lekë, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod.

Gjykata e Lartë gjykon në kolegji me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon në kolegje të bashkuara me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve, çështjet e parashikuara shprehimisht në dispozita të tjera të këtij Kodi.

Të gjitha masat dhe vendimet në **fazën paraprake** merren nga një gjyqtar i vetëm (Nenet 158 dhe 158a, Kodi i Procedurës Civile; shiko gjithashtu pikën 7 b **për fazën përgatitore**).

Nëse kërkesa është bërë para fillimit të procedurës gjyqësore, vlera e kërkesës (që është gjithashtu e rëndësishme për kompetencën funksionale) mund të përcaktohet (në vijim të Neneve 65 deri në 70 të Kodit të Procedurës Civile) sipas informacionit të dhënë nga kërkuesi në deklaratën e planifikuar e pretendimit.

iii. Procedura Penale

Vështrim i përgjithshëm

Në shumicën e rasteve (qoftë si mbrojtje e detyrueshme sipas Nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale ose sipas Nenit 21), avokati i ndihmës juridike do të emërohet tashmë nga organi procedues. Vetëm në rastet kur një palë aplikon për ndihmë juridike në një fazë të mëvonshme, avokati i ndihmës juridike caktohet nga gjykata.

Vështirë se ekziston një situatë kur një palë (siç mund të jetë më shpesh në procedurat civile) aplikon për ndihmë juridike para fillimit të procedurës penale. D.m.th., që problemet e përshkruara më lart për procedurat civile në lidhje me aplikimet para fillimit të procedurës vështirë se do të shfaqen në procedurat penale.

Kompetenca Funksionale

Nuk ka ndonjë dispozitë specifike për kompetencën funksionale të vendimeve për ndihmën juridike. Kështu vlen rregulli i përgjithshëm i Neneve 13 (shkalla e parë) dhe 14 (ankimi) Kodi i Procedurës Penale.

iv. Procedura para Gjykatave Administrative

Vërejtje të Përgjithshme

Në pajtim me Nenin 1 (2), dispozitat e Ligjit të Gjykatave **Administrative plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile**, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Shqyrtimi i Kompetencës

Neni 13 i Ligjit të Gjykatave Administrative është dispozita përkatëse e përgjithshme: Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit. Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave. Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente.

Kompetenca Funksionale

Ligji për Ndhimën Juridike nuk përcakton nëse vendimet për ndihmën juridike merren nga një gjyqtar i vetëm ose një trup gjykues i përbërë nga tre (ose më shumë) gjyqtarë.

Gjithashtu në Ligjin e Gjykatave Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile nuk ka ndonjë dispozitë specifike për këtë çështje. Neni 12 i Ligjit të Gjykatave Administrative është dispozita përkatëse e përgjithshme.

1. Gjykata administrative e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë me tre gjyqtarë mosmarrëveshjet lidhur me kontratat administrative publike dhe kërkesat e paraqitura në zbatim të shkronjave “d” dhe “dh” të Nenit 7 të këtij ligji. Të gjitha mosmarrëveshjet e tjera shqyrtohen **me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.**
2. Gjykata Administrative e Apelit gjykon me trup gjykues të përbërë:
 - a) me 3 gjyqtarë, ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;
 - b) me 5 gjyqtarë, paditë ndaj aktit nënligjor normativ.

6. Kërkesa

a. Përshkrim i përgjithshëm

Kërkesa mund të depozitohet **personalisht ose nëpërmjet postës** (Neni 19 (1)), gjithashtu edhe nëpërmjet një **përfaqësuesi ligjor** ose një përfaqësuesi të pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/sja ose një person me të cilin/cilën ka lidhje farefisnie të shkallës së parë (Neni 19 (2)).

Për detaje të mëtejshme në lidhje me përfaqësimin, siç janë personat e përjashtuar ose forma e prokurës, do të zbatohen rregullat e procedurës

përkatëse, p.sh. për Kodin e Procedurës Civile Neni 96 dhe Neni 14 i Ligjit për Gjykatat Administrative; ky i fundit i referohet dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkesa mund të depozitohet në **fazat që vijnë** (Nenet 19 (1), 22 (5)):

- përpara fillimit të një procesi gjyqësor,
- në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose
- në çdo fazë të një procesi gjyqësor derisa hetimi gjyqësor të mos jetë deklaruar i mbyllur (shikoni më pas për detaje për procedura specifike)

Kërkesa është e **përrjashtuar nga tarifat dhe kostot**.

Çdo kërkesë duhet të **regjistrohet** duke përfshirë të dhëna të mëtejshme të specifikuar në Nenin 7 të Udhëzimit Nr. 1, datë 08/03/2019 të Ministrisë të Drejtësisë për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.

b. Formularët

Aplikimi

- duhet të hartohet sipas **fletës së formularit të kërkesës** të miratuar nga Ministri i Drejtësisë (Neni 18) dhe sipas Nenit 19 (4)
- duhet të shoqërohet nga një **vetë-deklarim** i përbushjes së kriterëve për përfitim, siç përcaktohet në këtë ligj, sipas fletës së formularit të vetëdeklarimit së bashku me
- **dokumentacionin justifikues** sipas listës së dokumenteve që do të shërbejë për vërtetimin e përbushjes së kriterëve, të përcaktuar me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë.

Formularët do të plotësohen sipas Urdhrit Nr. 225 datë 25/3/2019 për Miratimin e Formularëve të Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti dhe do të jenë bashkangjitur këtij manuali si shtojcë.

c. Gabimet Formale

i. Përshkrim i përgjithshëm

Lind pyetja sesi duhet të procedojë gjykata nëse kërkesa ka gabime formale. Duket se tre skenarë janë të mundshme në praktikë:

- Skenari 1: Aplikanti nuk përdor formularët për kërkesën dhe vetë-deklarimin, por jep të gjitha informacionet që janë të nevojshme, në mënyrë që gjykata të mund të shqyrtojë se/nëse aplikanti përbush kriteret për ndihmë juridike.
- Skenari 2: Aplikanti nuk përdor formularët për kërkesën dhe vetë-

deklarimin dhe nuk jep të gjitha informacionet që janë të nevojshme, në mënyrë që gjykata të mund të shqyrtojë se/nëse aplikanti përmbush kriteret për ndihmë juridike.

- Skenari 3: Aplikanti përdor formularët për kërkesë dhe vetë-deklarim, por nuk i plotëson ato plotësisht ose me korrektësi dhe në këtë mënyrë nuk jep të gjitha informacionet që janë të nevojshme në mënyrë që gjykata të mund të shqyrtojë se/nëse aplikanti përmbush kriteret për ndihmë juridike.

Skenari 1: Kërkesa mund të hidhet poshtë vetëm kur “kushtet e përcaktuara në Nenet 11 dhe 12 të këtij ligji nuk përmbushen;” (shiko nenin 10 më sipër) ose “b) është dukshëm abusive ose haptazi e pabazuar.” Kjo do të thotë se vetëm për faktin, që aplikanti **nuk përdor formularët**, por **jep të gjitha informacionet dhe dokumentacionin** e nevojshëm për të shqyrtuar kërkesën e tij, aplikimi i tij për ndihmë juridike **nuk mund të hidhet poshtë**. Gjithashtu, duket se gjykata nuk ka asnjë bazë ligjore që t’i kërkojë aplikantit të korrigjojë kërkesën e tij duke përdorur formularët.

Skenaret 2 dhe 3:

Sipas nenit 12, aplikanti duhet të provojë se ka të ardhura dhe prona të pamjaftueshme.¹¹ Gjykata duhet të shqyrtojë kërkesën (neni 22 (1)) dhe pas shqyrtimit rrëzon kërkesën për ndihmë juridike kur nuk plotësohen kushtet e nenit 11 dhe 12. Çfarë duhet/mund të bëjë gjykata kur informacioni i dhënë nuk është i mjaftueshëm për të shqyrtuar plotësisht nëse janë përmbushur kushtet për ndihmë juridike? Mund të bëhen parashtrimet e mëposhtme:

Sipas nenit 22 (4) gjykata, “në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e legjislationit procedural”, pas shqyrtimit të kërkesës, do të pranojë (paragrafi a) ose rrëzojë (paragrafi b) kërkesën.

Neni 22 (3) tregon se gjykata duhet t’i kërkojë aplikantit që të plotësojë kërkesën e tij jo të plotë dhe jo thjesht të hedhë poshtë kërkesën: neni 22 (3) duhet të lexohet në atë mënyrë që gjykata të kërkojë jo vetëm nga organet e administratës shtetërore, që zotërojnë dokumentacionin që mungon, por **të kërkojë edhe nga vetë aplikanti që të japë informacione dhe dokumente të mëtejshme**. Kjo gjithashtu do të jetë në përputhje me nenin 154a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 25 (1) (a) Gjykatat Administrative.

¹¹ Shih Nenin 8 të Kodit të Procedurës Civile: Palët kanë detyrimin të paraqesin faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre; dhe Nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile: Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj.

ii. Neni 22 (3)

Neni 22 (3) përmban një dispozitë që trajton një situatë specifike ku

- aplikanti “deklaroi pamundësinë e sigurimit të dokumentacionit”, si dhe
- në çdo rast tjetër kur gjykata vlerëson se korigjimi ose plotësimi i kërkesës mund të jetë shkak për vonesa që ndikojnë në thelbin e të drejtave të aplikantit”.

Në këto rrethana gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e zotërojnë atë.

7. Shqyrtimi i Kërkesës

a. Shqyrtimi i Kërkesës në Përgjithësi

Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore në përputhje me dispozitat e legjislacionit procedural dhe sa më shumë të jetë e mundur, me dispozitat e Ligjit për Ndihmën Juridike (neni 22 (1)). Pyetja është, në cilin format shqyrtohet kërkesa dhe merret vendimi, p.sh. nëse vendimi merret në seancë gjyqësore apo jo.

b. Shqyrtimi i Kërkesës në Procedurat Civile

Sipas nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile “Gjykata e bazon vendimin e saj në provat e paraqitura nga palët ose nga avokati, të marra në seancë gjyqësore.” Kjo korrespondon me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile “Vendimi bazohet vetëm në të dhëna që janë në akte dhe që janë shqyrtuar në seancën gjyqësore”. Neni 172 përcakton se “Shqyrtimi i çështjes para gjykatës bëhet verbalisht, por palët mund të paraqesin me shkrim shpjegimet dhe pretendimet e tyre në lidhje me çështjen në gjykim.”

Pyetja është, nëse edhe për vendimet për ndihmë juridike duhet të ketë seancë gjyqësore apo, nëse vendimet për ndihmën juridike mund të merren pa seancë. Neni 22 (2) (b) (duke përcaktuar se vendimi merret “gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore”) tregon se vendimet për ndihmën juridike gjithashtu mund të merren pa seanca gjyqësore dhe jashtë seancave gjyqësore. Gjithashtu, neni 158a (2) (a) i Kodi të Procedurës Civile parashikon që me vendim, pa mbajtjen e një seanceje paraprake, gjykata përjashton “paditësin nga pagesa e tarifës në rastet e parashikuara me ligj dhe kur një kërkesë është bërë nga paditësi”. Sipas nenit 158b (2) të Kodit të Procedurës Civile seanca përgatitore do të mbahet vetëm për aq kohë sa thirrja dhe dëgjimi i palëve konsiderohet e nevojshme nga gjyqtari dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj. Kjo

do të thotë se në rastin që aplikimi depozitohet **para fillimit të procedurës ose në fazën përgatitore**, shqyrtimi dhe vendimi për kërkesën **nuk është marrë domosdoshmërisht në një seancë gjyqësore verbale**.

c. Shqyrtimi i Kërkesës në Procedurat e Gjykatave Administrative

Sipas nenit 3 (2) të Ligjit për Gjykatat Administrative, një gjykatë administrative, sipas natyrës së çështjes, do të shqyrtojë një çështje në seancë gjyqësore me gojë ose në dhomë këshillimi, bazuar në akte të shkruara. Dmth që në përgjithësi gjykata administrative mund të shqyrtojë dhe të vendosë për një kërkesë për ndihmë juridike **jashtë seancës gjyqësore** (shiko gjithashtu nenin 39 (1) të Ligjit për Gjykatat Administrative).

Në lidhje me veprimet përgatitore Neni 25 (1) (ç) i Ligjit për Gjykatat Administrative i referohet nenit 158a të Kodit të Procedurës Civile.

8. Vendimi për Kërkesën

a. Vendimet e Mundshme të Gjykatës

Gjykata në fund mund të pranojë ose hedhë poshtë kërkesën (Neni 22 (4)).

b. Koha e Vendimit (Neni 22 (2))

Koha e vendimit varet nga koha kur është depozituar aplikimi:

- Gjykata duhet të vendosë brenda 5 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, kur kërkesa është paraqitur **përpara fillimit** të procesit gjyqësor (paragrafi a);
- gjatë **veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore** përpara programimit të seancës gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur së bashku me deklaratën e pretendimit (paragrafi b);
- sipas dispozitave të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa është depozituar **gjatë shqyrtimit gjyqësor** (paragrafi c).

Paragrafi (a) (përpara fillimit):

Paragrafi (a) duhet të lexohet së bashku me nenin 22 (3). Neni 22 (3) përcakton se kur gjykata i drejtohet një organi të administratës shtetërore për dokumentacionin që mungon “kërkesa për ndihmë juridike dytësore konsiderohet se është paraqitur në fund të afatit të caktuar nga gjykata për paraqitjen e dokumentit që mungon nga ana e organit të administratës shtetërore”. I njëjti rregull zbatohet kur gjykata i kërkon aplikantit të plotësojë informacionin ose dokumentacionin e dhënë (shiko 7 b dhe c). Kjo do të thotë që afati prej 5 ditësh fillon vetëm pasi aplikimi të jetë i plotë.

Paragrafi (b) (gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore):

Dispozitat përkatëse duket se janë

- Neni 158a (2) (a) i Kodit të Procedurës Civile për vendime jashtë seancës paraprake: "Gjyqtari, me vendim, pa zhvilluar një seancë paraprake, do të udhëheqë rregullimet e mëposhtme: a) çliron paditësin nga pagesa e tarifës në instancat e parashikuara nga ligji dhe një kërkesë është bërë nga paditësi "dhe neni 25 (1) (ç) i Ligjit për Gjykatat Administrative që i referohet nenit 158a të Kodit të Procedurës Civile.
- Neni 158b i Kodit të Procedurës Civile për vendimet në seancën paraprake.

Paragrafi (c) (gjatë shqyrtimit gjyqësor):

Duket se nuk ka ndonjë dispozitë në Kodin e Procedurës Civile që përcakton një afat kohor deri kur mund të aplikohet për ndihmë juridike.

Sipas nenit 34 të Ligjit për Gjykatat Administrative seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, në masën që ato janë në përputhje me këtë ligj.

c. Lloji i Vendimit

i. Procedura Civile

Vendimi për ndihmë juridike mund të jetë

- Një vendim i ndërmjetëm (neni 125 Kodi i Procedurës Civile), ose
- Një vendim përfundimtar (neni 126 Kodi i Procedurës Civile) ose
- Një vendim jo përfundimtar (neni 127 Kodi i Procedurës Civile)

Duke marrë parasysh formulimin e këtyre tre neneve, duket se është **një vendim i ndërmjetëm** (neni 125 Kodi i Procedurës Civile). Një argument tjetër është se sipas nenit 22 (7) ankimi kundër hedhjes poshtë është një ankim i posaçëm (që sipas nenit 470 të Kodit të Procedurës Civile është ankimi kundër vendimeve të ndërmjetme; shiko gjithashtu nenin 315 të Kodit të Procedurës Civile).

Vendimi si për miratimin dhe për hedhjen poshtë të kërkesës për ndihmë juridike dytësore **do të arsyetohet** (neni 22 (6)).

d. Njoftimi i Vendimit të Gjykatës (Neni 23)

Vendimi i gjykatës për miratimin ose hedhjen poshtë të aplikimit duhet t'i njoftohet

- aplikantit
- personit që ka paraqitur kërkesën për ndihmën juridike dytësore, nëse nuk ka qenë aplikanti vetë;
- organit procedues, nëse zbatohen kushtet e Nenit 21 të këtij ligji (shiko pikën 13 në nenin 21 për çështjen se kujt duhet t'i njoftohet vendimi i organit procedues)
- Drejtorisë dhe
- dhomës vendore të avokatisë, në rast se është aprovuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore.

Drejtoria mban një regjistër të kërkesave dhe vetë-deklarimeve. Për përmbajtjen e tij, zbatohet neni 7 i Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë për “Miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.

9. Procedura e Ankimit (neni 22 (7) deri në (9))

a. Përshkrim i përgjithshëm

Ligji për Ndihmën Juridike ka dispozita të ndryshme për ankimet kundër miratimit (Neni 22 (7) dhe (8)) dhe hedhjes poshtë (Neni 22 (9)) të aplikimit për ndihmë juridike.

b. Ankimi kundër Hedhjes Poshtë (Neni 22 (7) dhe (8))

i. Ligji për Ndihmën Juridike

Dispozitat për procedurën e ankimit në Ligjin për Ndihmën Juridike janë të orientuara qartë në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe pjesërisht përdorin terminologjinë e Kodit të Procedurës Civile.

Ankimi kundër hedhjes poshtë është një apel i posaçëm (shih nenin 470 të Kodit të Procedurës Civile).

Ankimi **nuk pengon vazhdimin** e gjykimit të çështjes.

Ankimi duhet të bëhet me anë të **një formulari të posaçëm**. Mund të gjendet në Shtojcën VIII të Urdhrit Nr. 225 datë 25/3/2019 për Miratimin e Formularëve të Ndihmës Juridike të garantuar nga Shteti.

Procedura në gjykatën e apelit:

Gjykata e apelit vendos në dhomën e këshillimit (shiko nenin 465a të Kodit të Procedurës Civile) dhe merr vendimin brenda 15 ditëve nga marrja e akteve. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekursi.

ii. Procedura Civile

Çështjet e mëposhtme nuk janë rregulluar në Ligjin për ndihmën juridike. Prandaj, zbatohet Kodi për Procedurën Civile:

Ligji për Ndhimën Juridike nuk rregullon **afatet kohore** për ankim, por përcakton se ankimi i aplikantit është një ankim i posaçëm. Kështu zbatohet neni 443 Kodi i Procedurës Civile: ankimet e posaçme duhet të depozitohen brenda 5 ditësh.

Ankimi duhet t'i paraqitet gjykatës, e cila ka dhënë vendimin kundër të cilit bëhet ankimi (Neni 446 i Kodit të Procedurës Civile).

Ligji për Ndhimën Juridike nuk e rregullon atë/nëse ankimi duhet t'u njoftohet palëve. Kështu zbatohet neni 447 i Kodit të Procedurës Civile: ankimi **u njoftohet** palëve, d.m.th. në këtë rast edhe Drejtorisë.

Meqenëse nuk ka asnjë dispozitë kundërshtuese në Ligjin për Ndhimën Juridike, Drejtoria mund të bëjë një apel kundërshtues në kuptimin e nenit 456 të Kodit për Procedurën Civile.

iii. Procedura Penale

Neni 21 (4) dhe (5) përmban rregulla se çfarë mund të bëjë aplikanti nëse kërkesa e tij për ndihmë juridike refuzohet (shiko për detaje pikën 13 d vii). Konsideratat e mëposhtme vlejné vetëm për (raste të rralla të mundshme), ku neni 21, pikat (4) dhe (5) nuk janë të zbatueshme.

Ligji për Ndhimën Juridike nuk rregullon **afatet kohore** për ankim. Kështu, zbatohet neni 415 i Kodit të Procedurës Penale: afati i paraqitjes së ankimit është pesëmbëdhjetë ditë.

Ankimi depozitohet në sekretarinë e gjykatës, e cila nxori vendimin e apeluar (neni 413 i Kodit të Procedurës Penale).

Ankimi **do t'i njoftohet** prokurorit, të pandehurit dhe palëve private nga sekretarja e gjykatës që ka dhënë vendimin (neni 414 i Kodit të Procedurës Penale).

Sipas nenit 423 të Kodit të Procedurës Penale, pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit kohor mund të depozitojë **kundër-ankim** brenda pesë ditësh nga dita kur ka marrë njoftimin për ankimin e palës tjetër.

iv. Procedura Administrative

Sipas nenit 44 të Kodit për Gjykatat Administrative mjetet dhe afatet e apelit janë të njëjta me ato të parashikuara në **Kodin e Procedurës Civile**, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

c. Ankimi kundër Miratimit (Neni 22 (9))

i. Ligji për Ndhmën Juridike

Sipas formulimit të nenit 22 (9) Drejtoria mund të apelojë (vetëm) kundër pranimit kur pretendon se kërkesa është dukshëm abuzive ose qartazi e pabazuar dhe jo nëse pretendon se aplikanti nuk i përmbush kriteret e neneve 10 deri 12. Do të duhet të sqarohet nëse arsyet e apelimit ishin të kufizuara qëllimisht apo nëse referenca për nenet 10 deri 12 nuk ishte përfshirë gabimisht.

Meqenëse neni 22 (9) nuk (në kundërshtim me nenin 22 (7)) nuk i referohet ankimit të posaçëm, zbatohen **dispozitat për ankimet normale**. Neni 22 (9) përcakton se “Në këtë rast do të zbatohen afatet dhe rregullat e apelimit të vendimeve përfundimtare në përputhje me dispozitat e legjislacionit procedural”. Kështu zbatohen afatet dhe rregullat e apelimit të vendimeve përfundimtare në përputhje me dispozitat e legjislacionit procedural. Domethënë se rregullat e ndryshme procedurale zbatohen për ankimin e Drejtorisë kundër miratimit sesa për ankimin kundër refuzimit.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë.

ii. Procedura Civile

Çështjet e mëposhtme nuk janë rregulluar në Ligjin për Ndhmën Juridike. Prandaj, zbatohet Kodi për Procedurën Civile:

Ligji për Ndhmën Juridike nuk rregullon **afatet kohore** për një ankim. Kështu, zbatohet neni 443 i Kodit të Procedurës Civile: ankimi duhet të depozitohet brenda 15 ditësh.

Ankimi duhet t’i paraqitet gjykatës, e cila ka dhënë vendimin kundër të cilit bëhet ankimi (neni 446 i Kodit të Procedurës Civile).

Ligji për Ndhmën Juridike nuk e rregullon atë/nëse ankimi duhet t’u njoftohet palëve. Kështu zbatohet neni 447 i Kodit të Procedurës Civile: ankimi **u njoftohet** palëve. Gjithashtu, aplikanti duket se është një palë në atë sens.

Meqenëse nuk ka asnjë dispozitë kundërshtuese në Ligjin për Ndhmën Juridike, aplikanti mund të bëjë **një apel kundërshtues** në kuptimin e nenit 456 të Kodit të Procedurës Civile.

Për këtë rast (ankim kundër miratimit) nuk ka asnjë dispozitë që korrespondon me nenin 22(7) (“Ankimi i vendimit nuk pengon **vazhdimin**”

gjykimit të çështjes”). Meqenëse nuk ka asnjë dispozitë kundërshtuese në Ligjin për Ndhimën Juridike, sipas nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile “Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet derisa Gjykata e Apelit të ketë përfunduar shqyrtimin”. Domethënë vendimi për ndihmën juridike hyn në fuqi vetëm pasi gjykata e apelit të ketë vendosur për ankimin. Duke thënë se nuk ka ndonjë dispozitë që parashikon se dhoma vendore e avokatëve duhet të informohet në lidhje me ankimin kundër miratimit ose që në rast të një ankimi kundër miratimit, avokati i zgjedhur nuk mund të jetë aktiv. Përkundrazi: Sipas nenit 24 (4) avokati “menjëherë pasi të njihet me vendimin e gjykatës kompetente dhe vendimin e dhomës vendore të avokatisë ose vendimin e organit procedues për emërimin e tij si avokat për dhënien e ndihmës juridike dytësore, do të hyjë në kontakt me personin të cilit i është dhënë ndihma juridike dytësore dhe do të fillojë me ofrimin e shërbimeve të kërkuara”. Neni 24 (4) nënkupton që duhet parë si një dispozitë e veçantë e nenit 449 të Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë që edhe nëse Drejtoritë apelojnë miratimin e ndihmës juridike, avokati i caktuar mund dhe duhet të bëhet aktiv. Nga ana tjetër, neni 1 i Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrisë të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” i referohet ndihmës juridike “në favor të personave që kanë përfituar sipas një vendimi përfundimtar të gjykatës kompetente”.

Meqenëse Neni 22 (9) (në ndryshim nga Neni 22 (7)) nuk i referohet ankimit të posaçëm, zbatohen **dispozitat për ankimin e posaçëm**. Këto janë veçanërisht Nenet nga 460 në 465 të Kodit të Procedurës Civile.

iii. Procedura Penale

Në rastet e trajtuara në Nenin 21, nuk ka apelim ndaj miratimit të ndihmës ligjore.

Për rastet sipas Nenit 22, shih sa më sipër.

Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit, përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji (neni 417 i Kodit të Procedurës Penale). Shihni për të njëjtën çështje paragrafin më lart për procedurat civile.

iv. Procedura Administrative

Sipas nenit 44 të Ligjit për Gjykatat Administrative mjetet dhe afatet e apelit janë të njëjta me ato të parashikuara në **Kodin e Procedurës Civile**, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Gjykata Administrative e Apelit e shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga

data kur ankimi vjen nga gjykata ku është paraqitur ankimi (neni 48 (2) i Ligjit për Gjykatat Administrative).

Ankimi në Gjykatën e Apelit si rregull shqyrtohet në bazë të dokumenteve në dhoma (neni 49 (1) i Ligjit për Gjykatat Administrative).

10. Caktimi i Avokatit (Neni 24)

a. Praktika gjyqësore relevante e GJEDNJ-së

Në çështjen *Croissant k. Gjermanisë* GJEDNJ-ja parashtroi se dëshirat e aplikantit nuk duhet të injorohen, por zgjedhja e avokatit – duke marrë në konsideratë interesat e drejtësisë – është për Shtetin, në fund të fundit.

Pavarësisht nga rëndësia e marrëdhënies së besimit midis një avokati dhe klientit të tij, kjo e drejtë nuk është absolute. Ajo është domosdoshmërisht subjekt i disa kufizimeve kur bëhet fjalë për ndihmë juridike falas (*Almasi kundër Serbisë*).

Në çështjen *Daud k. Portugalisë*, avokati i ndihmës juridike u caktua vetëm tre ditë para gjyqit për një çështje serioze, komplekse. GJEDNJ-ja parashtroi se ishte qartësisht evidente për autoritetet shtetërore se avokati i ndihmës juridike nuk kishte kohë të përgatitej për gjyqin dhe se ata duhet të kishin ndërhyrë për të siguruar cilësinë e mbrojtjes.

b. Përshkrim i përgjithshëm

Rregulla të ndryshme zbatohen në varësi të dhënies së ndihmës juridike nga organi procedues (neni 21; shiko më poshtë pikën 13) apo nga gjykata. Ky paragraf trajton **situata që nuk mbulojnë nga neni 21** (shiko nenin 23 (3) dhe (6) (a)).

Vendimi i gjykatës për ndihmën juridike duhet t'i njoftohet **Dhomës Vendore të Avokatëve** (Neni 23 (d)). Sipas formulimit të Nenit 23 (d) vendimi I miratimit duhet t'i njoftohet dhomës përpara se të jetë e qartë nëse Drejtoria e apelon këtë vendim dhe në këtë mënyrë para se të bëhet e ditur nëse vendimet bëhen përfundimtare dhe hyjnë në fuqi (lexoni për këtë problem më sipër në 9 c).

Më pas, Dhoma Vendore e Avokatëve cakton avokatin (nëse nuk zbatohet neni 21)

- nga lista e avokatëve
- që kanë kontratë një-vjeçare me Drejtorinë
- sipas parimit të rotacionit.

Dhoma ja dërgon vendimin e saj për caktimin e avokatit specifik së

bashku me vendimin e gjykatës avokatit dhe palës.

Avokati duhet të kontaktojë palën menjëherë. Detajet e mëtejshme rregullohen nga aktet nënligjore përkatëse (shih pikat 10 c deri f). Pika 11 merret me zëvendësimin e avokatit.

c. Aktet nënligjore

Janë miratuar akte nënligjore mbi parimin e rotacionit (Neni 21 (6) dhe Neni 9 (b)), kontratat model, tarifat e shpërblimit dhe zgjedhjen e avokatëve (Neni 9 (a)). Këto janë:

- Kontratat model me avokatët (Shtojca 2 e Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për ‘Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti’ dhe Vendimi i Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal)
- Kriteret e shpërblimit dhe procedura e pagesës (Udhëzimi i Përbashkët Nr. 18, datë 5.8.2020, për miratimin e kriterëve për marrjen e pagesave dhe tarifat e shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore)
- Parimi i rotacionit (Kriteret dhe procedura për zgjedhjen e avokatëve)
- Vendimi i Këshillit të Prokurorisë, Nr. 231, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e mbrojtësit bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal.
- Udhëzimi i Përbashkët Nr. 17, datë 05.08.2020 për rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative

d. Kontrata ndërmjet Avokatit dhe Drejtorisë (Të drejtat dhe detyrimet e avokatit)

Avokati që ofron ndihmë juridike dytësore lidh një **kontratë** me Drejtorinë. Kjo kontratë rregullohet me Shtojcën 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”. Kontrata është e vlefshme për një afat prej një viti nga data e nënshkrimit, por në çdo rast deri në miratimin e listës së re dhe lidhjes së kontratave të reja (neni 2.1 i Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”). Ndërprerja e kontratës nuk e pengon avokatin të përfaqësojë përfituesin deri në

zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përveçse kur ekzistojnë rrethanat për zëvendësimin e tij (neni 2.2 i Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”). Avokati mund të zgjidhë kontratën, duke njoftuar paraprakisht dhomën vendore të avokatisë. Në këtë rast, avokati do të vazhdojë t’i ofrojë Ndihmë Juridike Dytësore Përfituesit deri në zëvendësimin e tij nga dhoma vendore e avokatisë (neni 9.3 i Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”).

Neni 5 i Shtojcës 2 të Urdhrit nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përcakton më tej **detyrat dhe detyrimet** e avokatit. Ato ndër të tjera janë si më poshtë:

Avokati do të veprojë në kohë dhe pa shkaktuar vonesa, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga dhoma vendore e avokatisë, për vendimin e gjykatës, e cila ka pranuar kërkesën për dhënien e ndihmës juridike dytësore për Përfituesin. Avokati mban kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me përfituesin për ta mbajtur atë vazhdimisht të informuar për çështjen për të cilën ofrohet ndihma juridike dytësore.

Në përfundim të punës, avokati, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, paraqet një raport.

e. Lista e Avokatëve (Kapitulli I i Udhëzimit të Përbashkët Nr. 17, datë 05.08.2020, mbi rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative)

i. Vështrim i përgjithshëm

Është hartuar lista e avokatëve të interesuar për të marrë përsipër ndihmën juridike dytësore në procedurat civile dhe administrative

- veçmas për secilën dhomë lokale të avokatëve
- për çdo vit kalendarik
- sipas rregullave të përcaktuara në Kapitullin I të këtij udhëzimi.

ii. Procedura për Hartimin e Listës së Avokatëve

Pasi të jetë publikuar një thirrje për shprehje interesi, avokatët duhet të paraqesin brenda afatit të caktuar shprehjen e interesit duke plotësuar formularin e **aplikimit** (sipas modelit të përcaktuar).

Nga këto aplikime, avokatët tërhiqen me short, i cili organizohet nga një

sekretariat teknik (që do të themelohet): Dhoma Shqiptare e Avokatisë do të caktojë datën e organizimit të **shortit** në ambientet e përshtatshme dhe do të njoftojë paraprakisht Kryetarët e Dhomave Lokale të Avokatisë, Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Renditja e avokatëve në listën e avokatëve që ofrojnë shërbime dytësore të ndihmës juridike për secilën dhomë bëhet me short.

Rezultatet e shortit së bashku me një raport mbi procesin e organizimit të lotarisë do të bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë. Miratimi i listave përfundimtare të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, bëhet nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, përmes shortit.

Lista e avokatëve për secilën dhomë përmban gjithashtu informacione mbi specializimin e avokatit në fushën e së drejtës, kur specializimi është i domosdoshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, viktimave dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj. Pas miratimit përfundimtar të listave, ato përcillen për botim në faqen zyrtare të DHKA-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Lista e aprovuar e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas dhomave lokale të avokatisë, do të jetë e vlefshme deri më 31 janar të vitit pasardhës.

f. Përzgjedhja e Avokatit Individual (Kapitulli II i Udhëzimit të Përbashkët Nr. 17, datë 05.08.2020 mbi rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative)

i. Përzgjedhja e Avokatit

Dhoma lokale e avokatëve emëron brenda 8 orëve nga vendimi i gjykatës për të pranuar kërkesën për sigurimin e ndihmës juridike dytësore një avokat nga lista e avokatëve sipas radhës në listë, duke filluar me avokatin të renditur në vendin e parë. Dhoma lokale njofton menjëherë Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për emërimin e një avokati.

Përzgjedhja e avokatëve me rotacion bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme nga lista, duke filluar nga avokati i renditur i pari dhe në rend zbritës.

Në rast se numri i vendimeve gjyqësore për pranimin e kërkesave për dhënie të ndihmës juridike dytësore është më i madh se numri i avokatëve që ofrojnë këtë shërbim, Dhoma Lokale e Avokatisë do të emërojë avokatë duke filluar nga avokati i parë i renditur në listë, dhe më tej në rend zbritës.

Në rast se shërbimi që do të kryhet kërkon njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara nga ligji, Dhoma Lokale e Avokatisë emëron avokatin e parë, të renditur, i cili është i specializuar në fushën përkatëse të ligji. Për çdo çështje tjetër që kërkon njohuri të specializuara në të njëjtën fushë të ligjit, do të emërohet një avokat i renditur më poshtë në listë dhe i specializuar në atë fushë të ligjit.

Në rast se lista e aprovuar e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore nën juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë që kanë njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara nga ligji, *Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë* pas njoftimit të marrë nga dhoma lokale do të emërojë një nga avokatët nga radhët e avokatëve, të cilët janë të specializuar në fushën më të afërt të kërkuar nga lista e miratuar e Dhomës Lokale të Avokatisë. Në një rast të tillë, emërimi i një avokati do t'i njoftohet gjithashtu Dhomës Lokale të Avokatëve, e cila ka avokatin nën juridiksionin e saj.

ii. Procedura e emërimit

Dhoma Lokale e Avokatëve do të kontaktojë me telefon dhe me postë elektronike avokatin e zgjedhur. Në rast se avokati, pas njoftimit të tij, refuzon të marrë përsipër detyrën, do të kontaktohet avokati tjetër në listë. Refuzimi për të marrë detyrën bëhet nga avokati me shkrim, duke specifikuar arsyet e refuzimit.

Nëse avokati nuk i përgjigjet thirrjes / postës elektronike, atij / asaj i jepet një kohë e arsyeshme, por në çdo rast, jo më shumë se 24 orë, për t'u përgjigjur. Në rast të moskthimit të thirrjes / postës elektronike, dhoma lokale e avokatisë menjëherë do të thërrasë avokatin tjetër në listë.

Pas marrjes së konfirmimit nga avokati, sipas procedurës së mësipërme, dhoma lokale e avokatisë vendos për emërimin e një avokati me modelin e parashikuar.

Dhoma lokale e avokatëve ia përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj për emërimin e një avokati personit, kërkesa e të cilit për ndihmë juridike dytësore ishte pranuar.

11. Zëvendësimi i Avokatit

a. Praktika Gjyqësore Relevante e GJEDNJ-së

Nëse avokati i ndihmës juridike nuk arrin të sigurojë përfaqësim efikas dhe kjo është shfaqur ose është sjellë në vëmendjen e autoriteteve

shtetërore, atëherë Shteti ka për detyrë të ndërhyjë dhe të korrigjojë mospërfaqësimin (*Kamasinski k. Austrisë*).

E drejta për ndihmë juridike falas nuk përmbushet me caktimin zyrtar të një avokati: kjo e drejtë duhet të jetë praktike dhe efikase (shiko *Artico k. Italisë*; gjithashtu Gjykatën Kushtetuese Shqiptare Nr.73/2015; nr. 6/2013; nr. 37/2011; nr. 25/2011).

Një individ i cili kërkon një ndryshim të avokatit të ndihmës juridike duhet të paraqesë prova se avokati nuk arriti të performojë në mënyrë të kënaqshme (Lagerblom kundër Suedisë).

b. Ligji për Ndhimën Juridike

Rregulla të ndryshme zbatohen në varësi të ofrimit të ndihmës juridike nga organi procedues (Neni 21; shiko poshtë pika 13) apo gjykata. Ky paragraf trajton **situatat që nuk mbulohen nga Neni 21** (shiko Nenin 23 (3)).

Dhoma vendore e avokatëve duhet të zëvendësojë avokatin nëse ka një **konflikt interesi** (Neni 23 (5) dhe (6) (b)).

c. Akti nënligjor

i. Urdhri i Ministrisë të Drejtësisë Nr. 226, datë 25/3/2019, për 'Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuara nga shteti'

Përveç Nenit 23 (5) dhe (6) **Neni 5.2. i Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrisë të Drejtësisë**, datë 25/3/2019 për "Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti" përcakton se avokati nuk do të heqë dorë nga ofrimi i ndihmës juridike detyësore, përveçse në **rastet e heqjes dorë të përcaktuara nga Ligji i Avokatisë**, duke përfshirë, por pa u kufizuar në çështjen e konfliktit të interesit. Në çdo rast të detyrimit të heqjes dorë, avokati do të informojë menjëherë dhomën vendore të avokatisë, me qëllimin e zëvendësimit të tij/të saj. Në këtë rast, avokati do të vazhdojë të ofrojë ndihmë juridike detyësore deri në zëvendësimin e tij/të saj, sipas dispozitave të Ligjit për Avokatinë dhe do të zbatojë të gjitha detyrimet e dhëna në Ligjin për Avokatinë.

ii. Kapitulli II i Udhëzimit të Përbashkët Nr. 17, datë 05.08.2020 mbi rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në emërimin e avokatëve, të cilët do të ofrojnë ndihmë juridike detyësore në proceset civile dhe administrative

Nëse avokati i caktuar për të siguruar ndihmë juridike ka **pengesa ligjore** sipas parashikimeve të nenit 9, të Ligjit Nr. 55/2018 "Për Profesionin e

Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ai / ajo do t’i drejtojë një kërkesë të arsyetuar dhomës lokale të avokatisë (shih tashmë pikën 11 c I më lart). Nëse dhoma lokale e avokatëve gjykon se kërkesa përmban arsye të arsyeshme, ajo do të zëvendësojë avokatin i cili ka hequr dorë nga përfaqësimi duke njoftuar menjëherë Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Avokati zëvendësues do të emërohet duke iu referuar numrit të parë të lirë në listën e avokatëve.

Kur dhoma lokale e avokatisë e vlerëson kërkesën si të **pabazuar**, ajo do të refuzojë zëvendësimin e avokatit. Në rast se avokati përsëri refuzon të marrë pjesë në seancë dëgjimore, dhoma lokale e avokatisë do të fillojë procedurën e zëvendësimit dhe do të njoftojë Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për fillimin e procedurave disiplinore. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai / ajo të zëvendësohet nga një avokat tjetër nga dhoma lokale e avokatisë.

12. Pagesa e Avokatit

a. Ligji për Avokatët

Neni 16 i Ligjit për Avokatinë përcakton se pagesa e avokatit për punën e kryer do të vendoset, ndër të tjera, “b) në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

b. Ligji për Ndhmën Juridike

Avokati paguhet sipas **skemës së pagesës** të vendosur nga Ministria e Drejtësisë (Neni 7 (g)) nga Drejtoria (shiko pikën d për mbrojtjen e detyrueshme, në vijim të dispozitave të Nenit 49 (7) dhe Neni 49/a të Kodit të Procedurës Penale).

c. Aktet nënligjore në përgjithësi

Sipas Nenit 5 (2) (iv) të Shtojcës 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti” avokati do të ofrojë ndihmë juridike dytësore në favor të Përfituesit, **vetëm me Tarifë Shërbimi**, pa pasur të drejtë për përfitime të tjera, përveçse për Tarifë Shërbimi (shiko gjithashtu Nenin 6, Shtojcën 2 të Urdhrit Nr. 226 të Ministrit të Drejtësisë, datë 25/3/2019 për “Miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”).

d. Akt nënligjor për Procedurat Penale

(Vendimi Nr. 231 i Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së

detyrueshme dhe caktimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proces penal)

Sipas Nenit 38 të këtij Vendimi, shpërblimi për punën e kryer nga avokati gjatë procesit të ofrimit të ndihmës juridike falas do të kryhet nga:

- **Drejtoria** për ndihmën juridike për njerëzit pa mjete financiare të mjaftueshme;
- **Prokuroria** do ta bëjë ndihmën juridike në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, në vijim të dispozitave të nenit 49 (7) dhe nenit 49/a të Kodit të Procedurës Penale.

a. Akti nënligjor për tarifën dhe pagesën e avokatëve (Udhëzim i Përbashkët Nr. 18, datë 5.8.2020, për miratimin e kriterëve për marrjen e pagesave dhe tarifave të shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore)

i. Kriteret / Procedura e Shpërblimit

Pas përfundimit të procedurave të ndihmës juridike, avokati duhet të paraqesë pranë Drejtorisë formularin për shpërblimin dhe të shtojë disa dokumente të caktuara.¹²

Kur avokati heq dorë nga ofrimi i ndihmës juridike dytësore, ai nuk do të ketë të drejtë kompensimi për shërbimin e ofruar.

ii. Tarifën dhe Shpenzimet e Shpërblimit

Avokatët kanë të drejtë për

- tarifa (siç parashikohet në aneksin e udhëzimit) dhe
- rimbursimin e shpenzimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punësimit, brenda vendit".

Aneksi i udhëzimit parashikon tarifën e mëposhtme:

¹² Fatura tatimore për shërbimin që është ofruar; kopjet e vendimit të gjykatave që janë dhënë për çështjen ose kopjet e akteve të tjera, të përpiluara sipas shtojcës 1; raportin e përfundimit të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

1. NDIHMA JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE		Tarifat
1	Përfaqësimi në çështjet penale	
	Shërbimi në lidhje me ndalimin dhe arrestimin deri në ndryshimin e masës së sigurisë	15 000
2	Ndihma juridike për hetimin paraprak deri në dërgimin e çështjes në gjykatë	
	Për kundërvajtjet penale	20 000
	Për krime që dënohen deri në 10 vjet burg në gjykatën e rrethit gjyqësor	50 000
	Për krime që dënohen me më shumë se 10 vjet burg në Gjykatën Speciale të Shkallës së Parë për korrupsion dhe krim të organizuar	60 000
3	Ndihmë ligjore dhe për gjykime në shkallë të parë	
	Për kundërvajtjet penale	20 000
	Për krime që dënohen deri në 10 vjet burg në gjykatën e rrethit gjyqësor	30 000
	Për krime që dënohen me më shumë se 10 vjet burg në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor	80 000
	Për krimet e gjykuara në Gjykatën Speciale të Shkallës së Parë për korrupsion dhe krim të organizuar	96 000
4	Ndihma juridike për gjykime në gjykatat e apelit, gjykatën e lartë dhe gjykatën kushtetuese	
	Për gjykimet në gjykatat e apelit	40 000
II. NDIHMA JURIDIKE NË FUSHËN CIVILE DHE ADMINISTRATIVE		
1	Përfaqësimi në shkallën e parë	
	Përfaqësimi në shkallën e parë, pa palë kundërshtarë	15 000
	Përfaqësimi në shkallën e parë, me palë kundërshtarë	40 000
2	Përfaqësimi në gjykatën e apelit, gjykatën e lartë dhe atë kushtetuese	
	Përfaqësimi në gjykatën e apelit	45 000

	Përfaqësimi në gjykatën e lartë dhe atë kushtetuese	60 000
3	Shërbime juridike jashtë-gjyqësore	
	Përgatitja e ankesës	15 000
	Rekursi në Gjykatën e Lartë dhe Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese	25 000
	Sigurimi i ndihmës juridike në formë këshillimi	500 - 15 000 ALL/orë
III. SHËRBIME TË TJERA JURIDIKE		
	Shërbime të tjera juridike të cilat nuk janë përfshirë në pikat e mësipërme	

13. Procedurat Penale – Neni 21 (Organi Proceudes)

a. Marrëdhënia ndërmjet Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Ndhimën Juridike – Përshkrim i Përgjithshëm

Ndihma juridike dytësore sipas Ligjit për Ndhimën Juridike zbatohet për “ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në (...) çështjet penale për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme në përrputhje me legjislacionin procedural penal” (Neni 3 (c) i Ligjit për Ndhimën Juridike).

Kjo korrespondon me Nenin 49 (7) të Kodit të Procedurës Penale ndërkohë që “mbrojtja nuk mund të sigurohet në përrputhje me këtë dispozitë dhe paragrafin 3 të nenit 49, ajo garantohet nga institucionet që ofrojnë ndihmë juridike falas, në përrputhje me legjislacionin në fuqi.”

Kjo do të thotë se dispozitat për ndihmën juridike dytësore të Ligjit për Ndhimën Juridike zbatohen vetëm kur nuk zbatohen dispozitat për mbrojtje të detyrueshme të Kodit të Procedurës Penale.

Si hap i parë në paragrafët vijues, dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale do të përshkruhen shkurtimisht.

Edhe nëse zbatohet Ligji për Ndhimën Juridike, neni 21 dhe disa paragrafë të tjerë përmbajnë rregulla të veçanta për Ndhimën Juridike në fazën e hetimit nga Organi Proceudes.

Neni 21 (7) rregullon se “Rregullat e hollësishme në lidhje me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, miratohen nga Këshilli i

Lartë i Prokurorisë". Këto rregulla mund të gjenden në **Vendimin Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë**, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimit të avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal. Ky vendim përmban dispozita për përzgjedhjen, zëvendësimin, pagesën dhe të drejtat e detyrimit e avokatëve sipas nenit 49 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Ndihmën Juridike.

b. Kodi i Procedurës Penale

i. Përshkrim i Përgjithshëm

Dy dispozita në Kodin e Procedurës Penale janë relevante në mënyrë të veçantë:

- Mbrojtja e detyrueshme (Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale) (i cili zbatohet pavarësisht nga mjetet financiare)
- I padituri pa mjete financiare të mjaftueshme (Neni 49/a i Kodit të Procedurës Penale)

ii. Mbrojtja e Detyrueshme (Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale)

Autoriteti procedues do të ofrojë menjëherë një avokat të paguar nga shteti për të pandehurin, i cili nuk ka caktuar ose nuk e ka mbajtur më avokatin mbrojtës, nëse plotësohen një nga nëntë kategoritë që vijojnë të të pandehurve ose situatat procedurale ku aplikohet mbrojtja e detyrueshme. Ato janë si më poshtë:

I padituri:

- a) është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç;
- b) është i shurdhër dhe i heshtur;
- c) ka aftësi të kufizuara që pengojnë aftësinë e tij për t'u mbrojtur;
- ç) akuzohet për një vepër penale, e dënueshme me burgim jo më pak se 15 vjet, në afatin maksimal;
- d) akuzohet për një vepër penale penale, në përputhje me shkronjat "a" dhe "b", të nenit 75/a, të këtij Kodi;
- d) është shpallur i arratisur ose në mungesë me vendim gjyqësor;
- e) personi i arrestuar ose i ndaluar merret në pyetje;
- ë) në rastet e parashikuara në paragrafin 5 të nenit 205 ose në paragrafin 1 të nenit 296 të këtij Kodi;
- f) në çdo rast tjetër të parashikuar me ligj".

Avokati mbrojtës **caktohet** nga organi procedues (neni 49 (2) i Kodit të Procedurës Penale) sipas listës së Dhomës së Avokatisë (neni 49 (3) i

Kodit të Procedurës Penale); shiko pikën 13 d për detaje).

Avokati i caktuar **i pushon** funksionet e tij nëse caktohet një avokat i mbajtur nga pala.

Avokati e ndihmon të pandehurin gjatë të gjitha fazave të procedurës, për sa kohë që ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 (1) të Kodit të Procedurës Penale.

Nëse kërkohet prania e avokatit dhe nuk ka avokat të mbajtur ose të emëruar nga pala, nuk është paraqitur ose nuk është tërhequr nga mbrojtja, gjykata ose prokurori e dënon me gjobë avokatit (neni 350 (4) i Kodit të Procedurës Penale). Nëse mungesa e tij është e justifikuar, gjykata ose prokurori **mund të caktojë një avokat tjetër** në zëvendësim, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrat e avokatit.

Sipas nenit 21 (7) të Ligjit për Ndhmën Juridike **rregulla të hollësishme** në lidhje me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale do të miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kjo është bërë me Vendimin **Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë**, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal (shiko pikën 13 d për detaje).

iii. Mbrojtja sipas Nenit 49a të Kodit të Procedurës Penale

Neni 49a i Kodit të Procedurës Penale përcakton sa vijon:

“Kur nuk janë rastet e mbrojtjes së detyrueshme dhe i pandehuri që nuk ka mjete financiare të mjaftueshme kërkon mbrojtës, organi procedues cakton mbrojtësin nga lista e vënë në dispozicion nga institucionet e ndihmës juridike falas. Shpenzimet e mbrojtjes mbuloohen nga shteti”.

Neni 49a i Kodit të Procedurës Penale duhet të lexohet në lidhje me dhe në kuadrin e Ligjit për Ndhmën Juridike. Në rastet kur nuk zbatohet Neni 49 i Kodit të Procedurës Penale për mbrojtjen e detyruar, kriteret dhe procedurat për ndihmën juridike zbatohen sipas Ligjit për Ndhmën Juridike. Ligji për Ndhmën Juridike parashikon ndihmën juridike dytësore vetëm kur përfituesi ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme (Neni 12), por, pavarësisht nga mjetet financiare të përfituesit, gjithashtu edhe për anëtarë të grupeve të caktuara.

Një ndër problematikat me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është hasur në praktikë lidhet me mbrojtjen e detyrueshme të të pandehurve në proces gjyqësor. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bërë disa kërkesa drejtuar Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përmes të cilave ka kërkuar garantimin e mbrojtjes së detyrueshme për 6 të pandehur, në kushtet kur mbrojtësit e zgjedhur kryesisht nuk janë paraqitur në seancat gjyqësore në mënyrë të përsëritur.

Në këtë pikë, përballemi me dy sisteme të ndryshme: Nga njëra anë sistemi i avokatëve të ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti dhe nga ana tjetër sistemi i avokatëve mbrojtës të caktuar kryesisht.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, në nenin 49 të tij ka parashikuar se: *“Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi”*. (ligji nr.111/2017”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”).

Sipas ligjit 111/2017, *“ndihma juridike dytësore”* është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe **në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.**

Gjithashtu, në vendimin e KLP nr. 231, datë 12.11.2019, i cili ka miratuar rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal, parashikohet se: *“Kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të sigurohet nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtja garantohet nga lista e avokatëve që ofrojnë Ndihmë Juridike Dytësore në procesin penal”*.

Nëse i referohemi dispozitave ligjore të mësipërme, qëllimi i tyre nuk është të mbivendosen dy sistemet e sipërpërmendura, por të jenë plotësues të njëri-tjetrit në funksion dhe në përmbushje të të drejtës kushtetuese të garantimit të mbrojtjes ligjore, referuar nenit 31 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

Nëse do të lexojmë dispozitat e ligjit të posaçëm për ndihmën juridike, vihet re se ndihma juridike dytësore (mbrojtja me avokat nga lista e ofruesve të ndihmës juridike dytësore), ofrohet në çështjet penale për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme sipas përcaktimeve të legji-

lacionit procedural penal. Në rastet e referuara nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, jemi në kushtet kur nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme sipas nenit 49 të KPP-së.

Sa i përket procedurës që duhet të ndiqet për të përfituar shërbimin e ndihmës juridike dytësore, referuar ligjit nr.111/2017, *organi kompetent për dhënien e vendimit nuk është Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, por gjykatat dhe organi procedues, në varësi të pozitës procedurale të kërkuarit*. Në këto kushte, nëse provohet se kërkuari është i pandehur pa mjete të mjaftueshme financiare, organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, **cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore** dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

iv. Të drejtat e Viktimave

Sipas nenit 58 (ç) të Kodit të Procedurës Penale (Të drejtat e viktimës së veprës penale), viktimat e një veprës penale ka të drejtën “për të zgjedhur një avokat mbrojtës dhe kur është rasti të marrë **ndihmë juridike falas** në vijim të legjislacionit në fuqi”.

Nenet 36 dhe 37 të **Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë**, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal përmbajnë dispozita të mëtijshme për viktimat:

Rregullorja, bazuar në udhëzimin se rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve, që do të ofrojnë ndihmë juridike, do të zbatohet për viktimat e veprës penale, si dhe viktimat akuzuese në lidhje me pretendimet e tyre për paraqitjen e padisë civile brenda dhe jashtë procesit penal.

I padituri civil në procesin penal, si rregull, mbrohet nga i njëjti avokat i caktuar për të ndjekur procesin penal. Kur avokati nuk dëshiron të ndjekë çështjen civile, avokati do të zëvendësohet në përputhje me rregullat e rotacionit dhe në bazë të kalendarit të çështjeve.

Sipas nenit 8 të Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime dytësore

të ndihmës juridike në procesin penal, përgatitet **një listë (e veçantë, e dytë) avokatësh** e përbërë nga avokatë **të specializuar dhe të trajnuar** në çështjet për të mitur, për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual.

v. Dispozita të tjera relevante në Kodin e Procedurës Penale

Neni 6 (E drejta e mbrojtjes) dhe neni 34/a(1)(d) (Të drejtat e të paditurit) **të Kodit të Procedurës Penale** nënvizojnë se të paditurit, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme, do t'i garantohet mbrojtje ligjore nga një avokat falas dhe se para marrjes në pyetje për herë të parë ose para përfundimit të akteve ku prania e tij është e detyrueshme në përputhje me ligjin, autoriteti procedues **do të informojë të paditurin** për të drejtat e parashikuara në nenin 34/a (d) të Kodit të Procedurës Penale (d.m.th. për të drejtën për të zgjedhur një avokat ose për të marrë një avokat falas; shiko gjithashtu nenin 13 të Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal).

Ekzistojnë dispozita të ngjashme në **Vendimin Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë**, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal: Organi procedurës do të fillojë veprimet hetimore, të cilat duhet të kryhen në prani të avokatit mbrojtës, vetëm pas një afati kohor jo më pak se një orë, i cili fillon pas paraqitjes së avokatit në organin procedues me qëllim që **avokati të këshillohet** me të paditurin dhe aktet e dosjes hetimore (neni 12 i Vendimit). Pas caktimit të avokatit mbrojtës, organi procedues do t'i ofrojë atij/asaj mundësinë që të paraqitet sa më shpejt të jetë e mundur në vendin e kërkuar.

c. Dispozita relevante në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur

Neni 19 (3) (a) i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur përcakton të drejtën e **fëmijës në konflikt me ligjin** për ndihmë juridike falas (shiko gjithashtu nenin 11 (c)) dhe për ndihmë psikologjike.

Neni 20 (1) i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon të drejta të ngjashme edhe për **fëmijën viktimë ose dëshmitar** në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur; ata kanë të drejtë për ndihmë juridike falas (shiko gjithashtu nenin 11 (c)) dhe ndihmë psikologjike të ofruar nga shteti sipas legjislacionit përkatës (shiko gjithashtu nenin 36 të Kodit të

Drejtësisë Penale për të Mitur).

Sipas Nenit 31 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, fëmija në konflikt me ligjin ose viktimën do të mbrohet nga **avokatët mbrojtës të specializuar** në drejtësinë për fëmijë, përveçse kur fëmija ose përfaqësuesi ligjor i fëmijës zgjedh një avokat mbrojtës tjetër. Dhoma Kombëtare e Avokatisë vë në dispozicion një listë avokatësh të specializuar në drejtësinë për të mitur për institucionet e ndihmës juridike falas. Kjo zbatohet më tej sipas nenit 8 të Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike detyruese në procesin penal: përgatitet një listë (e veçantë, e dytë) avokatësh e përbërë nga avokatë të specializuar dhe të trajnuar në çështjet për të mitur, për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual.

Institucioni që administron ndihmën juridike falas, në rastet e parashikuara me ligj, ofron menjëherë ndihmë juridike me kërkesë të fëmijës ose çfarëdo organi kompetent. Kur **kërkesa është bërë nga fëmija**, ajo mund të paraqitet në çfarëdo forme përpara organit kompetent, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 48 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (Mbrojtja e Fëmijëve) rregullon që, nëse një fëmijë në kundërshtim me ligjin nuk zgjedh një avokat mbrojtës, organi kompetent që kryen veprimin përkatës procedural **cakton menjëherë avokatin mbrojtës** sipas dispozitave të Kodit dhe ligjeve të posaçme për ndihmën juridike, deri në masën që nuk bien në kundërshtim me këtë Kod.

Neni 59 (3) i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (**Pëlqimi për masën e shmangies**) kërkon që, para marrjes së pëlqimit, fëmija të marrë këshillim dhe shërbim të ndihmës juridike falas për të kuptuar masën e propozuar për devijim dhe nëse është e përshtatshme dhe e pranueshme prej tyre.

Sipas nenit 127 (3) të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (**Procedimet për vendosjen e masave disiplinore**) fëmija i arrestuar/dënuar ka të drejtën për avokat mbrojtës në seancën dëgjimore ku shqyrtohet sjellja disiplinore dhe, para se të fillojë seanca, fëmija do të informohet për të drejtën për të pasur një avokat mbrojtës. Kjo e drejtë ushtrohet brenda 6 orëve nga dhënia e informacionit, nëse fëmija e pranon këtë. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet në kohë, fëmijës i caktohet një avokat kryesisht. Fëmija duhet të japë miratimin për avokatin kryesisht. Shpenzimet për avokatin kryesisht do të mbulohen sipas parashikimeve të legjislacionit

për ndihmën juridike.

Përveç këtyre dispozitave, ekziston edhe **një ligj specifik nr.18 / 2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e të Miturit**. Ai parashikon në nenin 29 që:

“Fëmijës, në çdo proces administrativ e gjyqësor, i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij.

2. Ndhima juridike dhe psikologjike i ofrohet fëmijës drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës.

3. Ndhima juridike ndaj fëmijës përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi, gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor. “

d. Organi Procedues (Neni 21)

i. Përshkrim i Përgjithshëm

Neni 21 dhe dispozitat e tjera të Ligjit për Ndhimën Juridike zbatohen vetëm **nëse nuk zbatohen dispozitat për mbrojtjen e detyrueshme** (neni 3 (c); shiko gjithashtu pikën 12 (a)).

Neni 21 trajton situatën që ndihma juridike ofrohet nga organi procedues. Në këtë rast gjykata duhet të vendosë për kundërshtimet e aplikantit kundër vendimit të organit procedues (neni 21 (4)).

Nenet 20 (2), 23 (c), 24 (3) dhe 24 (6) (a) përmbajnë dispozita të mëtejshme që vlejné për situatat që përfshihen në nenin 21.

ii. Detyrimet informuese të organit procedues, sipas neneve 24 dhe 25 të Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal

Në momentin e arrestimit, detyra e organit procedues është që **t'i njoftojë dhe t'i shpjegojë** të ndaluarit/personit të arrestuar/të paditurit:

- të drejtën e tij/të saj për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti në rast se ka paaftësi financiare për të siguruar një avokat mbrojtës nga tregu.
- të drejtën e tij/të saj për të përfituar ndihmë juridike falas kur plotësohen kushtet për të përfituar mbrojtjen e detyrueshme, në përputhje me

nenet 49 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale.

Organi procedues do t'i kërkojë të ndaluarit/personit të arrestuar/të paditurit të plotësojë një deklaratë/formular, sipas formës së miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ku ai/ajo do të deklarojë gjendjen ekonomike dhe do të shprehë vullnetin që ai/ajo kërkon për t'u mbrojtur nga një avokat i caktuar nga shteti.

Shiko gjithashtu Pikën 13 b to c

iii. Kërkesa

Ligji për Ndhmën Juridike

Kërkesa do t'i paraqitet organit procedues që fillon hetimin (Neni 19 (1) dhe 20 (2)).

Praktika Gjyqësore Relevante e GJEDNJ-së:

Ndihma juridike duhet të ofrohet në çdo fazë të procedurës:

Salduz k. Turqisë (2008): “Faza e hetimit veçanërisht e rëndësishme për përgatitjen e procedurës penale pasi provat e marra gjatë kësaj faze përcaktojnë kuadrin në të cilin, vepra penale e pretenduar, do të shqyrtohet në gjykim.”

Në *Nechiporuk dhe Yonkalo k. Ukrainës* (2011), GJEDNJ-ja ka përcaktuar “vulnerabilitetin e veçantë të një të akuzuari në fazat e hershme të procedurave kur ai përballet me stresin e situatës dhe legjislacionin gjithnjë e më kompleks penal të përfshirë”.

GJEDNJ-ja kërkon që të dyshuarve t'u jepet akses tek një avokat, i emëruar nga Shteti nëse është e nevojshme, përpara se të merren në pyetje nga policia (*Salduz k. Turqisë*).

Këto gjykime pasqyrohen në nenin 6 (E drejta për mbrojtje) dhe nenin 34/a (1) (d) (Të drejtat e të pandehurit) të kodit të Procedurës Penale.

iv. Kriteret

Organi që fillon hetimet shqyrton nëse “përmbushen kriteret e përcaktuara në Nenin 12 të këtij ligji”.

v. Njoftimi i Vendimit

Vendimi për pranimin ose refuzimin arsyetohet dhe i **njoftohet** të paditurit dhe Drejtorisë (Neni 21 (1) (c) dhe (3)).

vi. Opsioni 1: Dhënia e Ndhmës Juridike ose Mbrojtjes së Detyrueshme

Në rastin e një vendimi pozitiv, **organi procedues cakton** sipas akteve nënligjore të miratuara sipas nenit 21 (6) avokatin nga lista në dispozicion nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe informon avokatin dhe të paditurin për vendimin e tij. Në këtë rast, organi procedues cakton avokatin dhe jo dhomën vendore të avokatëve (neni 24 (1) (c) dhe (3)).

Vendimi nr. 231 i Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike detyruese në procesin penal rregullon më tej **përzgjedhjen dhe emërimin e avokatit** (si për avokatët e ndihmës juridike ashtu edhe për mbrojtjen e detyrueshme sipas nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale) si më poshtë:

Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, brenda 1 shkurtit të çdo viti kalendarik, nxjerr **listat e aprovuara të avokatëve** dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare (neni 3 i Vendimit). Lista është përpiluar sipas procedurës së parashikuar në nenet 4 dhe 5 të Vendimit. Ekzistojnë dy lista (neni 7 dhe 8 i vendimit): Lista e parë përbëhet nga avokatët, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve dhe Drejtoria dhe lista e dytë përbëhet nga avokatët e specializuar dhe të trajnuar në çështje për të miturit, për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual (shiko gjithashtu pikën 13 b iii dhe c).

Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë do të marrë masa për rastet kur mungon lista e avokatëve të caktuar në një rreth gjyqësor. Në një rast të tillë, ajo kërkon nga dhoma vendore e avokatëve, e cila është më e afërta me organin procedues të këtij rrethi gjyqësor, t'u sigurojë organeve proceduese listën dhe urdhrin e avokatëve të caktuar për të siguruar ndihmë juridike të dhënë nga shteti (Neni 24 i Vendimit).

Avokatët e përfshirë në listën e ndihmës juridike shërbejnë si **avokatë** (neni 6 i Vendimit)

- Për të paditurit që kualifikohen për ndihmë juridike sipas Ligjit për Ndhmën Juridike dhe
- Për të paditurit që janë në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme sipas parashikimeve të nenit 49 (7) dhe nenit 49/a të Kodit të Procedurës Penale.

Përzgjedhja e avokatëve bëhet përmes një rotacioni të njëpasnjëshëm nga lista, duke filluar nga nr.1 i listës, duke lëvizur më pas në nr. 2, duke vazhduar njëra pas tjetrës deri në fund të listës (neni 5 i Vendimit).

Kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të garantohet nga lista e dhënë nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtja do të garantohet nga lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike detyësore në procesin penal (neni 10 i Vendimit).

Procedura e mëtejshme është si më poshtë (Nenet 15 deri 24 të Vendimit):

Organi procedues **do të kontaktojë** nëpërmjet telefonit dhe/ose nëpërmjet postës elektronike **avokatin** e caktuar sipas renditjes në listën e dhënë nga dhoma vendore e avokatëve. Pastaj, ekzistojnë tre opsione:

Opsioni 1: Kur avokati i përgjigjet telefonatës ose postës elektronike dhe **konfirmon** mbrojtjen sipas çështjes përkatëse, atij do t'i jepet një afat i arsyeshëm, jo më pak se një orë, për t'u paraqitur në vendin e kërkuar. Pas pranimit të mbrojtjes, avokati lidh një **kontratë**.

Opsioni 2:

Kur avokati **refuzon** të pranojë detyrën, do të kontaktohet avokati vijues në listë.

Opsioni 3:

Kur avokati **nuk i përgjigjet** thirrjes telefonike ose postës elektronike, i lihet atij/asaj një periudhë prej 20 minutash për t'u përgjigjur.

Kur avokati nuk është i disponueshëm, do të bëhet një përpjekje për ta kontaktuar atë përsëri pas 20 minutash.

Kur thirrja telefonike/posta elektronike nuk merr përgjigje pas njoftimit të dytë, organi procedues do të veprojë menjëherë duke kontaktuar avokatin tjetër në listë.

Kur avokati në detyrë sipas kalendarit **nuk i përgjigjet thirrjes së organit procedues për 3 raste vijuese**, kur kërkohet mbrojtja nga ana e tij/e saj, ai/ajo do të pozicionohet në fund të listës dhe do të zëvendësohet nga avokati i mëpasshëm në listë sipas rendit. Në një rast të tillë, avokati zëvendësues nuk e humb radhën e tij /të saj për t'u caktuar në detyrë.

Organi procedues **do të njoftojë me shkrim Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë** për rastet e refuzimit dhe/ose për mos përgjigjen e avokatëve në listë për dhënien falas të ndihmës juridike.

vii. Opsioni 2: Ndihma Juridike NUK ofrohet

Në rast se kërkesa për ndihmë juridike **pushohet**, aplikanti mund të **kundërshtojë** vendimin e organit procedues me një padi në gjykatën

penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e gjykimit mbi meritat, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet apelimi i posaçëm në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomën e këshillimit brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

viii. Detyrimi i Organit Procedues sipas neneve 28 dhe 29 të Vendimit Nr. 231 të Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal

Organi procedues do të marrë masa për të kryer veprimet në prani të avokatit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Organi procedues, gjatë caktimit të avokatëve për ndihmë juridike falas, do të zbatojë parimin sipas të cilit avokati i caktuar në një fazë të procedimit do ta mbrojë klientin në të gjitha fazat e hetimit dhe të gjykimit.

ix. Vlerësimi i avokatit

Organi procedues i kërkon të ndaluarit/personit të arrestuar/të paditurit që të plotësojë formularin në përputhje me formularin e aprovuar nga Drejtoria **për vlerësimin e punës** së avokatit të caktuar (neni 35 i Vendimit).

x. Zëvendësimi i avokatit/fundi i funksionit

Ligji për Ndihmën Juridike:

Vendimi **për të zëvendësuar** avokatin (për shkak të **konfliktit të interesit** siç parashikohet në nenin 24 (5)), merret në këtë situatë nga organi procedues (Neni 24 (6) (a)).

Vendimi Nr. 231 i Këshillit të Prokurorisë, datë 12.11.2019, për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe emërimin e avokatit mbrojtës bazuar në parimin e rotacionit nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në procesin penal përmban **situata të mëtejshme** ku avokati mund të zëvendësohet:

Avokati **i caktuar nga lista e aprovuar për ndihmë juridike pushon** së ushtruar funksionet e tij/tësaj si avokat, kur (nenet 11 dhe 32 të Vendimit):

- Përmbushen kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe avokati i ndihmës juridike zëvendësohet në përputhje me dispozitat e nenit 49

(6) të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, kopja e procesverbalit për zëvendësimin e avokatit e hartuar në organin procedues do të dorëzohet në strukturat përgjegjëse që ofrojnë ndihmë juridike.

- I padituri pa mjete të mjaftueshme financiare nuk e pranon mbrojtjen e tij të mëtejshme, sipas parashikimeve të nenit 24 (5).

Avokati, sipas nenit 30 të Vendimit mund të zëvendësohet në raste të jashtëzakonshme, kur përmbushet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

- Ka konflikt interesi (kjo arsye korrespondon me nenin 24 (5));
- Avokati dhe/ose i ndaluar/personi i arrestuar/i padituri paraqet një kërkesë të arsyeshme me shkrim për heqjen dorë (shiko gjithashtu nenet 11 dhe 32 të Vendimit);
- Avokati nuk paraqitet para organit procedues në mënyrë të përsëritur dhe pa arsye;
- Avokati, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, nuk mund të përfaqësojë klientin në atë rast;
- Arsye të tjera të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.

Neni 30 i Vendimit nuk përcakton më tej kur dhe në cilat rrethana një kërkesë “arsyetohet”.

Kur avokati i caktuar për të siguruar ndihmë juridike përballet me pengesa për angazhimin dhe vazhdimin e mbrojtjes, ai/ajo do t’i drejtohet organit procedues dhe Dhomës Vendore të Avokatëve me një kërkesë të arsyetuar. Prokurori fillon procedurën e zëvendësimit dhe njofton Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai/ajo të zëvendësohet me një avokat tjetër (shih nenet 31 deri 34 të Vendimit).

14. Dispozita relevante të mëtejshme në Kodin e Procedurës Civile

Sipas nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile gjatë rregullimeve paraprake të gjyqtarit të vetëm gjykata **informon të paditurin** mbi mundësinë për të kërkuar ndihmë juridike.

VII. Përjashtimi nga Tarifat dhe Shpenzimet e Gjykatës

1. Përshkrim i përgjithshëm

a. Ligji për Ndihmën Juridike

Neni 3 (h) përcakton termin “Përjashtimi nga tarifrat dhe shpenzimet gjyqësore” si një formë të ndihmës juridike falas, për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve të tjera gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse përmbushen kriteret e vendosura nga ky ligj.

Neni 3 (i) dhe (j) përcaktojnë termat

- **“Tarifa gjyqësore”** si tarifa në përputhje me përkufizimin e dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifrat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë dhe
- **“Shpenzime gjyqësore”** si shpenzime të kryera në kuadrin e procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin në përputhje me kuptimin e dhënë në legjislacionin procedural, me përjashtim të tarifës gjyqësore.

Kapitulli VI mbulon

- Tarifrat gjyqësore
- Shpenzimet gjyqësore siç janë shpenzimet për përkthyesit, dëshmitarët, ekspertët, inspektimin në vend ose ekzaminimin e sendeve në vend dhe
- Detyrimin për parapagimin e tarifës për fillimin e ekzekutimit të urdhrorit të ekzekutimit në shërbimin e përmbarimit gjyqësor shtetëror

b. Ligji për Tarifat Gjyqësore

Sipas nenit 9 (1) të Ligjit për tarifrat gjyqësore, ndërgjyqësi mund të lirohet nga detyrimi për të paguar tarifrat gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore, kur bëhet një kërkesë për to, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligjin për ndihmën juridike.

c. Kodi i Procedurës Civile

Neni 102 i Kodit të Procedurës Civile **përcakton** “Shpenzimet gjyqësore” (ato përbëhen nga tarifata dhe shpenzimet e tjera të nevojshme për gjykimin) dhe “Tarifat gjyqësore” (“llojet e tyre, normat dhe çështjet e tjera që lidhen me to, do të rregullohen me ligj të veçantë”).

Në rast se një palë përjashtohet nga shpenzimet, detyrimi i **parapagimit** të shpenzimeve gjyqësore (neni 105 i Kodit të Procedurës Civile) nuk zbatohet (neni 105 b i Kodit të Procedurës Civile).

Tarifata fikse të përcaktuara për ekzekutimin e urdhrit ekzekutiv fillimisht paguhen nga kreditori dhe, pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit, i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera, gjatë procedurës së ekzekutimit, paguhen nga pala që i ka shkaktuar ato (Neni 525 i Kodit të Procedurës Civile).

d. Kodi i Procedurës Penale

nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale (Shpenzimet e pësuarat nga shteti) **shpenzimet procedurale penale** paguhen paraprakisht nga shteti, përveç atyre që lidhen me aktet të kërkuara nga palët private.

Në vendimin përfundimtar gjykata përcakton detyrimin për të paguar shpenzimet e paguara paraprakisht nga Shteti.

2. Aktet Nënligjore

Shpenzimet e ekspertëve dhe të dëshmitarëve rregullohen me Udhëzimin Nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë gjykimit” dhe “Udhëzimin për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit”.

Rregullorja e dytë është Udhëzimi nr. 6 i Ministrit të Drejtësisë, datë 20/08/2019, për **rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore**, ku është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike.

3. Përfituesit (Neni 25)

Shiko pikën IV.

4. Kërkesa

Shiko pikat IV dhe V.

Kërkesa duhet të bëhet duke përdorur **formularin**.

Çështja e kohës

Kërkesa mund të bëhet

- së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;
- bashkëlidhur deklaratës së padisë/prendimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit procedural;
- në çdo fazë të procedurës derisa hetimi gjyqësor nuk është deklaruar i mbyllur.

Mund të kërkohen përjashtime nga pagesa e **një, disa ose e të gjitha** tarifave gjyqësore dhe/ose shpenzimeve gjyqësore.

Kërkesa duhet t'i adresohet **gjykatës** që është kompetente për vendimin mbi meritat.

5. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Vendimit për Kërkesën

a. Shqyrtimi i Kërkesës

Gjykata shqyrton kërkesën në përputhje me dispozitat e legjislacionit procedural dhe deri në masën që është e mundur me dispozitat e Nenit 22 (Neni 27 (2)).

Shiko pikën V për detaje.

b. Njoftimi i Vendimit

Vendimi për **pranimin** e kërkesës për përjashtim nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore do t'i njoftohet menjëherë **Drejtorisë** (Neni 27 (4)) dhe **palës kërkuese** (Neni 316 i Kodit të Procedurës Civile).

6. Pagesa e Shpenzimeve dhe Tarifave

a. Ligji për Ndihmën Juridike

Shpenzimet gjyqësore paguhen nga Drejtoria sipas procedurave për

pagesën e shpenzimeve gjyqësore (neni 28 (2)).

Akti nënligjor për pagesën e ekspertëve dhe dëshmitarëve (Neni 28 (3)) dhe procedurat për pagesën e shpenzimeve gjyqësore (Neni 28 (4), 7 (gj)) rregullon se me çfarë shume dhe kur paguhen ekspertët dhe dëshmitarët.

b. Aktet nënligjore

Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së **shpenzimeve dhe pagesave të Ekspertëve dhe Dëshmitarëve** gjatë Gjykimit” dhe “Udhëzimi për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin Nr. 4, datë 12.12 .2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit” dhe Udhëzimi Nr. 6 i Ministrisë të Drejtësisë, datë 20/08/2019, për rregullat dhe procedurat për kryerjen e pagesave të shpenzimeve gjyqësore, ku është vendosur përjashtimi në rast të dhënies së ndihmës juridike” parashikojnë sistemin e mëposhtëm:

Për përzgjedhjen e ekspertëve:

Gjykata fton ekspertë, të cilët ofrojnë ekspertizë në një proces gjyqësor, bazuar në të dhënat e Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve (Neni 1, Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të Ekspertëve dhe Dëshmitarëve gjatë Gjykimit”) dhe thërret një ekspert jashtë Regjistrisë Elektronike të Ekspertëve vetëm kur, për nevojat e procesit, eksperti kërkohet nga fusha specifike të ekspertizës për të cilat ligji nuk siguron licencimin e tyre (Neni 4, Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit”). Secili ekspert nuk mund të caktohet për të siguruar ekspertizën e tij në më shumë se 30% të numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat kërkohet i njëjti lloj ekspertize brenda një viti kalendarik (Neni 3, Udhëzimi Nr. 4, datë 12.12.2012, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit”).

Për shumën e shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve, përkthyesve dhe dëshmitarëve:

Pjesa II e Udhëzimit Nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e shumës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe të dëshmitarëve gjatë gjykimit” përcakton shpenzimet dhe pagesën e ekspertëve, pjesa III e këtij Udhëzimi shpenzimet e dëshmitarëve dhe pjesa IV shpenzimet e përkthyesve.

Ekspertët kanë të drejtë për shpenzime të caktuara udhëtimi dhe dieta (në varësi të distancës së vendbanimit të tyre nga gjykata) dhe një pagesë maksimale prej 40 000 lekësh.

Për pagesën e dëshmitarëve, ekspertëve, përkthyesve dhe për inspektimin e sendeve dhe inspektimin e vendndodhjes (shiko nenin 2 Udhëzimi Nr. 6 i Ministrit të Drejtësisë, datë 20/08/2019, për rregullat dhe procedurat për kryerjen e pagesave të shpenzimeve gjyqësore, ku përjashtimi është vendosur në rast të dhënies së ndihmës juridike):

Pagesat për ekspertët dhe dëshmitarët në rastet kur gjykata ka vendosur lirim nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore bëhen **nga Drejtoria**. Detajet rregullohen me Udhëzimin Nr. 6 të Ministrit të Drejtësisë, datë 20/08/2019, për rregullat dhe procedurat për kryerjen e pagesave të shpenzimeve gjyqësore, ku përjashtimi është vendosur në rast të dhënies së ndihmës juridike si vijon (shiko nenet 3 deri 5 të atij Udhëzimi):

Drejtoria bën pagesa bazuar në vendimin e gjykatës. Brenda 15 ditëve nga data e shpalljes nga gjykata të vendimit për përjashtim nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore, dëshmitari, eksperti dhe përkthyesi **duhet të paraqesin pranë Drejtorisë** dokumentet tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin mbështetës siç përmendet në nenin 4 të atij Udhëzimi. Mosparaqitja e dokumentacionit tatimor sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tatimin përbën një shkak për mos kryerjen e pagesave.

Në fund të çdo muaji, Drejtoria bën (në varësi të buxhetit të disponueshëm) **pagesat** e shpenzimeve gjyqësore, sipas sekuencës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të konsoliduara me dokumentacionin themelues (Nenet 6, 8 të Udhëzimit) dhe njofton marrësin, përfituesin e ndihmës juridike dhe gjykatën në lidhje me pagesën (Neni 7 i Udhëzimit).

7. Procedura e Ankimit

Do të zbatohen dispozitat e Nenit 22 (Neni 27 (3)).

VIII. Rimbursimi

1. Përshkrim i përgjithshëm

a. Përmbajtja

Ligji rregullon dy skenarë në këtë kontekst:

- Rimbursimin nga **pala që humbet** në çështje civile dhe administrative (Neni 30) dhe
- Rimbursimin nga **përfituesi** (Nenet 31 dhe 32; shiko gjithashtu Nenin 6 “Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat për Verifikimin e Rrethanave për Kthimin e Fitimeve”)

Mundësia e përgjithshme për t’i kërkuar një përfituesi rimbursim është në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së: “Nuk ka garanci për një përjashtim definitiv nga kostot ligjore. Rimbursimi mund të kërkohej pas gjykimit nëse personi në fjalë ka mjetet për të përmbushur shpenzimet” (X. k. Gjermanisë (1982)).

b. Aktet nënligjore

Akti nënligjor relevant është “Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat për Verifikimin e Rrethanave për Kthimin e Fitimeve”.

c. Institucionet Kompetente

Drejtoria është kompetente për kërkimin e rimbursimit.

2. Rimbursimi nga Pala që humbet (Neni 30)

a. Dispozitat Relevante në Kodin e Procedurës Civile

Sipas Nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile (pala e ngarkuar)

- Tarifa, shpenzimet e tjera gjyqësore si dhe shpërblimi i një avokati që është paguar nga paditësi, **do t’i ngarkohen të paditurit** në masën e pjesës së padisë/pretendimit që është miratuar nga gjykata,

Tarifa dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, nga pagesa e së cilës pala është përjashtuar **do t'i ngarkohen palës tjetër** në masën e pjesës së padisë/pretendimit që është miratuar nga gjykata dhe

- **I padituri ka të drejtë të kërkojë** pagesa të shpenzimeve gjyqësore të bëra, në përpjesëtim me pjesën e papranuar të padisë/pretendimit. I padituri ka të drejtë të kërkojë pagesa të shpenzimeve gjyqësore të bëra, edhe në rast të vendimit për pushimin e gjykimit.

b. Objekti

Neni 30 zbatohet vetëm për çështjet **civile dhe administrative**. Sipas formulimit të tij, ai zbatohet kur “pala që është përjashtuar nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe e shpenzimeve gjyqësore”. Në atë rast, pala tjetër do të “ngarkohet me pagesën e tarifave gjyqësore dhe të shpenzimeve gjyqësore”. Pra, sipas formulimit të tij, neni 30 nuk zbatohet për shpenzimet e bëra për ndihmë juridike dytësore, d.m.th. tarifën që i paguhen avokatit. Mund të vihet në dyshim nëse heqja e shpenzimeve për ndihmë juridike dytësore ishte me qëllim dhe nëse shpenzimet e bëra për ndihmë juridike dytësore, d.m.th. tarifën e paguara për avokatin, mund të mos merren nga pala që ka humbur.

c. Kushtet

Nëse përfituesi i ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifën gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore

- **fiton** me vendim përfundimtar dhe
- pala tjetër që ka humbur ngarkohet në përputhje me **vendimin e gjykatës** për të paguar tarifën dhe kostot gjyqësore menjëherë për Drejtorinë.

d. Procedura

Sipas Ligjit për Ndihmën Juridike, vendimi (që ngarkon me pagesë palën tjetër) nuk i njoftohet Drejtorisë. Megjithatë, përfituesi është i detyruar t'i paraqesë Drejtorisë **një kopje të vendimit gjyqësor të formës së prerë** dhe ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor (Neni 4 “Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat për Verifikimin e Rrethanave për Kthimin e Fitimeve”).

Nëse kjo palë e humbur nuk paguan vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë, përmbauesi gjyqësor fillon **procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm** në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Rimbursimi nga Përfituesi

a. Përshkrim i përgjithshëm

Ekzistojnë **dy situata** kur mund të kërkohet rimbursim nga përfituesi:

- Nëse ka një ndryshim të rrethanave ose
- Nëse përfituesi ka dhënë informacion fillestar të rremë ose të pavërtetë

Të dyja opsionet **nuk janë të kufizuara në çështjet civile dhe administrative**, por zbatohen edhe në procedurat penale.

b. Ndryshimi i Rrethanave (Neni 31 (1 dhe 2))

Kushtet e rimbursimit janë

- Rrethanat kanë ndryshuar dhe për shkak të kësaj
- Përfituesi nuk i përmbush më kriteret ligjore për ndihmë juridike.

Neni 6a “Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat e Verifikimit të Rrethanave për Kthimin e Fitimeve” specifikon Nenin 31 pasi përcakton se rimbursimi mund të kërkohet nga përfituesi nëse “**të ardhurat** financiare janë të tilla që ato nuk i përkasin asnjë prej kategorive të **Nenit 12**”.

c. Procedura

Drejtoria, pas miratimit të ndihmës juridike, kërkon që përfituesi të nënshkruajë një deklaratë ku ata të angazhohen ndaj **detyrimit për të njoftuar për ndryshimet** në rrethanat financiare, ose kur nuk duan të ndjekin më procedurat gjyqësore, duke pranuar në këtë mënyrë kthimin vullnetar të shumës së përfituar për këtë efekt (Neni 3 “Udhëzimi Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat për Verifikimin e Rrethanave për Kthimin e Fitimeve”).

Drejtoria verifikon në mënyrë periodike, çdo vit, gjendjen ekonomike dhe financiare të përfituesit, si dhe fazën e procedurave ku pala përfituese është e përfshirë (Neni 1 i udhëzimit). Drejtoria megjithatë mund të kryejë gjithmonë verifikimin nëse ka të dhëna ose indikacione për ndryshimin e rrethanave (Neni 2 i Udhëzimit). Drejtoria mund të kërkojë informacion nga përfituesi dhe institucionet publike dhe jopublike që mund të jenë të vetëdijshme për situatën në të cilën ndodhet përfituesi (Neni 5 i këtij Udhëzimi).

Kur Drejtoria zbulon se janë plotësuar kushtet për rimbursim, ajo merr një **vendim** të argumentuar, ku pasqyron: a) të dhënat që janë mbledhur prej saj;

- a) të dhënat që janë mbledhur prej saj;
- b) shumën e llogaritur të saktë që duhet të kthehet nga përfituesi, dhe
- c) periudhën kohore brenda së cilës duhet të kthehet shuma e përfituar, e cila në asnjë rrethanë nuk do të tejkalojë periudhën kohore prej gjashtë muajsh nga data e zbulimit të rrethanave përkatëse (Neni 7 i Udhëzimit).

Në këtë rast Drejtoria njofton përfituesit për detyrimet për rimbursimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin kohor për përmbushjen e këtij detyrimi.

Nëse **nuk bëhen pagesa vullnetare**, Drejtoria bën një deklaratë kërkesë në gjykatë (Neni 8 i Udhëzimit).

4. Rimbursimi nga Përfituesi sipas Nenit 31 (3)

Rimbursimi (sipas nenit 31 (1) dhe (2)) mund të kërkohet nga përfituesi kur personi, të cilit i është aprovuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore ose avokati i caktuar:

- a) **nuk e ka depozituar deklaratën e pretendimit** në gjykatë, pasi brenda tre muajve nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore është bërë i formës së prerë (shiko gjithashtu nenin 6b të Udhëzimit);
- b) **është tërhequr** nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi, ose nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit (shiko gjithashtu nenin 6c të Udhëzimit).

5. Rimbursimi nga Përfituesi për shkak të Informacioneve dhe të Dhënave False ose të Pavërteta (Neni 32)

Rimbursimi mund të kërkohet nga përfituesi kur përfituesi ka marrë ndihmë juridike duke paraqitur të dhëna false ose të pavërteta (neni 6ç i Udhëzimit Nr. 2, datë 25/03/2019, për Procedurat, Periodicitetin dhe Rregullat për Verifikimin e...).

Drejtoria duhet të nxjerrë një vendim sipas nenit 7 të Udhëzimit (shiko më lart pikën 3). Në rastin e mungesës së ekzekutimit vullnetar, Drejtoria do të paraqesë një deklaratë pretendimi në gjykatë.

Aneks 1

LIGJ Nr. 111/2017

PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1 Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Neni 2 Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim:

- a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;
- b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;
- c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Ndihmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.
- b) “Ndihmë juridike parësore” është:
 - i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
 - ii) dhënia e këshillimit;
 - iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
 - iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
 - v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe
 - vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.
- c) “Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.
- ç) “Këshillim” është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
- d) “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- dh) “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.
- e) “Trajnim i posaçëm” është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

- ë) “Klinikë ligjore” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcakti-meve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
- f) “Të ardhura”, në kuptim të këtij ligji, janë të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihet ndihma ekonomike, pensioni social, pagesat e papunësisë, përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.
- g) “Familje”, në kuptim të këtij ligji, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkë- shortore ose bashkëjetese, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë dhe që kontribuojnë bashkërisht, financiarisht ose në mënyra të tjera për përballimin e kostos së jetesës.
- gj) “Pasuri”, në kuptim të këtij ligji, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore. Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji.
- h) “Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj.
- i) “Tarifa gjyqësore” është tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.
- j) “Shpenzimet gjyqësore” janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin procedural, përveç tarifës gjyqësore.
- k) “Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit” është tarifa që i parapaguhet shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 4 **Parimet e ndihmës juridike**

Dhënia e ndihmës juridike bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) cilësisë, efikasitetit dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit;
- dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

Neni 5 **Format e ndihmës juridike**

Ndihma juridike jepet në format e mëposhtme:

- a) ndihmë juridike parësore;
- b) ndihmë juridike dytësore;
- c) përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

KREU II **ORGANIZIMI I NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI**

Neni 6 **Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike**

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
- c) Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- ç) gjykatat kompetente, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 7 **Detyrat e Ministrit të Drejtësisë**

Ministri i Drejtësisë ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;

- b) i propozon Ministrisë së Financave projektbuxhetin vjetor për ndihmën juridike, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- c) mbikëqyr mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike dhe zbatimin e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
- ç) raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
- d) miraton aktet e mëposhtme:
 - i) formularin e kërkesës për ndihmë juridike parësore;
 - ii) formularin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore;
 - iii) formularin e kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore;
 - iv) formularin e vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;
 - v) formularin e vetëdeklarimit të të ardhurave dhe të pasurive, sipas këtij ligji;
 - vi) formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta, sipas nenit 11 të këtij ligji;
 - vii) formatin e regjistrimit për regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të mesipërme;
 - viii) formatin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
 - ix) formularin e ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore.

Ministria e Drejtësisë merr masat e nevojshme për publikimin e formularëve të parashikuar në këtë paragraf në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara;

- dh) miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- e) miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrisë përgjegjëse për financat;
- ë) miraton kontratën tip me avokatët për dhënie të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore;
- f) miraton, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike;
- g) miraton me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

- gj) miraton procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në lidhje me pagesat për shpenzimet gjyqësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- h) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
- i) miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
- j) kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 8

Detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Organizimi i brendshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Drejtorisë së

Ndhmës Juridike Falas rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë. Marrëdhëniet e punës të punonjësve me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe të personelit ndihmës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas rregullohen sipas Kodit të Punës.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen këto detyra:

- a) zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- b) i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike;
- c) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit;
- ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike;
- d) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj;
- dh) harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e

- këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë;
- e) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;
 - ë) harton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - f) lidh kontrata me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe kryen pagesat përkatëse;
 - g) bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm;
 - gj) administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore;
 - h) publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
 - i) publikon kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, pas miratimit nga Ministri i Drejtësisë;
 - j) kryen pagesat, bazuar në tarifat përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
 - k) lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore;
 - l) zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike;
 - ll) mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët;
 - m) zbaton rregullat për rimbursimin e pagesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe mbron interesat e buxhetit të shtetit;
 - n) harton dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë aktet nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
 - nj) mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë

juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë;

- o) kryen të gjitha detyrat e tjera që i caktohen me këtë ligj.

Neni 9

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë kryen këto detyra:

- a) miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
 - b) miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;
 - c) brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, Dhoma Kombëtare e Avokatisë mban parasysh, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;
 - ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
 - d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas;
- dh) kryen detyra të tjera që i caktohen nga ky ligj.

KREU III

PËRFITUESIT E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Neni 10

Përfituesit e ndihmës juridike

1. Subjekte përfituese të ndihmës juridike janë:

- a) shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të

- përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;
- c) shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- ç) azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.
2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë ndihmë juridike, nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 11

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

- gj personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 12

Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.
2. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
3. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
4. Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
5. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Neni 13

Dhënia e ndihmës juridike parësore

Ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;

- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Neni 14

Dhënia e ndihmës juridike parësore nga punonjësit me trajnim të posaçëm

Ndihma juridike parësore jepet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë këtyre qendrave.

Neni 15

Dhënia e ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të përmbushin këto kritere:
 - a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
 - b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike;
 - c) të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ç) të kenë përvojë në ofrimin e ndihmës juridike;
 - d) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
 - dh) anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.
3. Organizatat jofitimprurëse të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16

Dhënia e ndihmës juridike parësore nga klinikat ligjore

1. Ndhimja juridike parësore jepet nga klinikat ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë.
2. Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

Neni 17

Kërkesa dhe procedura e dhënies së ndihmës juridike parësore

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një organizate jofitimprurëse të autorizuar.
2. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të nënshkruajë një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kritereve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
3. Ndhimja juridike parësore ofrohet menjëherë me marrjen e kërkesës. Në rast se dhënia e menjëhershme e ndihmës juridike parësore është e pamundur, personi informohet menjëherë për datën dhe kohën e dhënies së shërbimit të kërkuar.
4. Një person ka të drejtën të marrë shërbimet e ndihmës juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje vetëm një herë, me përjashtim të rasteve kur rrethana të reja të caktuara justifikojnë dhënien e shërbimeve të mëtejshme të ndihmës juridike parësore për të njëjtin person, rreth së njëjtës problematikë ose çështje.
5. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet një konflikt interesi, ky shërbim ndërpritet menjëherë. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një qendër shërbimi për ndihmë juridike parësore, çështja trajtohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, për shmangien e konfliktit të interesit. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një organizatë jofitimprurëse e autorizuar, kjo e fundit merr masa për shmangien e konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke siguruar

dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kërkuesin.

6. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet se ekziston nevoja për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, personi informohet menjëherë për kushtet e dhënies së ndihmës juridike dytësore dhe ndihmohet për plotësimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.

7. Gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore mbahet një procesverbal, i cili përmban:

- a) emrin, mbiemrin dhe numrin e identifikimit personal të kërkuesit;
- b) adresën e vendbanimit, të dhënat e kontaktit, gjendjen familjare, statusin e punësimit të kërkuesit;
- c) një përshkrim të shkurtër të problematikës ose çështjes për të cilën janë kërkuar shërbimet e ndihmës juridike parësore;
- ç) nëse është e mundur, kohëzgjatjen e takimit ose takimeve;
- d) një përshkrim të shkurtër të dhënies së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe rezultatin e këtij shërbimi;
- dh) deklarimi se kërkuesi nuk ka përfituar më parë ndihmë juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje;
- e) të dhëna të tjera, sipas formularit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

8. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesve të ndihmës juridike parësore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU V NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Neni 18 Dhënia e ndihmës juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji. Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 19 Kërkesa për ndihmë juridike dytësore

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi

gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.

2. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë.

3. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore përjashtohet nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

4. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 20

Paraqitja e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe organi kompetent për shqyrtimin e saj

1. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet, sipas nenit 21 të këtij ligji.

Neni 21

Procedura e dhënies së ndihmës juridike dytësore të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare

1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

3. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuarit dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

4. Kërkuari mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim.

5. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijani. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal.

7. Rregulla të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 22

Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga gjykata

1. Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmën juridike dytësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji.

2. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente:

- a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
- b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;
- c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

3. Në rastet kur kërkuari deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se korrigjimi

ose plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuarit, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë. Në këto raste kërkesa për ndihmë juridike dytësore quhet e paraqitur në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata për paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga organet e administratës shtetërore.

4. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:

- a) pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore;
- b) rrëzimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.

5. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore rrëzohet vetëm në rastet kur:

- a) nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenet 11 ose 12 të këtij ligji;
- b) është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar.

6. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar.

7. Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili i jepet kërkuarit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës.

8. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.

9. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.

Neni 23

Njoftimi i vendimit të gjykatës

Vendimi i gjykatës mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore i njoftohet menjëherë:

- a) kërkuarit;
- b) personit që ka dorëzuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore, në

- rast se është një person i ndryshëm nga kërkuesi;
- c) organit procedues, nëse janë kushtet e nenit 21 të këtij ligji;
 - ç) Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;
 - d) dhomës vendore të avokatisë, në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore është miratuar.

Neni 24

Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët

1. Avokatët që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore plotësojnë këto kushte:

- a) kanë aplikuar në Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe janë përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
- b) kanë lidhur një kontratë vjetore shërbimi me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas;
- c) janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi procedues ose dhoma vendore e avokatisë;
- ç) janë të specializuar në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

2. Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme:

- a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;
- b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

3. Parashikimet e pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore është paraqitur nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare tek organi procedues që fillon hetimin.

4. Avokati i caktuar, menjëherë pasi njihet me vendimin e gjykatës kompetente dhe vendimin e dhomës vendore të avokatisë ose me vendimin e organit procedues mbi caktimin e tij si avokat për dhënien e ndihmës juridike dytësore, hyn në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara.

5. Avokati i caktuar zëvendësohet nga një avokat tjetër, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, vetëm në

rast se konstatohet një konflikt interesi midis avokatit dhe personit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

6. Vendimi për zëvendësimin e avokatit të caktuar nga një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore merret nga:

- a) organi procedues, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar nga ky organ;
- b) dhoma vendore e avokatisë, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar prej saj.

KREU VI PËRJASHTIMI NGA PAGIMI I TARIFAVE GJYQËSORE, SHPENZIMEVE GJYQËSORE DHE NGA DETYRIMI PËR PARAPAGIM TË TARIFAVE TË VËNIES NË EKZEKUTIM TË URDHRIT TË EKZEKUTIMIT

Neni 25 Përfituesit

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifave gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Neni 26 Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore

1. Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

2. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;

- b) bashkëlidhur kërkesëpadisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;
- c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.

3. Në kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të kërkohet përjashtimi nga pagimi i një, disa ose të gjitha tarifave gjyqësore dhe/ose i shpenzimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji.

4. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet nga personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë.

5. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

Neni 27

Procedura e shqyrtimit të kërkesës

1. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.

2. Gjykata shqyrton kërkesën në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me parashikimet e nenit 22 të këtij ligji.

3. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:

- a) pranimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
- b) rrëzimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji.

4. Vendimi i pranimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Neni 28 Zbatimi i vendimit

1. Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural.
2. Pagesa e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë dhe paguhet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
3. Pagesat që kryhen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk mund të tejkalojnë masën e shpërblimit për ekspertët dhe dëshmitarët në një proces gjyqësor, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.
4. Rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financat.

Neni 29 E drejta për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit

Personat, të cilët kanë përfituar ndihmë juridike dytësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

KREU VII RIMBURSIMI

Neni 30 Detyrimet e palës gjyqëmbëse në çështjet civile ose administrative

1. Kur pala që është përjashtuar nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, fiton me vendim gjyqësor të formës së prerë çështjen, për të cilën është dhënë ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, pala tjetër gjyqëmbëse, së cilës i ngarkohen pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas vendimit gjyqësor, detyrohet të kalojë këtë shumë menjëherë për llogari të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

2. Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 31

Rastet e kthimit të përfitimeve

1. Në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i njofton përfituesit të ndihmës juridike detyrimin për kthimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përmbushjen e këtij detyrimi. Procedura, periodiciteti dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

2. Në rast të mosekzekutimit vullnetar të detyrimit për kthimin e shpenzimeve brenda afatit të caktuar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, do të zbatohen dhe në rastin kur personi, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore ose avokati i caktuar:

- a) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë, pas kalimit të një afati tremujor nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;
- b) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrit të ekzekutimit.

Neni 33

Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta

1. Kërkuesi që ka përfituar ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, duke paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, është i detyruar të rimbursojë shpenzimet për avokatin që ka dhënë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe/ose shpenzimet gjyqësore. Pavarësisht nga rimbursimi i këtyre shpenzimeve, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bën kallëzim penal, kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

2. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, që përmban informacione të rreme ose të pavërteta, është dorëzuar nga një person tjetër i ndryshëm nga personi të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, dorëzuesi dhe përfituesi janë solidarisht përgjegjës për rimbursimin e shpenzimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Rimbursimi i shpenzimeve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet sipas kërkesës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Në rast të mosekzekutimit vullnetar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 33 Buxheti

1. Shpenzimet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në të gjitha format e saj, mbulohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.
2. Fondet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 34 Akte nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 28, pika 3, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, shkronjat “d”, “e”, “ë”, “f”, “gj” dhe “i”; nenit 17, pika 2; nenit 19, pika 4; nenit 28, pika 4, dhe nenit 31, pika 1, të këtij ligji.
3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “b”, të këtij ligji.
4. Ngarkohet titullari i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Kryetari

i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda një muaji nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “a”, të këtij ligji.

5. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, shkronja “g”, të këtij ligji.

6. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë që, brenda 3 muajve nga krijimi, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 21, pikat 6 dhe 7, të këtij ligji.

7. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme.

Neni 35 **Publikime**

Formularët e paraqitjes së kërkesave dhe vetëdeklarimit, të parashikuara nga neni 7, shkronja “d”, i këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Neni 36 **Dispozitë kalimtare**

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike pushon së ekzistuari me ngritjen e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ngrihet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ngrihen brenda tre muajve nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

4. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike përfundon shqyrtimin e të gjithë kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike brenda datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

5. Kërkesat për ndihmë juridike dytësore, që janë paraqitur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë shqyrtuar nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas rregullave të parashikuara nga ky ligj.

6. Për nëpunësit civilë ekzistues të sekretariatit të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.
7. Punonjësit administrativë të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
8. Të gjitha të drejtat, detyrimet, qendrat ekzistuese të shërbimit të ndihmës juridike, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kalojnë dhe administrohen nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë.
9. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë detyrat e parashikuara nga ky ligj për këtë organ kryhen nga Ministri i Drejtësisë.
10. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 37 **Shfuqizime**

Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, "Për ndihmën juridike", i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 38 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2018.

KRYETARI
Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 14.12.2017

Aneks 2

Udhëzim nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 105/a të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Masa e shpenzimeve të dëshmitarëve dhe pagesës së ekspertëve pjesëmarrës në seanca gjyqësore të përcaktohet sipas rregullave të këtij udhëzimi.
2. Çdo vit, gjykata e rrethit gjyqësor publikon listën e ekspertëve të licencuar dhe përditëson listën, në rastet kur autoritetet licencuese marrin masa administrative të pezullimit të licencës.
3. Gjykata thërret ekspertë të licencuar, të përcaktuar në listën që ajo disponon.
4. Në rast se në listë nuk figurojnë ekspertë në fushën e kërkuar ose kur asnjë nga ekspertët që figurojnë në listë nuk është i disponueshëm, Gjykata thërret ekspertë të tjerë, referuar veçantisë së fushës së kërkuar.
5. Dëshmitarët në një proces gjyqësor kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për dëshminë e dhënë.

II. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE

1. Caktimi i shpenzimeve që u takojnë ekspertëve bëhet në bazë të kushteve të mëposhtme:
 - a) Kur eksperti banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, trajtimi financiar i tij përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.
 - b) Kur eksperti banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

- i) Dietë ditore, jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur ekspertiza zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë;
- ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;
- iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.66, datë 27.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.

2. Pagesa për punën e kryer për ekspertimin nga eksperti i licencuar nuk mund të tejkalojë shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë.

III. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE TË DËSHMITARËVE

1. Caktimi i shpenzimeve, që u takon dëshmitarëve, bëhet, si më poshtë vijon:

- a) Kur dëshmitari banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, mbulimi i shpenzimeve të përfshijë vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifat përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.
- b) Kur dëshmitari banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:
 - i) Dietë ditore, në masën jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;
 - ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;
 - iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”.

c) Kur dëshmitari largohet nga vend i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga dëshmitari me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.

2. Nuk gëzojnë të drejtën e pagesës për dëshmitë e dhëna të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

IV. SHPENZIME TË VEÇANTA

Pagesat e përkthyesve të caktohen në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave, nr.3165, datë 12.5.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e pagesës së përkthyesve të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, në bazë faqesh. Në rast se përkthyesit do të thirren për t’u paraqitur në gjykatë për të kryer shërbimet e tyre, përveç pagesës, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar ekspertëve dhe dëshmitarëve.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokument tatimor, për efekt të këtij udhëzimi, do të konsiderohet çdo biletë transporti e miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimsht duhet të shoqërohet me kupon tatimor.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneks 3

Udhëzim nr. 1, date 06.03.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 105/a, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

Udhëzim
nr. 1
06.03.2019

V E N D O S I:

Në udhëzimin nr.4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në ndarjen I, pikat 2, 3 dhe 4 ndryshohen, me këtë përmbajtje:

“2. Gjykata thërret ekspertë që ofrojnë ekspertizë në një proces gjyqësor, mbështetur në të dhënat e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve, që administron dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë.

3. Gjykata, pa cenuar administrimin e drejtësisë, bën përzgjedhjen e ekspertëve në mënyrë të drejtë dhe transparente, duke konsideruar që çdo eksperti nuk mund t’i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij më shumë se 30% e numrit të çështjeve gjyqësore për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize, brenda një viti kalendarik. Kjo mënyrë caktimi nga gjykata siguron një nivel transparence të përshtatshme lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve përmes mjeteve informatike.

4. Gjykata thërret një ekspert jashtë Regjistrit Elektronik të Ekspertëve, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre.”.

2. Në ndarjen V, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje: “1/1. Pagesat për ekspertët dhe dëshmitarët, në rastet kur gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqësore në kuptim të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas rregullave dhe procedurës së përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I
E D I R A M A
Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDESKRYEMINISTRI

Aneks 4

Vendim nr. 55, date 06.02.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

Vendim
nr. 55
06.02.2019

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti, sipas parashikimeve të këtij vendimi.
2. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, në përputhje me autorizimin e miratuar nga ministri i Drejtësisë.
3. Kriteret ligjore, që duhet të përmbushin organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, janë ato të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
4. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bën publik njoftimin për aplikim, i cili përmban adresat e komunikimit, dokumentacionin që duhet të depozitohet, afatin, i cili duhet të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e njoftimit, dhe vendin e dorëzimit të tyre, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për aplikimin për autorizim. Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të këtij institucioni, të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
5. Dokumentacioni që duhet të depozitohet nga organizatat jofitimprurëse, që aplikojnë për marrjen e autorizimit që lëshohet nga ministri i Drejtësisë, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, përmban:
 - a) aktin e regjistrimit në gjykatë;
 - b) kopjen e statutit, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë ofrimi i ndihmës juridike;
 - c) dokumentacionin që provon përvojë në ofrimin e ndihmës juridike parësore, të paktën në 3 (tri) vite të veprimtarisë së tyre, duke përfshirë, si më poshtë vijon:

- i. listën e plotë të projekteve të ndihmës juridike parësore të zhvilluara nga organizata gjatë 3 (tri) viteve dhe të dhëna statistikore për përfituesit e ndihmës parësore;
 - ii. raportet përfundimtare për secilin nga projektet e listuara, si dhe pasqyrat financiare;
 - iii. buxhetin total të secilit projekt, donatorët përkatës, si dhe listën e ekspertëve të brendshëm dhe të jashtëm të përfshirë në këto projekte;
 - iv. letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese;
- ç) vërtetimin nga organet tatimore që i ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;
- d) vërtetim nga gjykata se nuk është në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;
- dh) vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike;
- e) formularin e gjendjes gjyqësore të anëtarëve të organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv.

6. Aplikimi për autorizim i shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij vendimi dorëzohet pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, e cila vlerëson nëse aplikimi është kryer brenda afatit të caktuar në njoftim, shqyrton përmbushjen e kriterëve ligjore dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar.

7. Aplikimet e paraqitura jashtë afatit nuk kualifikohen. Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas njofton aplikuesit nëpërmjet postës elektronike lidhur me këtë disponim.

8. Në rast të konstatimit të mungesës së dokumentacionit, Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas njofton aplikuesin për dorëzimin e dokumentacionit plotësues brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit. Mossjellja e dokumentacionit plotësues brenda këtij afati passjell shkualifikimin.

9. Procedura e verifikimit të kriterëve ligjore dhe e vlerësimit të aplikimit për autorizim bëhet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Procedura e shqyrtimit të aplikimit zhvillohet brenda një afati të arsyeshëm, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e përfundimit të afatit të njoftimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi.

10. Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas verifikon dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesit për marrjen e autorizimit dhe, në përfundim,

përgatit një relacion vlerësues për secilën organizatë jofitimprurëse që ka aplikuar. Relacioni përmban të dhënat e dokumentacionit të paraqitur, vlerësimin mbi përmbushjen ose jo të kriterëve ligjore dhe propozimin përkatës.

11. Propozimi i shoqëruar me relacionin vlerësues i paraqitet ministrit të Drejtësisë, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të aplikimit, miraton ose jo dhënien e autorizimit.

12. Aplikimi për autorizim nuk miratohet kur organizata jofitimprurëse nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr.111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Me kërkesën e saj, organizatës jofitimprurëse i njoftohen shkaqet e shkualifikimit.

13. Organizata jofitimprurëse që ngre pretendime për plotësimin e kriterëve ligjore ka të drejtën e ankimit pranë ministrit të Drejtësisë, duke paraqitur arsyet dhe dokumentacionin mbështetës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit. Ky afat mund të zgjatet për rrethana të arsyeshme, të cilat nuk lidhen me disponueshmërinë e organizatës jofitimprurëse. Ministri i Drejtësisë shqyrton ankesat dhe njofton organizatën jofitimprurëse lidhur me to brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e regjistrimit të ankimit pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.

14. Autorizimi i dhënë nga ministri i Drejtësisë është i vlefshëm për një periudhë dyvjeçare.

15. Ministria e Drejtësisë publikon listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, listë e cila hartohet dhe përditësohet nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbi bazën e të dhënave të regjistrimit që mban kjo drejtori.

16. Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, mund të revokojë autorizimin e dhënë një organizate jofitimprurëse në rast se vërteton, kryesisht, apo bazuar në faktet e parashtruara në ankesat e paraqitura pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe informacionet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike:

- a) mospërmbushjen në mënyrë të përsëritur të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore;
- b) paraqitjen me qëllim të të dhënave të pasakta gjatë procesit të verifikimit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore;

- c) mungesën e respektimit të standardeve dhe cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të ofruar;
- ç) se anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

17. Revokimi i autorizimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente.

18. Çdo e dhënë lidhur me miratimin apo revokimin e autorizimit të organizatës jofitimprurëse regjistrohet në regjistrin e organizatave jofitimprurëse, të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore që administron Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

19. Organizata jofitimprurëse e autorizuar për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore njofton menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për ekzistencën e rrethanave dhe fakteve, të cilat e bëjnë të pamundur ose e vështirësojnë ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, me qëllim që kjo e fundit të marrë masa për të siguruar një ofrim të pandërprerë të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

20. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI
EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
ERION BRAÇE**

Aneks 5

Udhëzim nr. 1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë,” i ndryshuar, si dhe të nenit 7 shkronja i) të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron:
 - a) të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetedeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
 - b) të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurese që ofrojnë ndihmë juridike parësore.
2. Te dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetedeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetedeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.
3. Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetedeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.
4. Plotësimi dhe përditesimi i regjistrit të kërkesave dhe vetedeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.
5. Regjistri i organizatave jofitimprurese që ofrojnë ndihmë juridike parësore plotësohet dhe përditesohet me të dhëna nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, brenda 24 ore nga koha e kryerjes së një veprimi apo marrjes së një informacioni që lidhet me veprimtarinë e tyre.
6. Në regjistrimin e kërkesave dhe vetedeklarimeve për ndihmë juridike

parësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emri, atësia, mbiemri,
- ii. gjinia,
- iii. datëlindja.
- iv. shtetësia,
- v. gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- vi. gjendja e punësimit,
- vii. adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- viii. vetëdeklarimi në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë,
- ix. nëse kërkesa për ndihmë është pranuar apo refuzuar, si dhe arsyen e refuzimit,
- x. natyra e çështjes/ve juridike për të cilën është kërkuar ndihmë (civile, administrative, penale);
- xi. të dhënat e ofruesit të shërbimit që ka dhënë ndihmë juridike parësore.

7. Në regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emri, atësia, mbiemri
- ii. gjinia,
- iii. datelindja,
- iv. shtetësia,
- v. gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- vi. gjendja e punësimit,
- vii. adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- viii. gjykata ose organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- ix. lloji i vetëdeklarimit në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë;
- x. lloji i ndihmës dytësore të kërkuar: (i) Perfaqësim; (ii) Përrjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore; (iii) përjashtim nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore; dhe/ose (iv) përjashtim nga tarifa e urdhërit të ekzekutimit;
- xi. natyra e çështjes/ve juridike për të cilën është kërkuar ndihmë (civile, administrative, penale);
- xii. nëse kërkesa për ndihmë është pranuar apo refuzuar nga gjykata/ organi procedues, plotësisht apo pjesërisht;
- xiii. data dhe numri i vendimit përkates dhe nëse vendimi është apeluar (në agjykatë të shkallës së parë ose të apelit, respektivisht, dhe pala ankimuese);
- xiv. të dhëna mbi vendimin mbi ankimin kundër refuzimit të ndihmës juridike, sipas rastit
- xv. emri dhe të dhënat e avokatit të caktuar për dhënien e ndihmës juridike dytësore;
- xvi. pagesa të përfituara nga avokati;
- xvii. rimbursimi i pagesave nga pala gjyqëmbësore ose nga përfituesi i ndihmës juridike, sipas rastit.

8. Në regjistrimin e organizatave jofitimprurese që ofrojnë ndihmë juridike parësore regjistrohen, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. emërtimi i organizates jofitimprurese, përfaqesuesit të saj ligjor dhe të dhënat e kontaktit;
- li. të dhëna mbi vendimin e Ministrit të Drejtësisë për autorizimin e organizatës jofitimprurese;
- iii. juridiksioni ose zona gjeografike ku organizata jofitimprurese është autorizuar të japë ndihmë juridike parësore, si dhe specifikime të tjera mbi llojin e ndihmës parësore për të cilën është autorizuar
- iv. të dhëna mbi kontratën e financimit për ofrimin ndihmës juridike parësore, nëse ka lidhur një kontratë të tillë;
- v. të dhëna për revokimin e autorizimit të leshuar nga Ministri i Drejtësisë, sipas rastit.

9. Regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese dhe i organizatave jofitimprurese që e ofrojnë ndihmë juridike falas (në vijim "Regjistrat") mbahet në formë elektronike.

10. Regjistrat bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

11. Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të Regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vleresohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Regjistrat plotësohen dhe perditësohen nga punonjësi i autorizuar me shkrim nga Drejtori i Ndihmës Juridike Falas,

13. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe perditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

14. Punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e Regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në Regjistrat, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e sakte.

15. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

16. Punonjësi i autorizuar plotëson dhe perditëson Regjistrat me të dhëna,

duke filluar nga dita e parë e ofrimit të shërbimit të dhënies së ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

17. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)

Udhëzim
nr. 1
08.03.2019

Aneks 6

Udhëzim nr. 2, datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë,” i ndryshuar, si dhe të nenit 31 pika 1 të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmen juridike të garantuar nga shteti”,

U D H Ë Z O J:

I. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas verifikon në mënyrë periodike, çdo vit, gjendjen ekonomike dhe financiare të subjekteve përfituese të ndihmës juridike, si dhe fazen në të cilën ndodhet gjykimi me palë subjektin përfitues.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas mund të kryejë verifikim në çdo kohë në rast se ka të dhëna apo indicie për ndryshimin e rrethanave.

2. Kontrata e financimit përfundon para afatit nëse ofruesi i shërbimit heq dorë nga shërbimi. Në këtë rast ai njofton menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas;
3. Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve do të zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin Civil”.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate.
2. Nëse kjo nuk është e mundur kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Adimistrative Tiranë.”

Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
2. Kjo kontratë përpilohet në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje të barazvlefshme, të nënshkruara me vullnet të plotë, të lirë dhe të pavesuar, nga palët kontraktuese si më poshtë:

ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE E AUTORIZUAR QË PËRFITON
FINANCIM

Përfaqësuar nga : _____

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Përfaqësuar nga : Z. Ergys Qirici Drejtor i Përgjithshëm”.

KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Kjo kontratë për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore (“Kontrata”) lidhet sot në [●], në datë [●], nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë:

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS, përfaqësuar nga Znj. _____; (këtu e më poshtë referuar si “**Kontraktori**”)

Dhe

Z.ZNJ. _____, shtetas _____, lindur më _____, në _____, banues në _____, identifikuar me Letërnjoftimin/Pasaportën me numër personal _____, numër _____; (këtu e më poshtë referuar si “**Ofruesi i Shërbimit**”)

Palët në këtë Kontratë do të referohen veçmas si “Pala” ose së bashku si “Palet”.

Neni 1 Objekti i kontrates

1.1. Objekti i kësaj Kontrate është ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, në favor të personave që kanë përfituar sipas një vendimi të formës së prerë të gjykatës kompetente, të drejtën e përfitimit të kësaj ndihme falas, sipas përcaktimeve të Ligjit 111/2017.

Neni 2 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

2.1. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe është e vlefshme për një afat 1 (një) vjeçar nga data e nënshkrimit por në cdo rast deri në miratimin e listës së re dhe lidhjes së kontratave të reja.

2.2. Afati i kësaj Kontrate mund të rinovohet me marrëveshje me shkrim mes Palëve.

2.3. Përfundimi i Kontrates 1- vjeçare nuk e pengon ofruesin e shërbimit të perfaqësorë përfituesin deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përveç kur ekzistojnë rrethanat për zëvendësimin e tij.

Neni 3

Parimet e ofrimit të ndihmës juridike dytësore

3.1. Dhënia e Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, bazohet vecanërisht mbi parimet e mëposhtme:

- a) aksesi i barabartë i individëve në ndihmën juridike;
- b) barazia dhe mosdiskriminimi i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmi në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) cilësia, efënca dhe efikasiteti në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtja e konfidencialitetit;
- dh) shmangia dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- e) mbrojtja e të drejtave të personave vulnerabël.

3.2. Përvec sa më sipër, dhënia e ndihmës juridike dytësore nga Ofruesi i Shërbimit bazohet mbi parimet e Kodit Etik të Avokatit.

3.3. Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen, përbën shkelje të rënde të kësaj Kontrate dhe passjell aplikimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë apo cdo ligji tjetër të aplikueshëm.

Neni 4

Tarifa e shërbimit dhe mënyra e pagesës

4.1. Tarifa e ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, përcaktohet sipas tarifave në Anesin bashkëlidhur kësaj kontrate ("Tarifa e Shërbimit").

4.2. Kontraktori do të paguajë Tarifën e Shërbimit, në llogarinë bankare të Ofruesit të Shërbimit me të dhëna si më poshtë:

Përfituesi:

Banka:

SWIFT:

IBAN:

Neni 5

Detyrimet dhe garancitë e palëve

5.1. Në kuptim të Ligjit 111/2017, shërbimet e Ndhmës Juridike Dytësore që Ofruesi i Shërbimit detyrohet të kryejë, përfshijnë por pa u kufizuar:

- Përpilimi i akteve të nevojshme për të venë në levizje gjykatën, kërkesa, kërkesë padi ose të çdo kërkesë procedurale që rezulton e

- nevojshme gjatë procesit gjyqësor;
- Perpilimi i akteve të mbrojtjes, për personat kunder të cilëve ka nisur një proces gjyqësor civil apo administrativ;
- Mbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit provues;
- Këshillimi mbi procesin gjyqësor civil ose administrativ;
- Perfaqesimi dhe mbrojtja para gjykatës në çështjet administrative dhe civile;
- Përgatitja e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, apo arbitrazhit;
- Përgatitjen e cdo lloj kërkesë drejtuar çdo gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, si dhe gjykatat ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë, lidhur me çështjen për të cilën ofron Ndihmë Juridike Dytësore, në favor të Perfituesit;
- Përveç sa parashikohet më sipër, Ofruesi i Sherbimit do të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Avokatinë, në kuptim të Ndihmës Juridike Dytësore, në Ligjin Nr.111.2017 si dhe në këtë Kontratë.

5.2. Ofruesi i Sherbimit deklaron dhe garanton se:

- i. Gëzon të gjitha cilësitë profesionale dhe kualifikimet e nevojshme, për të marrë përsiper detyrimet sipas kësaj Kontrate;
- ii. Do të ofrojë shërbimet e Ndihmës Juridike Dytësore, me standartet më të larta profesionale si dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate;
- iii. Do të veproje në kohë dhe pa shkaktuar asnjë vonesë në ofrimin e Ndihmës Juridike Dytësore, menjëhere me marrjen e njoftimit nga dhoma vendore e avokatisë, mbi vendimin e gjykatës e cila ka pranuar kërkesën për dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore ndaj Përfituesit.
- iv. Nuk do të heqë dorë nga dhënia e Ndihmës Juridike Dytësore, përveç kur janë rastet e heqjes dorë të përcaktuara nga Ligji për Avokatinë, përfshirë por pa u kufizuar në rastin e konfliktit të interesit.
- v. Në cdo rast të detyrimit për të hequr dorë, Ofruesi i Sherbimit do të informojë menjëhere dhomën vendore të avokatisë, me qëllim zëvendesimin e tij. Në këtë rast, Ofruesi i Sherbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore, deri në zëvendesimin e tij, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë si dhe do të zbatojë çdo dhe të gjitha detyrimet e parashikuara në Ligjin për Avokatinë;
- vi. Do të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore në favor të Përfituesit, vetëm kundrejt Tarifës së Shërbimit, pa pasur të drejtën e përfitimeve të tjera përveç Tarifës së Shërbimit;
- vii. Do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate duke

- mbajtur të padëmtuar Kontraktorin nga çdo veprim i kundert i tij;
- viii. Do të mbajë kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me Përfituesin, me qëllim informimin e tij të vazhdueshëm mbi çështjen për të cilën ofron Ndihmën Juridike Dytësore;
- ix. Do të paraqesë një raport në perfundim të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.
- x. Do të ofrojë shërbimin e ndihmës juridike me cilësi sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 531, datë 25.11.2019 “Kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

5.3. Kontraktori deklaron dhe garanton se:

- i. Do t’i paguajë Ofruesit të Shërbimit Tarifën e Shërbimit, pa vonesa, në përputhje me këtë Kontratë.
- ii. Të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet dhe të zbatojë çdo detyrim sipas Ligjit 111/2017, për të mundësuar dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore në favor të Përfituesit.

Neni 6

Klauzola anti-korrupsion

6.1. Në lidhje me këtë Kontratë, përveç Tarifës së Shërbimit të parashikuar në Nenin 4 më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të përfitojë, kërkojë apo pranojë, nga Përfituesi apo palë të tjera të përfshira në konflikt me të, asnjë pagesë, premtim për pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim, drejtpërdrejtë apo në menyrë të tërthortë.

6.2. Përveç sa më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të ofrojë, apo të premtojë, vete apo nëpërmjet personave të tretë, në favor të Palëve apo subjekteve të përfshira në procesin gjyqësor, ku Ofruesi i Shërbimit jep Ndihmë Juridike Dytësore, asnjë pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim.

6.3. Çdo shkelje e parashikimeve sipas paragrafëve 6.1. dhe 6.2. më sipër, do të përbëjë vepër penale në kuptim të legjislacionit penal në fuqi dhe Ofruesi i Shërbimit, do të jete subjekt procedimi sipas legjislacionit procedural penal dhe subjekt i procedimit etik, sipas legjislacionit për profesionin e avokatit.

Neni 7

Kontraktuesi i pavaruar

7.1. Palët e kësaj Kontrate bien dakort që Ofruesi i Shërbimit është

kontraktues i pavaruar në raport me Kontraktorin dhe për asnjë arsye ose shkak nuk do të konsiderohet si punëmarres i tij.

Neni 8

Parimi i mirëbesimit dhe konfidencialiteti

8.1. Palët nuk do të demtojnë interesat e njera-tjetres, reputacionin dhe imazhin. Ato do të veprojnë në mirëbesim ndaj njëra-tjetrës dhe do të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Kontrate, ligji dhe konventat ndërkombëtare.

8.2. Palët do të veprojnë në mirëbesim, duke kryer çdo dhe të gjitha veprimet e nevojshme, për mbrojtjen e interesave të ligjshëm të secilës Palë.

8.3. Palët janë të detyruar të mbajnë rreptesisht konfidenciale këtë Kontratë, përmbajtjen e saj, të dhënat personale respektive si dhe çdo të dhenë tjetër pa asnjë kufizim.

8.4. Asnjë prej Paleve nuk do të konsiderohet se është në shkelje të këtij detyrimi nëse përhapja apo transferimi i informacioneve e të dhënave të mësipërme buron nga një detyrim ligjor duke përfshirë por pa u kufizuar në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, legjislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë apo nga vendimet dhe urdhrat e Prokurorisë apo Gjykatave.

Neni 9

Përfundimi i kontratës

9.1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht në datën e përcaktuar në Nenin 2 më sipër.

9.2. Kontraktori mund të zgjidhe menjëherë këtë Kontratë, në rast se Ofruesi i Shërbimit shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontrate, apo në Ligjin 111/2017.

9.3. Ofruesi i Shërbimit mund të zgjidhe këtë Kontratë, duke njoftuar paraprakisht dhomën vendore të avokatisë. Në kete rast, Ofruesi i Shërbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihme Juridike Dytësore ndaj Perfituesit deri në zëvendesimin e tij nga dhoma vendore e avokatisë.

Neni 10 **Të ndryshme**

10.1. Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen dhe mirekuptimin mes Palëve dhe shfuqizon çdo marrëveshje tjetër të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.

10.2. Asnjë ndryshim, modifikim, përfundim, heqje dore nga çdo pikë e kesaj Kontrate nuk do të ketë efekt nëse nuk është me shkrim dhe e nenshkruar nga te dy Palet.

10.3. Mosushtrimi apo vonesa në ushtrimin e një të drejte ose dëmshperblimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në ligj nuk përbën heqje dore nga e drejta ose dëmshperblimi, apo heqje dore nga të drejta ose dëmshperblime të tjera. Asnjë ushtrim pjesor apo i plotë i së drejtës ose dëmshperblimit të parashikuar në këtë Kontratë nuk ndalon ushtrimin e mëtejshem të së drejtave ose dëmshperblimeve të tjera.

10.4. Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

10.5. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës. Nëse kjo nuk është e mundur, juridiksioni kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që burojnë nga ekzekutimi i kësaj Kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PALËT

KONTRAKTORI
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE EALAS

OFRUESI I SHËRBIMIT

Përfaqësuar nga:

Aneks 10

Udhëzim nr. 6, datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtim në rastin e dhënies së ndihmës juridike”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 7 gërma “gj” dhe nenit 28 pika 4, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Ministri i Drejtësisë,

UDHËZON:

1. Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, në kuptim të ligjit nr. 111/2017, date 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve për deshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural, për të cilat gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.
3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat bazuar në vendimin gjyqësor, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve gjatë procesit gjyqësor”, i ndryshuar.
4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e shpalljes të vendimit nga gjykata për përjashtimin nga pagesat e shpenzimeve gjyqësore, dëshmitari, eksperti dhe përkthyesi paraqesin pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dokumente tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin vërtetues, si vijon:
 - a) dokumentin tatimor për shpenzimet e transportit;
 - b) dokumentin tatimor për shpenzimet e fjetjes;
 - c) dokumentin me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës;
 - d) vërtetimin bankar nga një bankë e nivelit të dytë për deklarimin e numrit të llogarisë në lekë.
5. Mosparaqitja e dokumentacionit tatimor nga ana e dëshmitarit,

ekspertit dhe përkthyesit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për tatimet përbën shkak për mos kryerjen e pagesave për shërbimet e ofruara dhe për të cilat është vendosur përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore.

6. Në fund të çdo muaji, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, harton një raport mbi vendimet gjyqësore të njoftuara, dokumentet tatimore të paraqitura për secilin vendim, përllogaritjen e shpenzimeve ditore dhe buxhetin në dispozicion për pagesën e tyre. Bazuar në këtë analizë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve gjyqësore, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe te plotësuara me dokumentacionin provues.
7. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton dëshmitarin, ekspertin, përkthyesin, gjykatën që ka dhënë vendimin dhe përfituesin e ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti, të cilit i është pranuar kërkesa për përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, për kryerjen e pagesës së shpenzimeve gjyqësore.
 - Njoftimi shoqërohet me një kopje të vërtetimit të dhënë nga banka që vërteton kryerjen e pagesës.
 - Njoftimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga kryerja e pagesës, në rrugë postare, elektronike si dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
8. Në rastin kur limiti mujor është i pamjaftueshëm për likuidimin e plotë të shpenzimeve gjyqësore, likuidimi shtyhet në muajin pasardhës, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të plotësuara me dokumentacionin tatimor provues.
9. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore për pagesën e të gjitha shpenzimeve gjyqësore të përllogaritura, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të kontabilizojë çdo detyrim të mbartur, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare si dhe të planifikojë fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, për periudhat e ardhshme buxhetore.
10. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)

Aneks 11

Vendim nr. 231, datë 12.11.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal”

Në mbështetje të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 6 dhe 7, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike, të garantuar nga shteti”; të nenit 159, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazën e parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në procesin penal”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

**RREGULLORE
PËR
RREGULLAT E GARANTIMIT TË MBROJTJES SË DETYRUESHME
DHE CAKTIMIN MBI BAZËN E PARIMIT TË ROTACIONIT TË
AVOKATIT MBROJTËS NGA LISTA E AVOKATËVE QË OFROJNË
SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE NË PROCESIN
PENAL**

Në zbatim të nenit 49 dhe nenit 49/a, të ligjit nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 21, pika 6 dhe 7, të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike, të garantuar nga shteti"; të nenit 159, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullave të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme dhe mbrojtjen për të pandehurin pa mjete të mjaftueshme financiare, në procesin penal, nga ana e institucioneve të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
2. Organi procedues që fillon hetimet detyrohet të zbatojë rregullat për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e Ndihmës Juridike Dytësore në procesin penal.
3. Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik përcjell listat e miratuara, sipas procedurës së poshtëshënuar, si dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare.
4. Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë organizon shortin në një ambient të përshtatshëm dhe njoftonparaprakisht avokatët, që janë pjesë e listës për të qënë të pranishëm. Njoftimi përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shortit.
5. Pas zhvillimit të shortit, Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë rendit avokatët sipas rendit alfabetik. Përzgjedhja e avokatëve bëhet me totacion nëmënyrë të njëpasnjëshme nga lista, duke filluar nga Nr. 1 i listës, më pas kalohet tek nr. 2 dhe kështu me radhë deri në mbarimin e listës.
6. Avokatët e përfshirë në listën e ndihmës juridike ushtrojnë funksionet e mbrojtësit ligjor në procesin penal:

- a) Për të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare, sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";
 - b) Për të pandehurit që ndodhen në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a të Kodit të Procedurës Penale.
7. Lista e parë përbëhet nga avokatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.
8. Lista e dytë përbëhet nga avokatët e specializuar dhe të trajnuar në çështje për të mitur, për viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe abuzimit seksual.
9. Pranë organit të prokurorisë caktohet një person përgjegjës nga personeli administrativ për respektimin e rotacionit të avokatëve, sipas listës së miratuar nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë.
9. Kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të sigurohet nga lista e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, mbrojtja garantohet nga lista e avokatëve që ofrojnë Ndihmë Juridike Dytësore në procesin penal.
10. Avokati i caktuar nga lista e miratuar për ndihmën juridike pushon se ushtruar funksionet e tij si mbrojtës, kur:
- a) Ekzistojnë kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe avokati i ndihmës juridike zëvendësohet sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, kopja e procesverbalit të zëvendësimit të avokatit e mbajtur pranë organit procedues depozitohet pranë strukturave përgjegjëse që ofrojnë ndihmë juridike;
 - b) I pandehuri, pa mjete të mjaftueshme financiare, nuk pranon mbrojtjen e mëtejshme të tij, sipas parashikimit në pikën 5, të nenit 24, të ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
11. Organi procedues nis veprimet hetimore që kanë nevojë për t'u bërë në prani të avokatit mbrojtës, vetëm pas një afati kohor jo më pak se një orë, që nis pas paraqitjes së avokatit tek organi procedues, me qëllim që avokati të konsultohet me të pandehurin dhe aktet e dosjes hetimore.

12. Në rastet kur ndryshojnë kushtet për gëzimin e mbrojtjes së detyrueshme, organi procedues e njofton dhe asiston të pandehurin të aplikojë për përfitimin e ndihmës juridike falas sipas llojit të ndihmës juridike.
13. Organi procedues pas caktimit të avokatit mbrojtës i jep mundësi atij për t'u paraqitur në një kohë sa më të shpejtë në vendin e kërkuar.
14. Organi procedues kontakton me telefon dhe/ose nëpërmjet postës elektronike me avokatin e caktuar në detyrë, sipas renditjes së përcaktuar në listën e vënë në dispozicion nga dhoma vendore e avokatisë.
15. Në rast se avokati i përgjigjet telefonatës ose postës elektronike dhe konfirmon mbrojtjen sipas rastit të paraqitur, atij i lihet një kohë jo më e shkurtër se një orë, për t'u paraqitur në vendin e kërkuar.
16. Me marrjen përsipër të mbrojtjes, avokati i caktuar për mbrojtjen juridike dytësore, sipas kërkesave të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike, të garantuar nga shteti", lidh kontratën për detyrimet e palëve sipas formatit bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
17. Në rast se avokati, pas marrjes së njoftimit refuzon marrjen përsipër të detyrës, vijohet me kontaktimin e avokatit të radhës në listë.
18. Në rast se avokati nuk i përgjigjet telefonatës ose postës elektronike, atij i lihet një kohë prej 20 minutash për të kthyer përgjigje.
19. Në rast se avokati është i padisponueshëm, provohet të kontaktohet sërish pas 20 minutash.
20. Në rast të moskthimit të telefonatës/të postës elektronike pas njoftimit të dytë, organi procedues operon menjëherë me kontaktimin e avokatit të radhës në listë.
21. Në rast se avokati në detyrë, sipas kalendarit nuk do t'i përgjigjet thirrjes së organit procedues për 3 raste radhazi, kur kërkohet mbrojtja e tij, ai do të kalojë në fund të listës dhe do të zëvendësohet nga avokati në radhë i listës sipas renditjes. Në këtë rast, avokati zëvendësues nuk e humbet radhën e tij të caktimit në detyrë.
22. Organi procedues njofton me shkrim Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për rastet e refuzimit dhe/ose të mospërgjigjes së avokatëve të caktuar në listën e ofrimit të ndihmës juridike falas.
23. Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë merr masa që, nëse ka mungesë të listave të avokatëve të caktuar në një rreth gjyqësor, t'i kërkojë

dhomës vendore të avokatisë më të afërt me organin procedues të atij rrethi gjyqësor, të verë në dispozicion të organeve proceduese listën dhe renditjen e avokatëve të caktuar për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

24. Në momentin e ndalimit, organi procedues ka për detyrë që të njoftojë dhe t'i shpjegojë të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit:
 - a) Të drejtën e tij/e saj për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti, në rast të pamundësisë financiare për ta përballuar vetë një avokat mbrojtës nga tregu;
 - b) të drejtën e tij/e saj për të përfituar ndihmë juridike falas, në rast se plotësohen kushtet për të përfituar nga mbrojtja e detyrueshme, sipas neneve 49 dhe 49/a të Kodit të Procedurës Penale.
25. Organi procedues i vendos në dispozicion të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit për të plotësuar një deklaratë/formular, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ku duhet të deklarojë gjendjen ekonomike dhe të shprehë vullnetin se kërkon të mbrohet me një avokat të caktuar nga shteti.
26. Organi procedues vendos rast pas rasti nëse i ndaluarit/ të arrestuarit/i pandehuri mund të përfitojë mbrojtje nga një avokat i caktuar për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.
27. Organi procedues merr masa që të kryejë veprimet në prani të avokatit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.
28. Organi procedues në caktimin e avokatëve për ndihmën juridike falas respekton parimin sipas të cilit avokati i caktuar në një fazë të procedimit mbron klientin në të gjitha fazat e hetimit dhe gjykimit.
29. Avokati mund të zëvendësohet sipas kushteve të kësaj rregulloreje dhe, përjashtimisht, nëse plotësohen këto kushte:
 - a) Avokati është në kushtet e konfliktit të interesit;
 - b) Avokati dhe/ose i ndaluarit/të arrestuarit/i pandehuri paraqet një kërkesë të arsyetuar me shkrim për heqjen dorë;
 - c) Avokati nuk paraqitet para organit procedues në mënyrë të përsëritur dhe të paarsyeshme;
 - d) Avokati, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, nuk është në gjendje për të përfaqësuar klientin në atë çështje;
 - e) Shkaqe të tjera të parashikuara me ligj ose akte nënligjore.
30. Nëse avokati i caktuar për të ofruar ndihmën juridike ka pengesa për angazhimin dhe vazhdimin e mbrojtjes duhet t'i drejtohet organit

procedues dhe Dhomës Vendore të Avokatisë me një kërkesë të arsyetuar.

31. Avokati i caktuar nga lista e miratuar për ndihmën juridike pushon se ushtruari funksionet e tij si mbrojtës, kur:
- a) Ekzistojnë kushtet e mbrojtjes së detyrueshme dhe avokati i ndihmës juridike zëvendësohet sipas parashikimeve të nenit 49, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë rast, kopja e procesverbalit të zëvendësimit të avokatit e mbajtur pranë organit procedues depozitohet pranë strukturave përgjegjëse që ofrojnë ndihmë juridike;
 - b) I pandehuri, pa mjete të mjaftueshme financiare, nuk pranon mbrojtjen e mëtejshme të tij, sipas parashikimit në pikën 5, të nenit 24, të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
32. Prokurori fillon procedurën e zëvendësimit dhe njofton Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.
33. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai të zëvendësohet me një avokat tjetër.
34. Organi procedues i kërkon të ndaluarit/të arrestuarit/të pandehurit që të plotësojë formularin, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për vlerësimin e punës së avokatit të caktuar.
35. Për viktimat e veprës penale dhe viktimat akuzuese për pretendimet e tyre, në lidhje me ngritjen e padisë civile brenda dhe jashtë procesit penal, zbatohen rregullat sipas udhëzimit për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike.
36. I padituri civil në procesin penal, si rregull mbrohet nga i njëjti avokat i caktuar për të ndjekur procesin penal. Në rast se avokati nuk dëshiron të ndjekë çështjen civile, avokati zëvendësohet sipas rregullave të rotacionit dhe sipas kalendarit të çështjeve.
37. Shpërblimi për punën e kryer nga avokati gjatë procesit të dhënies së ndihmës juridike falas bëhet:
- a) Për ndihmën juridike për personat pa mjete të mjaftueshme financiare kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Për ndihmën juridike në kushtet e mbrojtjes së detyrueshme, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 7 dhe nenit 49/a të Kodit të

Procedurës Penale, kryhet nga Organi i Prokurorisë.

38. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregullore Organi i Prokurorisë dhe i Policisë Gjyqësore, Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë, Dhomat Vendore të Avokatisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.
39. Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË KONTRATË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE JURIDIKE DYTËSORE

Kjo kontratë për ofrimin e shërbimit të Ndhmës Juridike Dytësore (Kontrata) lidhet sot në _____, në datën _____.____.2020, nga dhe nëpërmjet palëve, si me poshtë:

Prokuroria _____, përfaqësuar nga z./zgj.

_____ (këtu me poshtë referuar si “Kontraktori”)

Dhe

Z./Zgj. _____, shtetas _____, lindurmë _____,

Banues në _____, identifikuar me ID/pasaportë, me numër personal _____

(këtu më poshtë referuar si “Ofertuesi i Shërbimit”).

Palët në këtë Kontratë do të referohen veçmas si “Pala” ose së bashku si “Palët”.

Neni 1 Objekti i kontrates

1.1. Objekti i kësaj Kontrate është ofrimi i shërbimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, në favor të personave që kanë përfituar sipas një vendimi të formës së prerë të gjykatës kompetente, të drejtën e përfitimit të kësaj ndihme falas, sipas përcaktimeve të Ligjit 111/2017.

Neni 2 Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

2.1. Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët dhe është e vlefshme për një afat 1 (një) vjecar nga data e nënshkrimit por në cdo rast deri në miratimin e listës së re dhe lidhjes së kontratave të reja.

2.2. Afati i kësaj Kontrate mund të rinovohet me marrëveshje me shkrim mes Palëve.

2.3. Përfundimi i Kontrates 1 vjecare nuk e pengon ofruesin e shërbimit të përfaqësorë përfituesin deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, përveç kur ekzistojnë rrethanat për zëvendesimin e tij.

Neni 3

Parimet e ofrimit të ndihmës juridike dytësore

3.1. Dhënia e Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, bazohet vecanërisht mbi parimet e mëposhtme:

- a) aksesi i barabartë i individëve në ndihmën juridike;
- b) barazia dhe mosdiskriminimi i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmi në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) cilësia, efënca dhe efikasiteti në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtja e konfidencialitetit;
- dh) shmangia dhe parandalimi i konfliktit të interesit;
- e) mbrojtja e të drejtave të personave vulnerabël.

3.2. Përvec sa më sipër, dhënia e ndihmës juridike dytësore nga Ofruesi i Shërbimit bazohet mbi parimet e Kodit Etik të Avokatit.

3.3. Shkelja e parimeve të përcaktuara në këtë nen, përbën shkelje të rënde të kësaj Kontrate dhe passjell aplikimin e sanksioneve dhe masave disiplinore, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë apo cdo ligji tjetër të aplikueshëm.

Neni 4

Tarifa e shërbimit dhe mënyra e pagesës

4.1. Tarifa e ofrimit të Ndhmës Juridike Dytësore nga Ofruesi i Shërbimit, përcaktohet sipas tarifave në fuqi të miratuara, bashkëlidhur kësaj kontrate.

4.2. Kontraktori do të paguajë Tarifën e Shërbimit, në llogarinë bankare të Ofruesit të Shërbimit me të dhëna si më poshtë:

Përfituesi:

Banka:

SWIFT:

IBAN:

Neni 5

Detyrimet dhe garancitë e palëve

5.1. Në kuptim të Ligjit 111/2017, shërbimet e Ndhmës Juridike Dytësore që Ofruesi i Shërbimit detyrohet të kryejë, përfshijnë por pa u kufizuar:

- Përpilimi i akteve të nevojshme për të venë në levizje gjykatën,

kërkesa, kërkesë padi ose të çdo kërkesë procedurale që rezulton e nevojshme gjatë procesit gjyqësor;

- Perpilimi i akteve të mbrojtjes, për personat kunder të cilëve ka nisur një proces penal, gjyqësor apo administrativ;
- Mbledhja dhe përgatitja e dokumentacionit provues;
- Këshillimi mbi procesin penal/ gjyqësor civil ose administrativ;
- Perfaqësimi dhe mbrojtja para prokurorit/gjykatës në çështjet penale/ administrative dhe civile;
- Përgatitja e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, apo arbitrazhit;
- Përgatitja e cdo lloj kërkesë drejtuar prokurorisë apo çdo gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën Kushtetuese, si dhe gjykatat ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë, lidhur me çështjen për të cilën ofron Ndihmë Juridike Dytësore, në favor të Përfituesit;
- Përveç sa parashikohet më sipër, Ofruesi i Sherbimit do të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin për Avokatinë, në kuptim të Ndihmës Juridike Dytësore, në Ligjin Nr.111.2017 si dhe në këtë Kontratë.

5.2. Ofruesi i Sherbimit deklaron se:

- i. Gëzon të gjitha cilësitë profesionale dhe kualifikimet e nevojshme, për të marrë përsiper detyrimet sipas kësaj Kontrate;
- ii. Do të ofrojë shërbimet e Ndihmës Juridike Dytësore, me standartet më të larta profesionale si dhe në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate;
- iii. Do të veproje në kohë dhe pa shkaktuar asnjë vonese në ofrimin e Ndihmës Juridike Dytësore, menjëherë me marrjen e njoftimit nga Organi i Prokurorisë, mbi vendimin e prokurorisë ose gjykatës e cila ka pranuar kërkesën për dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore ndaj Përfituesit.
- iv. Nuk do të heqë dorë nga dhënia e Ndihmës Juridike Dytësore, përveç kur janë rastet e heqjes dorë të përcaktuara nga Ligji për Avokatinë, përfshirë por pa u kufizuar në rastin e konfliktit të interesit.
- v. Në cdo rast të detyrimit për të hequr dorë, Ofruesi i Sherbimit do të informoje menjëherë prokurorin/gjykatën, me qëllim zëvendesimin e tij. Në këtë rast, Ofruesi i Sherbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore, deri në zëvendesimin e tij, sipas parashikimeve të Ligjit për Avokatinë si dhe do të zbatojë të gjitha detyrimet e parashikuara në Ligjin për Avokatinë;
- vi. Do të ofrojë Ndihmën Juridike Dytësore në favor të Përfituesit, vetëm kundrejt Tarifës së Shërbimit, pa pasur të drejtën e përfitimeve të tjera përveç Tarifës së Shërbimit;

- vii. Do të sigurojë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate duke mbajtur të padëmtuar Kontraktorin nga çdo veprim i kundert i tij;
- viii. Do të mbajë kontakte të rregullta dhe të vazhdueshme me Përfituesin, me qëllim informimin e tij të vazhdueshëm mbi çeshtjen për të cilën ofron Ndihmen Juridike Dytësore;
- ix. Do të paraqesë një raport në perfundim të punës, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë/ Organi i Prokurorisë.

5.3. Kontraktori deklaron dhe garanton se:

- i. Do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimit Tarifën e Shërbimit, pa vonesa, në përputhje me këtë Kontratë.
- ii. Të kryejë çdo dhe të gjitha veprimet dhe të zbatojë çdo detyrim sipas Ligjit 111/2017, për të mundësuar dhënien e Ndihmës Juridike Dytësore në favor të Përfituesit.

Neni 6

Klauzola anti-korrupsion

6.1. Në lidhje me këtë Kontratë, përveç Tarifës së Shërbimit të parashikuar në Nenin 4 më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të përfitojë, kërkojë apo pranojë, nga Përfituesi apo palë të tjera të përfshira në konflikt me të, asnjë pagesë, premtim për pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim, drejtpërdrejtë apo në menyrë të tërthortë.

6.2. Përveç sa më sipër, Ofruesi i Shërbimit nuk do të ofrojë, apo të premtojë, vete apo nëpërmjet personave të tretë, në favor të Palëve apo subjekteve të përfshira në procesin gjyqësor, ku Ofruesi i Shërbimit jep Ndihmë Juridike Dytësore, asnjë pagesë, përfitim, dhuratë apo shpërblim.

6.3. Çdo shkelje e parashikimeve sipas paragrafëve 6.1. dhe 6.2. më sipër, do të përbëjë vepër penale në kuptim të legjislacionit penal në fuqi dhe Ofruesi i Shërbimit, do të jete subjekt procedimi sipas legjislacionit procedural penal dhe subjekt i procedimit etik, sipas legjislacionit për profesionin e avokatit.

Neni 7

Kontraktuesi i pavaruar

7.1. Palët e kësaj Kontrate bien dakort që Ofruesi i Shërbimit është kontraktues i pavaruar në raport me Kontraktorin dhe për asnjë arsye ose shkak nuk do të konsiderohet si punëmarres i tij.

Neni 8

Parimi i mirëbesimit dhe konfidencialiteti

8.1. Palët nuk do të demtojnë interesat e njera - tjetres, reputacionin dhe imazhin. Ato do të veprojnë në mirëbesim ndaj njera - tjetres dhe do të respektojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Kontrate, ligji dhe konventat ndërkombëtare.

8.2. Palët do të veprojnë në mirëbesim, duke kryer çdo dhe të gjitha veprimet e nevojshme, për mbrojtjen e interesave të ligjshëm të secilës Palë.

8.3. Palët janë të detyruar të mbajnë rreptesisht konfidenciale këtë Kontratë, përmbajtjen e saj, të dhënat personale respektive si dhe çdo të dhenë tjetër pa asnje kufizim.

8.4. Asnjë prej Paleve nuk do të konsiderohet se është në shkelje të këtij detyrimi nëse perhapja apo transferimi i informacioneve e të dhënave të mësipërme buron nga një detyrim ligjor duke përfshirë por pa u kufizuar në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 9

Përfundimi i kontratës

9.1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht në datën e përcaktuar në Nenin 2 te saj.

9.2. Kontraktori mund të zgjidhe menjëhere këtë Kontratë, në rast se Ofruesi i Shërbimit shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontrate, apo në Ligjin 111/2017.

9.3. Ofruesi i Shërbimit mund të zgjidhe këtë Kontratë, duke njoftuar paraprakisht Prokurorin/Gjykatën. Në kete rast, Ofruesi i Shërbimit, do të vazhdojë të ofrojë Ndihe Juridike Dytësore ndaj Perfituesit deri në zëvendesimin e tij nga Prokuroria/Gjykata.

Neni 10

Të ndryshme

10.1. Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen dhe mirekuptimin mes Palëve dhe shfuqizon çdo marrëveshje tjetër të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj.

10.2. Asnjë ndryshim, përfundim, heqje dore nga çdo pikë e kesaj Kontrate nuk do të ketë efekt nëse nuk është me shkrim dhe e nenshkruar nga të dy Palet.

10.3. Mosushtrimi apo vonesa në ushtrimin e një të drejte ose dëmshperblimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose në ligj nuk përbën heqje dore nga e drejta ose dëmshperblimi, apo heqje dore nga të drejta ose dëmshpërblime të tjera. Asnjë ushtrim pjesor apo i plotë i së drejtës ose dëmshperblimit të parashikuar në këtë Kontratë nuk ndalon ushtrimin e mëtejshem të së drejtave ose dëmshpërblimeve të tjera.

10.4. Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

10.5. Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës. Nëse kjo nuk është e mundur, juridiksioni kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që burojnë nga ekzekutimi i kësaj Kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

PALËT

**KONTRAKTORI
PROKURORI**

OFRUESI I SHËRBIMIT

AV. _____

Aneks 12

Urdhër nr.531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga drejtoria e ndihmës juridike falas të shërbimeve të ndihmës juridike”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “f”, të nenit 7, të ligjit nr. 111, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve falas juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike sipas shtojcës, bashkëlidhur këtij urdhëri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.
3. Ngarkohen Sektori i Arkiv – Protokollit për njoftimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Etilda Gjonaj (Saliu)

**KRITERET E VLERËSIMIT,
METODOLOGJIA DHE
PROCEDURAT E MBIKËQYRJES
TË NDIHMËS JURIDIKE**

TABELA E LËNDËS

I. HYRJE.....	195
II. NDIHMA JURIDIKE.....	196
III. QËLLIMI I NDIHMËS JURIDIKE	197
IV. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	197
V. PROCEDURAT E MBIQYRJES DHE KOORDINIMIT.....	229
ANKESI 1	233
ANKESI 2	234
ANKESI 3	235
ANKESI 4	237
ANKESI 5	239
ANKESI 6	241

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

SHKURTIME	PËRKUFIZIME
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
IKV	Indikatorët Kryesor të Vlerësimit
Ligji Nr. 111/2017	Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
Ligji Nr. 55/2018	Ligji Nr. 55/2018 datë 23.7.2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.
Kodi i Etikës Profesionale	Kodi i Etikës së Avokatit miratuar nga Dhoma e Avokatisë
Zyra e ndihmës juridike parësore	I referohet qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore të përmendura në Ligjin Nr. 111/2017 përfshirë edhe organizatat jofitimprurëse të përmendura në ligj.

I. HYRJE¹³

Ky dokument është hartuar dhe miratuar në kuadër të Nenit 7 (f) të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky dokument përmban metodologjinë e vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti bazuar në kriteret e përcaktuara këtu si dhe procedurat e mbikqyrjes që do të zbatohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas gjatë ushtrimit të veprimtarisë së dhënies së ndihmës juridike.

13 Për hartimin e kësaj metodologjie janë konsultuar një sërë modelesh dhe metodologjishë vlerësimi dhe përkatësisht:

- I. *Assessment of the free secondary legal aid system in Ukraine in the light of Council of Europe Standards and Best Practices, Council of Europe, September 2016.*
- II. *American Bar Association, Standards for the Provision of Civil Legal Aid, August 2006.*
- III. *Practice Standards for Legal Aid Provides, Ministry of Justice, Neë Zeland Government, February 2017.*
- IV. *“Evaluating Systems for Delivering Legal Service to the Poor: Conceptual and Methodological Considerations”, Fordham Law Review, Volume 67 Issue 5, Gregg G. Van Ryzin and Marianne Engelman Lado, 1999.*

II. NDIHMA JURIDIKE

Ndihma juridike falas është një shërbim i konsoliduar në shumë vende të zhvilluara. Nevoja për ofrimin e shërbimeve juridike falas ka lindur si pasojë e të jetuarit në një shoqëri gjithmonë e më komplekse të përbërë nga një mori ligjesh dhe procedurash administrative të cilat rregullojnë jetën e përditshme të qytetarëve. Kështu në shumë fusha është bërë e domosdoshme marrja e këshillimit ligjor të specializuar për kryerjen e procedurave administrative apo mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve. Nga ana tjetër shërbimet ligjore janë bërë gjithmonë e më të kushtueshme dhe shpeshherë të papërballueshme nga qytetarët me të ardhura të kufizuara ekonomike.

Koncepti dhe modelet e ndihmës juridike falas kanë lindur kryesisht me synim ofrimin e shërbimeve të përfaqësimit gjyqësor. Megjithatë është vënë re se ka një sërë çështjesh dhe situatash të cilat jo domosdoshmërisht zgjidhen në rrugë gjyqësore. Me një ndërhyrje të hershme të specializuar këto çështje mund të zgjidhen që në fazën administrative kur kanë të bëjnë me marrëdhëniet e qytetarit me administratën publike, ose nëpërmjet zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve në rastet e mosmarrëveshjeve civile. Edhe për këto raste, qytetarët kanë nevojë për konsulencë ligjore të specializuar të cilën mund të mos jenë në gjendje ta përballojnë ekonomikisht kur të ardhurat e tyre ekonomike janë të kufizuara.

Për trajtimin e të gjitha rasteve të sipërpërmendura, Ligji Nr. 111/2017 ka ri-organizuar dhe ri-strukturuar konceptin e ndihmës juridike të garantuar nga shtetit dhe të ndarë në dy shtyllat e ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore.

Sipas nenit 3 (b) të Ligjit Nr. 111/2017, Ndihma Juridike Parësore përkon me kryerjen e shërbimeve të mëposhtëme ligjore:

- i.** dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- ii.** dhënien e këshillimit ligjor për raste konkrete;
- iii.** dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- iv.** dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- v.** përfaqësimin përpara organeve administrative; dhe

vi. dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Sipa nenit 3 (c) të Ligjit Nr. 111/2017 Ndhimja Juridike Dytësore është shërbimi juridik që përkon kryerjen e shërbimeve të /mëposhtëme ligjore:

- i. përpilimi i akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- ii. ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

III. QËLLIMI I NDIHMËS JURIDIKE

Ndhimja juridike falas e garantuar nga shteti dhe e rregulluar me Ligjin Nr. 111/2017 ka disa qëllime dhe objektiva të mirëpërcaktuara. Këto qëllime janë:

- i. krijimi i një sistemi të ndihmës juridike falas i cili siguron akses të barabratë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;
- ii. mirorganizimi, miradministrimi dhe mirëfeksionimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;
- iii. garantimin e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive

IV. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Qëllimet e ndihmës juridike falas janë udhëzuesi i mënyrës së ushtrimit të kësaj veprimtarie. Më konkretisht veprimtaria e ndihmës juridike falas, duhet të ushtrohet në mënyrë të tillë që të krijojë **akses në drejtësi** edhe për qytetarët me vështirësi ekonomike, duhet të jetë e **mirëorganizuar**, e **mirëadministruar** dhe **funksionale**; dhe duhet të garantojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike të cilat të jenë **profesionale, cilësore, efçente dhe efektive**.


Qëllimet e sipërpërmendura duhet të mbahen në konsideratë në hartimin e metodologjisë së vlerësimit. Vetëm duke pasur të qarta qëllimet e veprimtarisë që vlerësohet mund të përcaktohet qartësisht çfarë do të vlerësohet dhe si do të vlerësohet.

1. Çfarë do të vlerësohet

Nisur nga qëllimet e ndihmës juridike, si përfaqëse e përgjithshme mund të thuhet se do të vlerësohet nëse mënyra e dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore i përmbush qëllimet e përgjithshme të ofrimit të aksesit në drejtësi, të mirëorganizimit, mirëadministrimit, mirëfunktionimit, profesionalizmit, cilësisë, eficensë dhe efektivitetit. Të gjithë këto elemente janë ngushtësisht të lidhura me njëra tjetrën dhe përmbushja e secilës prej tyre ndikon në realizimin e qëllimeve të sistemit të ndihmës juridike falas. Si rrjedhojë, për të vlerësuar nëse sistemi i ngritur i përmbush qëllimet e tij duhet të identifikohen dhe vlerësohen elemente konkret të sistemit për të cilat mund të mblidhen të dhëna objektive.

Në këtë rast, vlerësimi i sistemit të ndihmës juridike do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të dy shtyllave kryesore mbi të cilat ngrihet ky sistem dhe përkatësisht të Strukturës Organizative dhe Burimeve Njerëzore. Elementet përbërëse të secilës shtyllë do të vlerësohen bazuar në Indikatorët Kryesor të Vlerësimit (IKV) të identifikuar më poshtë.

Figura 1 – Shtyllat e vlerësimit të ndihmës juridike



2. Si do të vlerësohet

Shtyllat e vlerësimit të ndihmës juridike, të paraqitura në Figurën 1 më sipër do të vlerësohen bazuar në indikatorët kryesorë të vlerësimit (IKV) dhe sistemin e pikëzimit. Për shkak të specifikave dhe nevojave të ndryshme të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe ndihmës juridike dytësore, secili nga të dy sistemet do të ketë krahas IKV-ve të

njëta edhe IKV specifike vlerësimi. Për qartësi IKV-të e ndihmës juridike parësore dhe IKV-të e ndihmës juridike dytësore sëbashku me sistemin e pikëzimit përkatëse do të paraqiten në dy tabela specifike.

2.1. IKV-të e Ndhmës Juridike Parësore

Sipas Ligjit Nr. 111/2017 ndihma juridike parësore do të ofrohet nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore të vendosura në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme dhe nga organizatat jofitimprurëse të cilat lidhin një kontratë me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore.

Për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të qendrave të reja që do të ngrihen për ndihmën juridike parësore si dhe të organizatave fitimprurëse që do të lidhin kontratën me DNJF-në janë identifikuar më poshtë Indikatorët Kryesorë të Vlerësimit të ndara në IKV të strukturës organizative dhe IKV të burimeve njerëzore.

Tabela 1 – IKV Ndhma Juridike Parësore

SHTYLLAT	FUSHA E VLERËSIMIT	IKV	SISTEMI I PIKËZIMIT
SHTYLLA I STRUKTURA ORGANIZATIVE	Përshtatshmëria e ambienteve pritës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Qendra Pritëse ✓ Zyra të brendshme ✓ Arkiv ✓ Mjetet e punës ✓ Aksesueshmëria e zyrës 	<p>1 Pikë = Shkëlqyeshëm: (përbushja e IKV-ve të fushës së vlerësimit është tejkaluar)</p> <p>2 Pikë = Shumë Mirë (IKV-ja është përbushur sipas të gjitha pritshmërive)</p>
	Përshtatshmëria e Procesit të Punes	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Përcaktimi dhe ndarja e qartë e funksioneve ✓ Procesi i pritjes dhe trajtimit të Klientëve ✓ Rregullorja e Procesit të Punës 	
SHTYLLA 2 BURIMET NJERËZORE	Përshtatshmëria e Kapaciteteve Profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Arsimi ✓ Kualifikimi profesional ✓ Trajnimi 	<p>3 Pikë = Mirë (IKV-ja është përbushur pjesërisht)</p> <p>4 Pikë = Keq (IKV-ja nuk përbushet)</p> <p>5 Pikë = Shumë keq (mospërbushje e rendë e IKV-së)</p> <p>N/A = e pazbatueshme</p>
	Respektimi i Kodit të Etikës Profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Pavarësia ✓ Ruajtja e konfidencialitetit ✓ Shmangia e konfliktit të interesit ✓ Trajtimi me dinjitet i klientit ✓ Kthimi i dokumentave 	
	Përshtatshmëria e Cilësisë së Shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Analizë e thelluar ✓ Cilësia e dokumentave të hartuara ✓ Koha e shqyrtimit ✓ Numri i rasteve të shqyrtuara 	

2.2. IKV-të e Ndhimës Juridike Dytësore

Ligji Nr. 111/2017 parashikon se ndihma juridike dytësore do të ofrohet nga Avokatët e përzgjedhur nga lista e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë brenda dates 1 Shkurt të çdo viti.

Për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të avokatëve të ndihmës juridike dytësore që do të lidhin kontratën me DNJF-në janë identifikuar më poshtë Indikatorët Kryesorë të Vlerësimit të ndara në IKV të strukturës organizative dhe IKV të burimeve njerëzore. Disa nga IKV-të e ndihmës juridike parësore të përmendura më sipër janë të zbatueshme edhe në vlerësimin e cilësisë së shërbimit të avokatëve të ndihmës juridike dytësore. Krahas tyre janë edhe IKV-të specifike për vlerësimin e ndihmës juridike dytësore siç përshkruhen në Tabelën 2 më poshtë.

Tabela 2 – IKV Ndhimja Juridike Dytësore

SHTYLLAT	FUSHA E VLERËSIMIT	IKV	SISTEMI I PIKËZIMIT
SHTYLLA 1 STRUKTURA ORGANIZATIVE/ ORGANIZIMI	Përshtatshmëria e ambienteve pritës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Zyra të brendshme ✓ Arkiv ✓ Mjetet e punës ✓ Aksesueshmëria e zyrës 	1 Pikë = Shkëlqyeshëm: (përbushja e IKV-ve të fushës së vlerësimit është tejkaluar)
	Përshtatshmëria e Procesit të Punës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Identifikimi i Afateve ✓ Trajtimi me përparësi ✓ Mbledhja e fakteve ✓ Mbledhja e provave ✓ Strategjia e Mbrojtjes 	
SHTYLLA 2 BURIMET NJERËZORE	Përshtatshmëria e Kapaciteteve Profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Arsimi ✓ Kualifikimi profesional ✓ Trajnimi 	2 Pikë = Shumë Mirë (IKV-ja është përbushur sipas të gjitha pritshmërive)
	Respektimi i Kodit të Etikës Profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Pavarësia ✓ Ruajtja e konfidencialitetit ✓ Shmangia e konfliktit të interes ✓ Trajtimi me dinjitet i klientit ✓ Kthimi i dokumentave 	
	Përshtatshmëria e Cilësisë së Shërbimit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Analizë e thelluar ✓ Cilësia e dokumentave të hartuara ✓ Pjesmarrja në seanca ✓ Respektimi i afateve procedurale ✓ Rezultati gjyqësor 	
			3 Pikë = Mirë (IKV-ja është përbushur pjesërisht)
			4 Pikë = Keq (IKV-ja nuk përbushet)
			5 Pikë = Shumë keq (mospërbushje e rendë e IKV-së)
			N/A = e pazbatueshme

3. Shpjegim i IKV-ve

Indikatorët kryesor të vlerësimit të përmendur më sipër përmbajnë tregues të cilët mundësojnë kryerjen e vlerësimit objektiv të situatës nëpërmjet të dhënave të identifikuar dhe të identifikueshme. Por në mënyrë që IKV-të të mund të maten nëpërmjet sistemit të pikëzimit, synimi i tyre duhet të jetë i qartë dhe duhet shpjeguar çfarë konsiderohet e përshtatshme për çdo IKV në mënyrë përmbushjen e qëllimeve të këtij vlerësimi. Ky shpjegim jepet për secilën shtyllë dhe kur është e nevojshme për secilën IKV si më poshtë:

3.1. Shtylla 1 – Sturktura Organizative / Organizimi

Struktura organizative dhe organizimi janë thelbësore për dhënien e ndihmës juridike. Përshtatshmëria e strukturës organizative është një kusht paraprak për të realizuar vetë qëllimet e ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti të tilla si: **ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë efçente dhe efektive**. Për garantimin e eficensës dhe efektivitetit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore është e nevojshme patja në dispozicion e një strukture organizative e cila përmbush kushtet minimale që i mundësojnë të veprjë në mënyrë efçente dhe efektive gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, të përcaktuara në IKV-të e mëposhtëme.

A. Përshtatshmëria e ambienteve pritës

Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore ka së pari nevojë për ambiente të përshtatshme ku të kryhen të gjitha veprimtaritë e dhënies së ndihmës juridike me të njëjtat standarte që do të zbatoheshin pranë çdo zyre private që ofron shërbime ligjore për klientët e saj. Edhe pse në vlerësimin e përshtatshmërisë së ambienteve duhen marrë parasysh fondet e kufizuara që ekzistojnë zakonisht për ndihmën juridike parësore, ose kapacitetet e ngushta financiare të avokatëve shqiptarë, ambientet ku zhvillohet kjo veprimtari duhet të respektojnë standartet minimale të punës si dhe nevojat specifike të llojit të veprimtarisë.

Zyra Pritëse

Qendra e ndihmës juridike **parësore** duhet të jetë e pajisur me një zyrë pritëse që të kryejë funksione të komunikimit të parë me klientët dhe regjistrimit të tyre. Stafi i zyrës pritëse duhet të përbëhet nga juristë të cilët kryejnë funksione e pritjes së parë të klientit: ndihmojnë klientin në plotësimin e formularëve të vetëdeklarimit; japin konsulta juridike ose hartojnë kërkesa të thjeshta kur çështja nuk ka nevojë për shqyrtim të thelluar nga avokatët; regjistrojnë çështjet e klientëve dhe përcjellin tek avokatët çështjet që kanë nevojë për shqyrtim më të thelluar.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	5 ose më shumë jurist që kryejnë funksionet e pritjes së parë
2 Pikë = Shumë Mirë	3-4 juristë që kryejnë funksionet e pritjes së parë
3 Pikë = Mirë	1-2 juristë që kryejnë funksionet e pritjes së parë
4 Pikë = Keq	1 jurist për funksionet e pritjes së parë
5 Pikë = Shumë Keq	Nuk ka ndarje funksionale mes pritjes së parë dhe shqyrtimit të thelluar

Zyra të Brendshme

Qëndrat e ndihmës **juridike parësore** dhe **avokatët e ndihmës juridike dytësore** duhet të kenë në dispozicion zyra të brendshme ku avokatët të presin klientët e tyre dhe të bisedojnë në kushtet e ruajtjes së konfidencialitetit në lidhje me çështjet e tyre. Kjo vlen veçanërisht për rastet delikate të tilla si çështjet e të drejtës familjare (dhuna në familje, divorci; kujdestaria, birësimi etj).

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Zyrat e brendshme janë individuale për çdo avokat të izoluar nga mjedisi përreth
2 Pikë = Shumë Mirë	Zyrë e brendshme takimesh e izoluar nga mjedisi përreth për trajtimin e rasteve sensitive (dhunë në familje; fëmijë të abuzuar etj).
3 Pikë = Mirë	Zyrat e brendshme janë të izoluar nga mjedisi përreth por Avokati kryen takime në prani të avokatëve të tjerë.
4 Pikë = Keq	Zyrat e brendshme nuk janë të izoluar nga zyrat pritëse dhe mjedisi përreth.
5 Pikë = Shumë Keq	Ndihma juridike parësore nuk ka zyra të brendshme / Avokati i ndihmës juridike dytësore nuk ka zyrë

Arkivi

Zyra e ndihmës juridike **parësore** dhe **avokatët e ndihmës juridike dytësore** duhet të kenë në dispozicion një Arkiv fizik dhe/ose elektronik për ruajtjen e dosjeve dhe dokumentave në format shkresor të klientëve. Çdo jurist apo avokat duhet të kujdeset për arkivimin e dokumentacionit sipas rregullave dhe standarteve të profesionit ligjor duke u kujdesur veçanërisht për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Arkiv fizik dhe elektronik i dosjes së çdo klienti me të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar sipas një sistemi uniform arkivimi
2 Pikë = Shumë Mirë	Arkiv fizik ose elektronik i dosjes së cdo klienti me të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar sipas një sistemi uniform arkivimi
3 Pikë = Mirë	Arkiv fizik ose elektronik i dosjeve të klientëve me të gjithë dokumentacionin e shqyrtuar pa një sistem uniform arkivimi
4 Pikë = Keq	Arkiv fizik ose elektronik i dosjeve të klientëve me dokumentacion të paplotë dhe pa sistem uniform arkivimi
5 Pikë = Shumë Keq	Nuk ka sistem arkivi

Mjetet e Punës

Qendra e ndihmës juridike **parësore** dhe **avokatët e ndihmës juridike dytësore** duhet të kenë ambiente të pajisur me mjetet minimale të punës të tilla si mjete elektronike, kancelari, librarinë ligjore fizike të përbërë nga kodet e përditësuara, përmbledhje të legjislacionit, manuale ligjore, përmbledhje të praktikës gjyqësore etc.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Zyra është e pajisur me të gjitha mjetet e punës fizike, elektronike dhe librari ligjore fizike
2 Pikë = Shumë Mirë	Zyra është e pajisur me të gjitha mjetet e punës fizike, elektronike dhe librari ligjore elektronike
3 Pikë = Mirë	Zyra është pjesërisht e pajisur me mjetet minimale të punës
4 Pikë = Keq	Zyra nuk është e pajisur me mjete elektronike funksionale
5 Pikë = Shumë Keq	Zyrës i mungon pjesa kryesore e mjeteve minimale të punës

Aksesueshmëria e ambienteve

Ambientet e Qendrës së **ndihmës juridike parësore** dhe të **avokatëve të ndihmës juridike dytësore** duhet të jenë të aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuara ose nga të moshuarit dhe duhet të kenë kushtet minimale për pritjen dhe akomodimin e tyre.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Zyra është e projektuar që të mund të aksesohet lehtësisht nga persona me aftësi të kufizuara ose nga të moshuarit dhe ka ambiente të posacme akomodimi (mundësi për personat në karrige me rrota; persona me vështirësi në ecje etj)/
2 Pikë = Shumë Mirë	Zyra është e pajisur me të gjitha mjetet e Zyra është lehtësisht e aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuara ose nga të moshuarit elektronike
3 Pikë = Mirë	Nuk ka asnjë vështirësi domethënëse për personat me aftësi të kufizuara ose të moshuarit në aksesin e zyrës (shkallë të larta; pengesa etj).
4 Pikë = Keq	Zyra është vështirësisht e aksesueshme nga persona me aftësi të kufizuara ose të moshuarit (shkallë të larta; pengesa etj).
5 Pikë = Shumë Keq	Zyra është plotësisht e pa-aksesueshme nga disa kategori personash me aftësi të kufizuara.

B. Përshtatshmëria e Procesit të Punës

Procesi i punës në zyrat ligjore është një element shumë i rëndësishëm për dhënien e shërbimeve ligjore në mënyrën e duhur. Në konceptin e procesit të punës përfshihet takimi i parë me klientin, takimet e

ndërmjetme dhe trajtimi i klientit deri në takimin e fundit me të. Pra procesi i punës përfshin të gjitha veprimtaritë e kryera nga stafi (juristët apo avokatët) e ndihmës juridike parësore apo avokatët e ndihmës juridike dytësore. Në mënyrë që procesi i punës të jetë në standarte të kënaqshme duhet të përmbushen kushtet e IKV-ve të mëposhtme.

Përcaktimi dhe ndarja e qartë e funksioneve

Ushtrimi i çdo veprimtarie ka nevojë për rregulla të qarta dhe ndarje funksionesh. Ky parim është akoma më i vlefshme për **Qendrën e ndihmës juridike parësore** ku duhet të përcaktohet qartë ndarja e funksioneve mes juristëve dhe avokatëve.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Avokatët dhe juristët kanë kompetenca të qarta dhe tërësisht të ndara. Avokati nuk mund të ushtrojë funksionet e juristit dhe juristi nuk mund të ushtrojë funksionet e avokatit.
2 Pikë = Shumë Mirë	Zyra është e pajisur me të gjitha mjetet e Zyra është lehtësisht e aksesueshme nga Avokatët dhe juristët kanë kompetenca të qarta dhe tërësisht të ndara . Rastet kur Avokati ose juristit mund të ushtrojnë funksionet e njëri-tjetrit janë qartësisht të përcaktuara. moshuarit elektronike
3 Pikë = Mirë	Ka njëfarë ndarje të kompetencave të avokatëve dhe juristëve megjithatë shumë funksione mund të ushtrohen nga të dyja kategoritë.
4 Pikë = Keq	Ndarja e kompetencave mes avokatëve dhe juristëve nuk është e qartë dhe është shume e përgjithshme
5 Pikë = Shumë Keq	Nuk ka ndarje kompetencash

Procesi i pritjes dhe trajtimit të Klientëve pranë Qendrës së ndihmës juridike parësore

Procedura e pritjes dhe trajtimit të rastit të klientit është thelbësore dhe duhet të jetë e mirëpërcaktuar. Duhet mbajtur parasysh se klientët e Qendrës së ndihmës juridike falas shpeshherë janë në situatë të vështirë psikologjike për shkak të vështirësive ekonomike dhe kohëzgjatjes së problemit ligjor për të cilin kërkojnë ndihmë juridike. Për këtë arsye, gjatë trajtimit të rastit në Qendrën e ndihmës juridike parësore duhet shmangur që klienti të përcillet nga njëri avokat në tjetrin përveç rasteve të urgjencës kur kjo është e domosdoshme. Gjithashtu juristi pritës, pas kryerjes së trajtimit fillestar nëpërmjet regjistrimit, plotësimit të formularëve dhe pyetjeve në lidhje me çështjen, duhet ta adresojë klientin tek një nga avokatët e ndihmës juridike në rast se konsulenca ligjore është jashtë kompetencave të jurisitit. Do të trajtohen me përparësi rastet që kanë të bëjnë me skadencë afatesh, ndërsa rastet e tjera do t'i nënshtrohen listës së pritjes në varësi të çështjeve pararendëse.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Protokoll i qartë i pritjes dhe trajtimit të klientit i cili rregulon të gjitha fazat e pritjes dhe trajtimit të klientit, i miratuar dhe i njohur nga avokatët dhe juristët.
2 Pikë = Shumë Mirë	Protokoll i i pritjes dhe trajtimit të klientit i cili rregullon fazat kryesore të pritjes dhe trajtimit të klientit, i miratuar dhe i njohur nga avokatët dhe juristët. elektronike
3 Pikë = Mirë	Protokolli ekzistues i pritjes dhe trajtimit të klientit është i miratuar por nuk është shumë i qartë.
4 Pikë = Keq	Ekziston një proces i pritjes dhe trajtimit të klientit krijuar në bazë të eksperiencës që nuk është formalizuar me anë të një protokollit të mirfilltë.
5 Pikë = Shumë Keq	Procesi i pritjes dhe trajtimit të klientëve është në varësi të punës individuale të juristëve dhe avokatëve.

Rregullorja e Procesit të Punës të Qendrës së ndihmës juridike parësore

Për të mundësuar që procesi i punës të rrjedhë rregullisht dhe të zbatohen kushtet minimale të përcaktuara më sipër, Qendra e Ndihmës Juridike parësore duhet të veprojë bazuar në Rregulloren e procesit të punës, ku të përcaktohen detyrat e stafit, rregullat kryesore të procesit të punës, si dhe mbikqyrësi i procesit të punës. Kjo rregullore duhet të jetë e njohur nga i gjithë stafi i ndihmës juridike parësore të cilët mund t'i nënshtrohen edhe trajnimeve specifike në lidhje me të, nëse kjo rezulton e nevojshme.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Rregullore e procesit të punës me përcaktime të qarta të të gjitha kompetencave dhe proceseve mbikqyrëse e miratuar dhe e njohur nga avokatët dhe juristët.
2 Pikë = Shumë Mirë	Rregullore e procesit të punës me përcaktime të qarta të kompetencave dhe proceseve mbikqyrëse kryesore e miratuar dhe e njohur nga avokatët dhe juristët.
3 Pikë = Mirë	Protokolli ekzistues i pritjes dhe trajtimit të klientit është i miratuar por nuk është shumë i qartë.
4 Pikë = Keq	Rregullore e procesit të punës me përcaktime të paqarta të kompetencave dhe proceseve mbikqyrëse kryesore.
5 Pikë = Shumë Keq	Nuk ekziston rregullorja e procesit të punës

Procesi i shqyrtimi dhe trajtimit të rastit nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore

Procesi i shqyrtimit dhe trajtimit të rastit nga Avokati i ndihmës juridike dytësore duhet të jetë në përputhje me qëllimin final të ndihmës së ofruar atë të përfaqësimit të klientit në gjykatë. Si rrjedhojë organizimi i procesit të punës për shqyrtimin dhe trajtimin e rastit duhet të përmbushë disa standarte minimale. Së pari Avokati i ndihmës juridike dytësore duhet të identifikojë që në fillim të trajtimit të çështjes **afatet** për paraqitjen e çështjes në gjykatë, **afatet e parashkrimit** dhe **afatet e tjera procedurale** dhe të informojë Klientin për to. Së dyti Avokati i ndihmës juridike dytësore do të **trajtojë me përparësi** rastet afatet e të cilave janë më të ngushta. Së treti avokati i ndihmës juridike parësore gjatë intervistave të para me klientin dhe shqyrtimit të dokumentacionit duhet të kujdeset për mbledhjen e fakteve në mënyrë sa më të qartë dhe të plotë si dhe për mbledhjen e provave që mbështesin pretendimet e Klientit. Bazuar në shqyrtimin e fakteve, dokumentave, provave, Avokati i ndihmës juridike dytësore do t'i shpjegojë Klientit strategjitë e mundshme të mbrojtjes dhe sugjerimet e tij për strategjinë më të dobishme si dhe ta mbajë të informuar gjatë gjithë përfaqësimit gjyqësor për ecurinë e seancave.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Avokati respekton afatet procedurale, mbledh provat, propozon disa strategji, këshillon strategjinë e duhur dhe mban të informuar klientin.
2 Pikë = Shumë Mirë	Avokati respekton afatet procedurale, mbledh provat, zgjedh strategjinë e duhur dhe mban të informuar klientin.
3 Pikë = Mirë	Avokati respekton afatet, mbledh provat dhe nis përfaqësimin gjyqësor.
4 Pikë = Keq	Avokati nuk identifikon qartë provat dhe strategjinë e mbrojtjes.
5 Pikë = Shumë Keq	Avokati humbet afatet procedurale

3.2. Shtylla II – Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore janë thelbësore për dhënien e ndihmës juridike parësore dhe dytësore në mënyrë të kënaqshme dhe në përputhje me standartet e ushtrimit të profesionit ligjor. Gjithashtu burimet e përshtatshme njerëzore janë thelbësore për të realizuar vetë qëllimet e ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti të tilla si: **garantimi i aksesit të barabartë** në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë **profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive**.

Barazia në akses në sistemin e drejtësisë duhet parë nga ana thelbësore dhe jo nga ana formale. Formalisht dhënia e ndihmës juridike falas garanton akses në sistemin e drejtësisë. Por në rast se ndihma juridike falas nuk është në cilësinë e duhur, humbet barazia mes personave me aftësi ekonomike të cilët mund të pajtojnë avokatë cilësor dhe personave pa aftësi ekonomike të cilët nuk e kanë këtë mundësi. Ndaj është shumë e rëndësishme që për të garantuar barazi në akses në sistemin e drejtësisë edhe për shtresat ekonomikisht më të dobta, ndihma juridike e ofruar nga shteti duhet të jetë cilësore dhe të përmbushë të paktën kushtet e përcaktuara në IKV-të e mëposhtme.

A. Përshtatshmëria e Kapaciteteve Profesionale

Avokatët dhe juristët të cilët përfshihen në dhënin e ndihmës juridike falas duhet të kenë eksperiencë të përshtatshme profesionale. Përshtatshmëria profesionale duhet të jetë në përputhje me kompetencat e ushtrura ndaj si normë parametrat e rekrutimit duhet të jenë më të larta për avokatët të cilët kanë kompetencë të trajtojnë në mënyrë më të thelluar çështjet e klientëve apo të kryejnë përfaqësimin gjyqësor të tyre. Megjithatë tendenca e rekrutimit për të dyja kategoritë e profesionistëve të ndihmës juridike falas duhet të jetë ajo e përzgjedhjes së kandidatëve më të kualifikuar, sipas kriterëve minimale në IKV-të e mëposhtme në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Arsimi

Avokatët dhe juristët të cilët kanë vazhduar të arsimohen përtej arsimit të detyrueshëm konsiderohen si vlerë e shtuar në sistemin e ndihmës juridike falas.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Avokatët dhe juristët me Master Shkencor dhe PhD
2 Pikë = Shumë Mirë	Avokatët dhe juristët me Master Profesional
3 Pikë = Mirë	Avokatët dhe juristët me arsim të detyrueshëm
4 Pikë = Keq	Stafi në proces të mbylljes së arsimit të detyrueshëm
5 Pikë = Shumë Keq	Stafi pa arsimin e detyrueshëm

Kualifikimi profesional

Kualifikimi profesional është thelbësor për garantimin e cilësisë së ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Kualifikimi profesional i kërkuar për juristët dhe avokatët duhet të jetë i ndryshëm dhe të reflektojë përgjegjësitë dhe kompetencat e secilës kategori. Megjithatë në procesin e rekrutimit duhet të kenë përparësi avokatët dhe juristët me njohuri në të drejtën civile, të drejtën administrative, të drejtën penale, të drejtën familjare, të drejtat e njeriut, proceset gjyqësore, dhe njohuri në fushat specifike më të hasura në sistemin e ndihmës juridike falas. Eksperienca e gjatë profesionale dhe shumëllojshmëria e fushave të mbuluara nga avokatët apo juristët përbën një vlerë të shtuar.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Eksperiençë profesionale 10 vjet e sipër
2 Pikë = Shumë Mirë	Eksperiençë profesionale 6 - 9 vjet
3 Pikë = Mirë	Eksperiençë profesionale 3 - 5 vjet
4 Pikë = Keq	Eksperiençë profesionale 1 - 2 vjet
5 Pikë = Shumë Keq	Pa eksperiençë profesionale Eksperiençë profesionale e rreme

Trajnimi

Trajnimi i profesionistëve të ndihmës juridike falas është një element thelbësor si për ndihmën juridike parësore ashtu edhe për ndihmën juridike dytësore. Avokatët dhe juristët e ndihmës juridike parësore duhet të marrin trajnimet e posaçme për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Gjithashtu Avokatët e ndihmës juridike dytësore duhet të kenë trajnimet e posaçme për fushat e veprimtarisë të mbuluara prej tyre si p.sh proceset me të mitur viktime ose dëshmitarë, raste të dhunës në familje etj. Në procesin e vlerësimit, avokatët dhe juristët me trajnim të posaçëm në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, të marrë brenda apo jashtë vendit, duhet të konsiderohen vlerë e shtuar. Trajnimet në lidhje me fusha sensitive të tilla si dhuna në familje, mbrojtja e fëmijëve, trajtimi i personave me aftësi të kufizuara etj. kanë peshë në procesin e vlerësimit.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Trajnim në sistemin e ndihmës juridike falas parësore / dytësore dhe trajnime në fusha të caktuara
2 Pikë = Shumë Mirë	Trajnime në sistemin e ndihmës juridike falas parësore / dytësore
3 Pikë = Mirë	Trajnime në më shumë se 1 fushë të caktuar
4 Pikë = Keq	Asnjë trajnim
5 Pikë = Shumë Keq	Informacione të pavërteta për trajnimet

Respektimi i Kodit të Etikës Profesionale

Profesioni i avoktatit ushtrohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 55/2018 datë 23.7.2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Në përputhje me nenin 27 të Ligjit Nr. 55/2018, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton Kodin e Etikës së Avokatit. Ky kod

përmban të gjitha normat dhe rregullat profesionale që duhet të përmbushin avokatët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Përmbushja e këtyre normave dhe rregullave duhet të respektohen nga avokatët dhe juristët e ndihmës juridike parësore dhe avokatët e ndihmës juridike dytësore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Këto norma janë përkthyer në IKV-të e mëposhtëme.

Pavarësia

Avokati është i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij. Për të siguruar pavarësinë avokati duhet të jetë i lirë nga çdo ndikim që mund të lindë nga interesat e tij personale ose nga presioni i jashtëm. Avokati në ushtrimin e profesionit vepron në përputhje me ligjin, Statutin, Kodin e Etikës dhe interesat e ligjshme të klientit duke i ofruar atij shërbimet profesionale të mbështetura në gjykimin e tij më të mirë. Avokati duhet të shmangë çdo cënim të pavarësisë së tij dhe të mos kompromentojë standartet profesionale për të kënaqur klientin, gjykatën apo të tretët. (Ky parim është i vlefshëm edhe për juristin e ndihmës juridike parësore).

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Avokati/juristi është i pavarur në ushtrimin e profesionit të tij nga çdo strukturë private apo shtetërore
2 Pikë = Shumë Mirë	Avokati/juristi në varësi hierarkike nga struktura private apo shtetërore nuk merr udhëzime/urdhra për trajtimin e çështjeve nga eprorët e tij.
3 Pikë = Mirë	Udhëzime/urdhrrat për trajtimin e çështjeve nga eprorët e avokatit/juristit jepen vetëm me shkrim dhe zbatohen në rast se nuk janë në kundërshtim me interesin e klientit.
4 Pikë = Keq	Avokati / juristi zbaton urdhra / udhëzime të pashkruara të eprorëve për trajtimin e çështjes pa analizuar nëse janë në interes të klientit.
5 Pikë = Shumë Keq	Avokati / juristi zbaton urdhra / udhëzime të eprorëve për trajtimin e çështjes të cilat çenojnë interesin e klientit.

Ruajtja e konfidencialitetit

Avokati dhe juristi duhet të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të dhënë nga klienti gjatë kryerjes së shërbimeve për klientin bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit (ref. ligji 111/2017).

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Asnjë pretendim dhe/ose masë për shkeljen e konfidencialitetit
2 Pikë = Shumë Mirë	Pretendimet e shkeljes së konfidencialitetit janë vërtetuar të pabazuara dhe nuk është marrë asnjë masë
3 Pikë = Mirë	1 masë e lehtë për shkeljen e konfidencialitetit nga pakujdesia brenda një periudhe 3 vjeçare.
4 Pikë = Keq	2 masa të lehta për shkeljen e konfidencialitetit brenda një periudhe 3 vjeçare.
5 Pikë = Shumë Keq	Masa të rënda për shkeljen e konfidencialitetit

Shmangia e konfliktit të interesit

Avokati nuk mund të japë ndihmë juridike, të këshillojë, të përfaqësojë apo mbrojë në emër të dy ose më shumë klientëve në të njëjtën çështje, në rast se ka konflikt interesash të atyre klientëve midis tyre. Avokati nuk përfaqëson dhe heq dorë nga përfaqësimi apo mbrojtja e dy ose më shumë personave, kur lind një konflikt interesash midis klientëve, kur avokati bindet se përfaqësimi do të çënojë marrëdhëniet me klientin tjetër. Në këtë rast Qendra e ndihmës juridike parësore kujdeset që trajtimi i njërit prej klientëve t'i kalohet një avokati tjetër të Qendrës së ndihmës juridike parësore. Ndërsa avokati i ndihmës juridike dytësore i gjendur para një rasti konflikti interesash zbaton procedurat për heqjen dorë nga çështja.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Asnjë pretendim ose masë për konflikt interesi
2 Pikë = Shumë Mirë	Pretendimi i konfliktit të interesit vërtetohet i pabazuar
3 Pikë = Mirë	1 masë e lehtë për konflikt interesi nga pakujdesia brenda një periudhë 3 vjeçare.
4 Pikë = Keq	2 masa të lehta për konflikt interesi brenda një periudhe 3 vjeçare.
5 Pikë = Shumë Keq	Masa të rënda për konflikt interesi

Trajtimi me dinjitet i klientetit

Avokatët dhe juristët e sistemi të ndihmës juridike falas duhet të lidhin një marrëdhënie besimi me klientin. Besimi arrihet kur avokati dhe juristi e trajtojnë klientin me ndershmëri, integritet dhe dinjitet. Avokatët dhe juristët e ndihmës juridike falas duhet t'i shjegojnë klientit në një gjuhë të kuptueshme ligjin dhe linjën e veprimit që do të ndiqet për mbrojtjen e çështjes së tij, duke evidentuar pasojat e mundshme ligjore në favor ose në disfavor të tij. Avokati ose juristi duhet t'i përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të arsyeshme të klientit për informacion duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për klientin.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Asnjë pretendim nga klientët për trajtim jo dinjitoz dhe mungesë besimi
2 Pikë = Shumë Mirë	Pretendimet e trajtimit jo dinjitoz vërtetohen të pabazuara nga mbikqyresi
3 Pikë = Mirë	Trajtimi jo dinjitoz dhe mungesa e besimit vjen ka ardhur si pasojë e paaftësisë për të menaxhuar klientë me sjellje agresive / të vështira
4 Pikë = Keq	Më shumë se 5 pretendime për trajtim jo dinjitoz gjatë një periudhe 1 vjecare.
5 Pikë = Shumë Keq	Vërtetim i rasteve të trajtimit jo dinjitoz

Kthimi i dokumentave

Me kërkesën e klientit avokati dhe juristi i ndihmës juridike falas duhet t'i kthejë klientit çdo dokument origjinal të marrë dorëzuar nga Klienti. Marrja dhe kthimi i dokumentave origjinale do të bëhet me një procesverbal të nënshkruar nga Avokati dhe/ose juristi dhe Klienti në fjalë.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Mbajtja rregullisht e procesverbalit për kthimin e dokumentacionit
2 Pikë = Shumë Mirë	Mbajtja e procesverbalit të kthimit të dokumentacionit për të paktën 90% të rasteve të trajtuara
3 Pikë = Mirë	Mbajtja e procesverbalit të kthimit të dokumentacionit për të paktën 75% të rasteve të trajtuara
4 Pikë = Keq	Mbajtja e procesverbalit të kthimit të dokumentacionit për më pak se 75% e rasteve të trajtuara
5 Pikë = Shumë Keq	Mos-mbajtja e procesverbalit të kthimit të dokumentacionit

Përshtatshmëria e Cilësisë së Shërbimit

Siç u tha edhe më sipër ofrimi i ndihmës juridike cilësore është kusht i domosdoshëm për të përmbushur qëllimin kryesor të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi. Për këtë arsye të gjitha parametrat e vendosura nga IKV-të e sipërpërmendura shërbejnë për të garantuar që shërbimet ligjore të ofruara nga juristët dhe avokatët e sistemit të ndihmës juridike falas të jenë cilësore. Nga ana tjetër matja e cilësisë së shërbimeve juridike është në përgjithësi një sfidë më vete sepse ndikohet nga një sërë elementesh të cilat shpeshherë janë jashtë kontrollit të ofruesit të shërbimit. Për këtë arsye IKV-të e cilësisë së shërbimit janë kryesisht të përqëndruara në ato elemente të ofrimit të shërbimit të cilat mund të jenë objektivisht të identifikueshme.

Analizë e thelluar

Profesionistët e ndihmës juridike falas parësore dhe dytësore duhet të kryejë analizën e thelluar të çështjeve ligjore për të cilat klientët kërkojnë ndihmë juridike. Analiza e thelluar konsiston në kuptimin e qartë të problemit ligjor, verifikimin e dokumentacionit të sjellë nga klientët, udhëzimin për sjelljen e dokumentacionit shtesë në rast se ka mangësi në kuptimin e plotë të çështjes. Analiza e thelluar vlen veçanërisht për avokatët e ndihmës juridike parësore dhe avokatët e ndihmës juridike dytësore të cilët kanë kompetencë të trajtojnë çështjen me anë të hartimit të dokumentave ligjore në mbrotje të interesave të klientit dhe përfaqësimit gjyqësor. Ky parim vlen edhe për juristët e Qëndrës së ndihmës juridike parësore të cilët duhet të kuptojnë thelbin e çështjes përpara dhënies së konsulencës, apo hartimit të kërkesave dhe ankesave.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Argumtim i thelluar ligjor bazuar në legjislacionin e fushës, parimet themelore civile, administrative, penale, parimet kushtetuese, të drejtat e njeriut sipas KEDNJ për të gjitha rastet e trajtuara
2 Pikë = Shumë Mirë	Argumentim i thelluar ligjor bazuar në legjislacionin e fushës dhe parimet themelore civile, administrative, penale për mbi 75% të rasteve të trajtuara
3 Pikë = Mirë	Argumentim i thelluar ligjor bazuar në legjislacionin e fushës dhe parimet themelore civile, administrative, penale për 60% të rasteve të trajtuara
4 Pikë = Keq	Shkresa të thjeshta ankesa / kërkesa me përmendje legjislacioni për mbi 61% të rasteve të trajtuara
5 Pikë = Shumë Keq	Shkresa të thjeshta kërkesa / ankesa pa legjislacion dhe argumentim ligjor për të gjitha rastet e trajtuara

Cilësia e dokumentave të hartuara

Profesionistët e ndihmës juridike falas, Avokatët dhe juristët, gjatë punës së tyre hartojnë kërkesa, ankesa, ankime administrative, kërkesë padi, rekurse dhe dokumenta të ngjashme ligjore sipas nevojës së mbrojtjes së interesave të klientit. Cilësia e dokumentave të hartuara do të vlerësohet nga qartësia e shpjegimit të çështjes, cilësia e argumenteve ligjore, legjislacioni mbështetës i shqyrtuar, referenca ndaj parimeve ligjore kryesore të tilla si parimet e të drejtës civile, administrative, kushtetuese, penale etj., referenca ndaj legjislacioni të fushës përkatëse.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Dokumentat e hartuara me argumentime të thelluara për të gjitha rastet e trajtuara
2 Pikë = Shumë Mirë	Dokumentat e hartuara me argumentime të thelluara për mbi 75% të rasteve të trajtuara
3 Pikë = Mirë	Dokumentat e hartuara me argumentime të thelluara për 60% të rasteve të trajtuara
4 Pikë = Keq	Dokumentat e hartuara pa argumentime të thelluara për mbi 61% të rasteve të trajtuara
5 Pikë = Shumë Keq	Dokumentat e hartuara pa argumentime të thelluara

Koha e shqyrtimit në Qendrën e ndihmës juridike parësore

Në kuadër të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit, avokatët dhe juristët e zyrës së ndihmës ligjore parësore duhet të shqyrtojnë çështjen brenda kohës më të shkurtër të mundshme. Koha e shqyrtimit nuk është e paracaktuar dhe ajo është ngushtësisht e lidhur me kompleksitetin e çështjes në shqyrtim, sasinë e dokumentacionit të shqyrtuar si dhe ngarkesën e punës të stafit me çështje pararendëse. Të gjitha këto elemente do të merren në konsideratë në vlerësimin e kohës së shqyrtimit. Do të trajtohen me përparësi çështjet të cilat kanë afate skandence.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	1 javë
2 Pikë = Shumë Mirë	2 javë
3 Pikë = Mirë	3 javë
4 Pikë = Keq	3.5 javë
5 Pikë = Shumë Keq	4 javë

Numri i rasteve të shqyrtuara nga ndihma juridike parësore

Në kuadër të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit, avokatët dhe juristët e zyrës së ndihmës ligjore parësore duhet të shqyrtojnë në mënyrë të thelluar sa më shumë çështje. Numri i çështjeve të shqyrtuara nuk mund të paracaktohet dhe është ngushtësisht e lidhur me numrin e klientëve, numrin e çështjeve në proces, kohën në dispozicion të stafit për të trajtuar çështjet dhe rrethana të tjera objektive. Të gjitha këto elemente do të merren në konsideratë në vlerësimin e numrit të rasteve të shqyrtuara dhe do të përbëjnë një IKV të rëndësishme për planifikimet e ardhshme të burimeve njerëzore dhe financiare dedikuar ndihmës juridike parësore.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	10 shqyrtime të thelluara në muaj dhe konsulenca të thjeshta
2 Pikë = Shumë Mirë	5-10 shqyrtime të thelluara në muaj dhe konsulenca të thjeshta të thelluara për mbi 75% të rasteve të trajtuara
3 Pikë = Mirë	1-5 shqyrtime të thelluara në muaj dhe konsulenca të thjeshta
4 Pikë = Keq	0 shqyrtime të thelluara në muaj dhe kryesisht konsulenca të thjeshta
5 Pikë = Shumë Keq	0 shqyrtime dhe konsulenca në muaj

Pjesmarrja në seancat gjyqësore

Ndihma juridike dytësore kërkon përfaqësimin aktiv të interesave të klientit gjatë seancave gjyqësore. Për këtë arsye një indikator objektiv vlerësimi për të verifikuar mbrojtjen aktive të interesave të Klientit është edhe pjesmarrja e avokatit në seancat gjyqësore. Avokati duhet të marrë pjesë rregullisht në seancat gjyqësore, të jetë aktiv gjatë seancave gjyqësore në mbrojtjen e interesave të klientit duke përdorur mjetet procedurale përkatëse, duke paraqitur prova, duke thirrur dëshmitar etj. Shtyrjet e seancave gjyqësore nga avokati duhet të jenë të rralla dhe për shkak të rrethanave urgjente dhe të pashmangëshme.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Pjesmarrje në të gjitha seancat gjyqësore
2 Pikë = Shumë Mirë	Maksimumi 2 shtyrje për të njëjtën çështje, për rrethana urgjente
3 Pikë = Mirë	Maksimumi 3 shtyrje për të njëjtën çështje për rrethana urgjente
4 Pikë = Keq	Më shumë se 3 shtyrje për të njëjtën çështje
5 Pikë = Shumë Keq	Shtyrje të pajustificuara

Respektimi i afateve procedurale

Avokati i ndihmës juridike dytësore duhet të kujdeset që të identifikojë në mënyrë të saktë të gjitha afatet procedurale të përfaqësimit gjyqësor dhe ti respektojë ato. Humbja e afateve procedurale për shkak të neglizhencës së avokatit të ndihmës juridike dytësore duhet të konsiderohet një shkelje e rëndë.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Respektimi i të gjitha afateve procedurale
2 Pikë = Shumë Mirë	Humbja e afateve procedurale të ndërmjetme për shkaqe jashtë kontrollit të avokatit për 5 % të çështjeve të përfaqësuara
3 Pikë = Mirë	Humbja e afateve procedurale të ndërmjetme për shkaqe jashtë kontrollit të avokatit për 15 % të çështjeve të përfaqësuara
4 Pikë = Keq	Humbja e afateve procedurale të ndërmjetme për pakujdesi të avokatit
5 Pikë = Shumë Keq	Humbja e afateve procedurale të padisë

Rezultati Gjyqësor

Pritshmëria e klientëve të ndihmës juridike dytësore është njohja e pretendimeve të tyre në rrugë gjyqësore. Megjithatë në vlerësimin e rezultatit gjyqësor duhet të mbahen në konsideratë edhe rrethana jashtë kontrollit të avokatit të tilla si provueshmëria e pretendimeve; qëndrimi i trupës gjyqësore; argumentimi i palës tjetër etj.

Vlerësimi sipas pikëzimit:

1 Pikë = Shkëlqyeshëm	Rezultat pozitiv 100% të çështjeve të përfaqësuara
2 Pikë = Shumë Mirë	Rezultat pozitiv ose pjesërisht pozitiv në mbi 75% të çështjeve të përfaqësuara
3 Pikë = Mirë	Rezultat pozitiv ose pjesërisht pozitiv në 30-75% të çështjeve të përfaqësuara
4 Pikë = Keq	Rezultat pozitiv ose pjesërisht pozitiv në 0-30% të çështjeve të përfaqësuara
5 Pikë = Shumë Keq	Rezultat negativ të të gjitha çështjeve të përfaqësuara

4. Mjetet vlerësuese të indikatorëve

Mjetet vlerësuese të IKV-ve duhet të jenë të përshtatshme me IKV-të që dëshirohen të vlerësohen. Ato mund të jenë të shumëllojshme duke nisur nga monitorimi, tek vetë-monitorimi nëpërmjet përgatitjes së raporteve dhe analizimi i tyre nga mbikqyrësit, deri tek pyetësorët drejtuar klientëve. Megjithatë vlerësuesi duhet të jetë i kujdesshëm t'i japë peshën e duhur mjeteve të vlerësimit të përdorura dhe informacioneve të mbledhura prej tyre veçanërisht për ato elemente vlerësimi të cilat përmbajnë elemente subjektiviteti.

4.1. Mjetet e Vlerësimit për IKV-të e Shtyllës 1 – Struktura Organizative

Për vlerësimin e **përshtatshmërisë së ambienteve të punës**, mund të përdoren si mjet vlerësues **monitorimet pranë Qëndrave të ndihmës juridike parësore** ose kontrollet verifikuese pranë zyrave ku ushtrojnë profesionin avokatët e ndihmës juridike dytësore për të verifikuar nëse janë përmbushur kushtet minimale të ambienteve. Monitorimet dhe kontrollet mund të kryhet në periudha periodike nga përgjegjës të caktuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Për vlerësimin e **përshtatshmërisë së procesit të punës pranë Qëndrave të ndihmës juridike parësore** mund të përdoren dy mjete vlerësuese ku ndërthuren aspekte objektive dhe subjektive. Së pari shqyrtohet nëse ekziston rregullorja e procesit të punës dhe nëse përcaktimi dhe ndarja e funksioneve të përmbajtura në të janë të qarta. Ky vlerësim mund të bëhet nga ekspertë të ngarkuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Vlerësimi i IKV-së në lidhje me procesin e pritjes dhe trajtimit të Klientëve, mund të kryhet nëpërmjet monitorimit pranë Qëndrave të ndihmës juridike parësore apo nëpërmjet pyetësorëve të klientëve të trajtuar. Në rastin e fundit vlerësuesi duhet të mbaj parasysh elementet subjektive që mund të ndikojnë tek klientët e trajtuar për të dhënë një përgjigje apo një tjetër.

Për vlerësimin e **përshtatshmërisë së procesit të punës nga avokatët e ndihmës juridike dytësore** mund të përdoren gjithashtu mjete vlerësuese ku ndërthuren aspekte objektive dhe subjektive. Së pari mund të vlerësohen raportet e përgatitura nga avokatët e ndihmës juridike dytësore në lidhje me çështjen e cdo Klienti të cilat përmbajnë përshkrimin e rastit, afatet proceduriale, provat e mbledhura. Së dyti vlerësimi i mënyrës së trajtimit të Klientit, informacionit të dhënë, shpjegimeve dhe qartësisë së tyre mund të kryhet edhe nëpërmjet pyetësorëve dhe/ose intervistave me klientët e trajtuar. Në rastin e fundit vlerësuesi duhet të mbaj parasysh elementet subjektive që mund të ndikojnë tek klientët e trajtuar për të dhënë një përgjigje apo një tjetër.

4.2. Mjetet e Vlerësimit për IKV-të e Shtyllës 2 – Burimet Njerëzore

Për vlerësimin e **përshtatshmërisë së Kapaciteteve Profesionale** do të përdoren të dhënat objektive të marra nga CV-të e avokatëve dhe juristëve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në lidhje me arsimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin.

Për vlerësimin e **Respektimit të Kodit të Etikës Profesionale** mund të përdoren dy mjete vlerësuese: nëpërmjet monitorimit pranë Qëndrave të ndihmës juridike parësore, nëpërmjet analizimit të ankesave të klientëve apo nëpërmjet pyetsorëve dhe/ose intervistave të klientëve të trajtuar. Në dy rastet e fundit vlerësuesi duhet të mbajë parasysh elementet subjektive që mund të ndikojnë tek klientët e trajtuar për ankesat e kryera prej tyre apo për të dhënë një përgjigje apo një tjetër dhe të zhvillojnë gjithashtu një bashkëbisedim me avokatin apo juristin në fjalë.

Për vlerësimin e **Përshtatshmërisë së Cilësisë së Shërbimit** mund të përdoret si mjet vlerësimi **monitorimi** i cilësisë së dokumentave shkresore të hartuara nga avokatët apo juristët, duke shqyrtuar elemente të tilla si shpjegimi i qartë i situatës së faktit, legjislacioni i shqyrtuar, njohuria në fushën specifike, argumentimi ligjor, provat e mbledhura dhe të paraqitura, strategjia gjyqësore e ndjekur etj. Vlerësuesi duhet të mbajë parasysh edhe subjektivitetin e këtij vlerësimi në lidhje me strategjinë e zgjedhur të mbrojtjes.

Për vlerësimin e **kohës së shqyrtimit** dhe numrit të rasteve monitorohen raportet mujore të përgatitura nga avokatës ose juristët e ndihmës juridike parësore dhe skedat e secilit klient të trajtuar të hartuara sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kësaj metodologjie.

Për vlerësimin e **pjesëmarrjes në seancat gjyqësore, respektimin e afateve procedurale dhe rezultatet gjyqësore** monitorohen skedat e klientit të përgatitura nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore sipas Aneksit 2 bashkëlidhur kësaj metodologjie si dhe raporti përfundimtar i përgatitur nga avokati pas mbylljes së çështjes. Raporti përfundimtar do të përmbajë të gjitha informacionet e kërkuara në Skedën e Klientit sipas Aneksit 2 si dhe informacione / komente shtesë që mund të jenë të nevojshme të pasqyrohen pas përfundimit të çështjes. Ankesat e Klientëve nëse ka të tilla, do të merren gjithashtu parasysh. Në këtë rast duhet marrë në konsideratë edhe elementi subjektiv që mund të ndikojë në ankesat e klientëve dhe çështja të shqyrtohet duke dëgjuar edhe shpjegimet e avokatit.

V. PROCEDURAT E MBIKQYRJES DHE KOORDINIMIT

Në përputhje me Nenin 8 të Ligjit Nr. 111/2017 Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është organi përgjegjës për administrimin dhe mbikqyrjen e sistemit të ndihmës juridike falas. Në këtë kuadër DNJF ushtron një sërë funksionesh të rëndësishme:

- i. mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike;
- ii. administron qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme;
- iii. zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike;
- iv. mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët;

Për vlerësimin e standarteve të ofrimit të shërbimit dhe të cilësisë, DNJF do të përdorë metodologjinë e vlerësimit sipas IKV-ve dhe mjeteve të vlerësimit të përshkruara në këtë dokument.

1. Koordinimi dhe Mbikqyrja e Ndhmës Juridike Parësore

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nëpërmjet strukturës përgjegjëse të saj ushtron funksione mbikqyrëse dhe koordinuese mbi Qëndrat e ndihmës juridike parësore.

Funksionet Koordinuese

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e Qëndrave të ndihmës juridike parësore kujdeset për mbarëvajtjen e procesit të punës. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen cakton pikat e kontaktit me qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në lidhje me çdo aspekt të veprimtarisë së tyre duke trajtuar –të gjitha çështjet e administrimit të zakonshëm.

Funksionet Mbikqyrëse

Mbikqyrja e standarteve të ofrimit të ndihmës juridike parësore do të kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen pranë DNJF. Mbikqyrja përkon me aktivitetet e mëposhtëme:

i. Monitorimi fillestar

Kjo strukturë do të monitorojë Qëndrën e ndihmës juridike parësore në momentin e ngritjes së saj për të vlerësuar nëse i përmbush standartet

minimale të përshtatshme të ambienteve sipas IKV-ve përkatëse. Personi përgjegjës i Qendrës së ndihmës juridike parësore do të mbajë një procesverbal në lidhje me gjendjen e ambienteve të cilin do ta përcjellë pranë DNJF-së.

ii. Monitorime tre mujore

Çdo tre muaj, Struktura përgjegjëse e ndihmës juridike parësore, do të kryejë monitorime një ditore për të vlerësuar zhvillimin e punës pranë Qendrës të ndihmës juridike parësore nën përgjegjësinë e tij/saj. Gjatë këtyre monitorimeve do të vlerësohet zhvillimi i procesit të punës, respektimi i kodit të etikës, rregullat e pritjes së klientëve dhe të arkivimit të dokumentave. Gjatë procesit të monitorimit mbikqyrësi mund gjithashtu të kryejë bashkëbisedime/intervista me klientët e pranishëm në Qendrën e ndihmës juridike parësore. Në fund të ditës së monitorimit, mbikqyrësi përgatit një raport në lidhje me monitorimin.

iii. Monitorimi i vazhdueshëm

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen ka akses në të gjitha dokumentat në format elektronik apo dhe në format shkresore, të hartuara nga avokatët dhe juristët e Qendrës së ndihmës juridike parësore të cilat mund t'i monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të kërkojnë sqarimet përkatëse nga avokatët dhe juristët.

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen mbledh dhe shqyrton raportet mujore dhe skadat e klientit të hartuar nga avokatët dhe juristët e ndihmës juridike parësore.

Gjithashtu ka të drejtën të trajtojë në çdo kohë ankesat e klientëve kundrejt avokatëve apo juristëve dhe të organizojë takime me këta të fundit në lidhje me çështjen në fjalë.

iv. Vlerësimi i performancës së Avokatëve dhe Juristëve

Bazuar në monitorimet e kryera, raporte mujore dhe skadat e klientit të dërguara nga Avokatët dhe Juristët e ndihmës juridike parësore, struktura përgjegjëse kryen vlerësimin e performancës së këtyre të fundit. Vlerësimi i performancës do të kryhet duke përdorur IKV-të e vlerësimit të përcaktuara për Shtyllën II - burimet njerëzore dhe mjetet e vlerësimit të përcaktuara më lart në këtë dokument.

Vlerësimi i performancës do të kryhet 1 herë në vit, në fund të vitit të punës, në mënyrë individuale për secilin jurist apo avokat të angazhuar pranë Qendrës së ndihmës juridike parësore. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen do të hartojë raportin paraprak të vlerësimit, të cilin do t'ja

dërgojë për dijëni juristit apo avokatit përkatës duke caktuar edhe një datë për takimin dhe diskutimin e raportit.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të performancës do të hartohet pas takimit dhedo të përmbajë vlerësimin dhe rekomandimet nga mbikëqyrja dhe monitorimi si dhe komentet dhe rekomandimet e juristit apo avokatit të vlerësuar. Raporti i vlerësimit të performancës do të hartohet sipas formatit të Aneksit 3 bashkëlidhur.

2. Koordinimi dhe Mbikëqyrja e Ndhmës Juridike Dytësore

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nëpërmjet strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen do të ushtrojë funksione mbikëqyrëse dhe monitoruese mbi avokatët e ndhmës juridike dytësore.

Funksionet Koordinuese

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen do të jetë pika e kontaktit për avokatët e ndhmës juridike dytësore nën mbikëqyrjen e tij dhe për klientët e ndjekur nga këta avokatë dhe do të trajtojë dhe koordinojë raportet mes tyre, nëse kjo është e nevojshme.

Funksionet Mbikëqyrëse

Mbikëqyrja e standarteve të ofrimit të shërbimit të ndhmës juridike dytësore do të kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen pranë DNJF. Mbikëqyrja përkon me aktivitetet e mëposhtme:

v. Monitorimi fillestar

Kjo strukturë nëpërmjet stafit do të kontaktojë me avokatët e mbikëqyrur prej tij për të marrë informacionet fillestare në lidhje me çështjen dhe takimet e para me klientin e caktuar, afatet procedurale dhe cdo informacion tjetër fillestar të dobishëm. Struktura përgjegjëse mund të kryhen monitorime fillestare pranë zyrave ku avokati ushtron profesionin e tij për të vlerësuar nëse i përmbush standartet minimale të përshtatshmërisë së ambienteve sipas IKV-ve përkatëse si dhedo të mbahet një procesverbal në lidhje me konstatimet e rëndësishme gjatë monitorimeve fillestare.

vi. Monitorimi i vazhdueshëm

Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen ka askes në të gjitha dokumentat në format elektronik apo dhe në format shkresor, të hartuara nga avokatët e ndhmës juridike dytësore nën mbikëqyrjen e tij të cilat mund t'i monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të kërkojë sqarimet përkatëse.

Gjithashtu ka të drejtën të trajtojë në çdo kohë ankesat e klientëve kundrejt avokatëve dhe të organizojë takime me këta të fundit në lidhje me çështjen në fjalë si dhe të marrë pjesë në ndonjë nga seancat gjyqësore.

vii. Vlerësimi i performancës së Avokatëve

Bazuar në monitorimet fillestare dhe në monitorimet e vazhdueshme si dhe në skedat e klientit dhe raportin përfundimtar të hartuar nga avokati pas përfundimit të çështjes gjyqësore, dhe kryen vlerësimin e performancës së Avokatit.

Vlerësimi i performancës do të kryhet duke përdorur IKV-të e vlerësimit të përcaktuara për Shtyllën II - burimet njerëzore dhe mjetet e vlerësimit të përcaktuara më lart në këtë dokument.

Vlerësimi i performancës do të kryhet në përfundim të çështjes gjyqësore për secilin avokat. Doo të hartohet një raport paraprak të vlerësimit, të cilin do t'ja dërgojë për dijeni avokatit përkatës duke caktuar edhe një datë për takimin dhe diskutimin e raportit.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të performancës do të hartohet dhe do të përmbajë vlerësimin dhe rekomandimet e strukturës si dhe komentet dhe rekomandimet e avokatit të vlerësuar. Raporti i vlerësimit të performancës do të hartohet sipas formatit të Aneksit 4 bashkëlidhur.

ANEKSI 1
SKEDA E KLIENTIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Emri:	Nr. ID:
Mbiemri:	Nr.Tel:
	Adresa:
Problematika	<i>Përshkrim i përmbledhur i problemit të klientit</i>
Institucioni/et i/e Përfshirë/a	<i>Cilat janë institucionet e përfshira në problemin e klientit / në rast se është problem mes privatëve të vendoset N/A</i>
Nr. i Takimeve	<i>Sa takime janë zhvilluar me klientin dhe përse janë dashur disa takime.</i>
Nr. i Dokumentave të Shqyrtuara	<i>Numri i përfaqësuar i dokumentave të shqyrtuara me vlerë për çështjen</i>
Fusha ligjore	<i>p.sh administrative/civile/penale/familjare</i>
Lloji i konsulencës	<i>Konsulencë me gojë / konsulencë me shkrim</i>
Koha e trajtimit (ditë)	<i>Numri i ditëve të punës për trajtimin e rastit</i>
Komente	<i>Informacione të tjera që konsiderohen të vlefshme</i>

ANEKSI 2

SKEDA E KLIENTIT SKEDA E KLIENTIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Emri:	Nr. ID:
Mbiemri:	Nr.Tel:
	Adresa:
Lloji i Konfliktit	<i>Përshkrim i përmbledhur i problemit të klientit</i>
Afatet Procedurale	<i>Afatet e kërkesë padisë, afatet e parashkrimit, afatet e tjera</i>
Fusha ligjore	<i>p.sh administrative/civile/penale/familjare</i>
Institucioni/et i/e Përfshirë/a	<i>Cilat janë institucionet e përfshira në problemin e klientit / në rast se është problem mes privatëve të vendoset N/A</i>
Numri i Provave	<i>Provat e mbledhura</i>
Seancat gjyqësore	<i>Këtu shënohen në mënyrë kronologjike seancat gjyqësore të zhvilluara</i>
Seanca gjyqësore të shtyra	<i>Sa seanca gjyqësore janë shtyrë dhe arsytet</i>
Informimi i Klientit	<i>Takimet dhe informimet nëpërmjet mjeteve të tjera</i>
Strategjia e Mbrojtjes	<i>Përshkrim i shkurtër i strategjisë së mbrojtjes</i>
Komente	<i>Informacione të tjera që konsiderohen të vlefshme</i>

ANEKSI 3
RAPORTI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS PËR
NDIHMËN JURIDIKE PARËSORE

Emri:	VLERËSIMI NARRATIV
Mbiemri:	<i>Vlerësimi kryhet sipas sistemit të IKV-ve</i>
Titulli: (Jurist / Avokat)	
KAPACITETET PROFESIONALE	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Arsimi	<i>Të dhëna mbi arsimin e lartë / Pikëzimi</i>
Kualifikimi profesional	<i>Të dhëna mbi kualifikimin profesional / Pikëzimi</i>
Trajnimi	<i>Të dhëna mbi trajnimin / Pikëzimi</i>
KODIT I ETIKËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Pavarësia	<i>Përshkrim i respektimit të kriterit të pavarësisë / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Ruajtja e konfidencialitetit	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Shmangia e konfliktit të interes	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të shmangies së konfliktit të interesit / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>

Trajtimi me dinjitet i klientetit	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të trajtimit me dinjitet / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Kthimi i dokumentave	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të kthimit të dokumentave/ raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
CILËSIA E SHËRBIMIT	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Analizë e thelluar	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit dhe dokumentave të hartuara / Pikëzimi</i>
Cilësia e dokumentave të hartuara	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit dhe dokumentave të hartuara / Pikëzimi</i>
Koha e shqyrtimit	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit / Pikëzimi</i>
Numri i rasteve të shqyrtuara	<i>Vlerësimi sipas Skedave të Klientëve dhe raportimeve të tjera / Pikëzimi</i>
PIKËZIMI TOTAL:	
KOMENTE DHE REKOMANDIME NGA STRUKTURA PËRGJEGJËSE NË DNJFn	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË AVOKATIT/JURISTIT	
NËNSHKRIMI	NËNSHKRIM I AVOKATIT/ JURISTIT
Data:	Data:
Firma:	Firma:

ANEKSI 4
RAPORTI I VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS PËR
NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

Emri:	VLERËSIMI NARRATIV
Mbiemri:	<i>Vlerësimi kryhet sipas sistemit të IKV-ve</i>
Titulli: (Jurist / Avokat)	
KAPACITETET PROFESIONALE	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Arsimi	<i>Të dhëna mbi arsimin e lartë / Pikëzimi</i>
Kualifikimi profesional	<i>Të dhëna mbi kualifikimin profesional / Pikëzimi</i>
Trajnimi	<i>Të dhëna mbi trajnimin / Pikëzimi</i>
KODIT I ETIKËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Pavarësia	<i>Përshkrim i respektimit të kriterit të pavarësisë / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Ruajtja e konfidencialitetit	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Shmangia e konfliktit të interes	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të shmangies së konfliktit të interesit / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
Trajtimi me dinjitet i klientit	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të trajtimit me dinjitet / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>

Kthimi i dokumentave	<i>Përshkrim i respektimit të detyrimit të kthimit të dokumentave / raste problematike nëse ka / pikëzimi</i>
CILËSIA E SHËRBIMIT	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Analizë e thelluar	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit / Pikëzimi</i>
Cilësia e dokumentave të hartuara	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit dhe dokumentave të hartuara / Pikëzimi</i>
Pjesmarrja ne Seancat gjyqësore	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit / Pikëzimi</i>
Respektimi i afateve procedurale	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit / Pikëzimi</i>
Rezultate Gjyqësore	<i>Vlerësimi sipas Skedës së Klientit dhe raporteve të tjera / Pikëzimi</i>
PIKËZIMI TOTAL:	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË MBIKQYRËSIT	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË AVOKATIT	
NËNSHKRIM I MBIKQYRËSIT	NËNSHKRIM I AVOKATIT
Data:	Data:
Firma:	Firma:

ANEKSI 5

RAPORTI I VLERËSIMIT TË STRUKTURËS ORGANIZATIVE PËR NDIHMËN JURIDIKE PARËSORE

<p>Zyra e Ndhmës Parësore:</p> <p>Emri:</p> <p>Adresa:</p> <p>Personi i Kontaktit:</p>	<p>VLERËSIMI NARRATIV</p> <p><i>Vlerësimi kryhet sipas sistemit të IKV-ve</i></p>
PËRSHTATSHMËRIA E AMBIENTEVE PRITËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Qendra Pritëse	<i>Përshkrim i Qëndrave pritëse / pikëzimi</i>
Zyra të brendshme	<i>Përshkrim i zyrave të brendshme / pikëzimi</i>
Arkiv	<i>Përshkrim i sistemit të arkivimit / pikëzimi</i>
Mjetet e punës	<i>Të dhëna mbi mjetet e punës / pikëzimi</i>
Aksesueshmëria e zyrës	<i>Përshkrim i aksesueshmërisë së zyrës /pikëzimi</i>
PËRSHTATSHMËRIA E PROCESIT TË PUNËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Përcaktimi dhe ndarja e qartë e funksioneve	<i>Përshkrim i ndarjes së funksioneve mes avokatëve dhe juristëve / pikëzimi</i>

Procesi i pritjes dhe trajtimit të Klientëve	<i>Përshkrim i protokollit / procesit të pritjes dhe trajtimit të Klientëve / pikëzimi</i>
Rregullorja e Procesit të Punës	<i>Evidentim i ekzistencës së rregullore së procesit të punës dhe qartësisë së saj / pikëzimi</i>
PIKËZIMI TOTAL:	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË MBIKQYRËSIT	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË PERSONIT TË KONTAKTIT	
NËNSHKRIM I MBIKQYRËSIT Data: Firma:	NËNSHKRIM I PERSONIT TË KONTAKTIT Data: Firma:

ANEKSI 6

RAPORTI I VLERËSIMIT TË STRUKTURËS ORGANIZATIVE PËR NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

Avokati: Emri: Mbiemri: Adresa / Kontakti:	
VLERËSIMI NARRATIV <i>Vlerësimi kryhet sipas sistemit të IKV-ve</i>	
PËRSHTATSHMËRIA E AMBIENTEVE PRITËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Zyra të brendshme	<i>Përshkrim i zyrave të brendshme / pikëzimi</i>
Arkiv	<i>Përshkrim i sistemit të arkivimit / pikëzimi</i>
Mjetet e punës	<i>Të dhëna mbi mjetet e punës / pikëzimi</i>
Aksesueshmëria e zyrës	<i>Përshkrim i aksesueshmërisë së zyrës / pikëzimi</i>
PËRSHTATSHMËRIA E PROCESIT TË PUNËS	<i>Pikëzimi i përgjithshëm sipas sistemit të IKV-ve</i>
Identifikimi i Afateve	<i>Të dhënat nga skeda e klientit për afatet / pikëzimi</i>

Trajtimi me përparësi	<i>Të dhënat nga skeda e klientit për rradhën e trajtimit të klientit / pikëzimi</i>
Mbledhja e fakteve	<i>Të dhënat nga skeda e klientit për faktet / pikëzimi</i>
Mbledhja e provave	<i>Të dhënat nga skeda e klientit për provat / pikëzimi</i>
Strategjia e Mbrojtjes	<i>Të dhënat nga skeda e klientit për strategjinë e mbrojtjes / pikëzimi</i>
PIKËZIMI TOTAL:	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË MBIKQYRËSIT	
KOMENTE DHE REKOMANDIME TË AVOKATIT	
NËNSHKRIM I MBIKQYRËSIT Data: Firma:	NËNSHKRIM I AVOKATIT Data: Firma:

Aneks 13

Vendim nr. 110, date 06.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Organizatat jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti (në vijim “organizata jofitimprurëse të autorizuara”) përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje, bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara në këtë vendim.
2. Procedurat e përfitimit të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara bëhen duke u bazuar në parimet e mëposhtme:
 - a) Konkurrueshmërisë;
 - b) Trajtimin të barabartë dhe mosdiskriminimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, aplikuese për përfitimin e financimit;
 - c) Transparencës të të gjitha fazave që lidhen me shqyrtimin, vendimmarrjen dhe përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara;
 - ç) Kritereve të mirëpërcaktuara dhe publike, të cilat do të mundësojnë vlerësimin e propozimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara në raport me objektivat dhe prioritetet e mbështetjes financiare;
 - d) Efektivitetit dhe ekonomizimit në shfrytëzimin e fondeve publike, duke siguruar që të arrihen objektivat dhe prioritetet e përcaktuara me një kosto sa më të favorshme për realizimin e shërbimit të synuar;
 - dh) Respektimit të plotë të parimeve të llogaridhënies dhe raportimit në përdorimet e fondeve publike;
 - e) Financimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë e përfituesve që janë me prioritet për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe në interes të përfituesve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;
 - ë) Ruajtjes së pavarësisë së organizatës jofitimprurëse të autorizuar;

f) Parandalimit të konfliktit të interesit, si dhe të çdo aktiviteti tjetër që rrezikon ofrimin me integritet të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

3. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas planifikon në buxhetin e saj një zë të veçantë për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara dhe harton, në bazë të shumës së miratuar, planin vjetor të financimit.

4. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban:

- a) shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;
- b) objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuar;
- c) numrin e përafërt të organizatave jofitimprurëse të autorizuara që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes;
- ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe
- d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

5. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton, në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, çdo fillim viti kalendarik, thirrje të përgjithshme ose gjatë vitit, në raste të veçanta ose të paparashikuara, për përmbushjen e nevojave të kategorive të caktuara të popullsisë për ndihmë juridike parësore, duke caktuar:

- a) shumën e fondeve financiare në dispozicion;
- b) numrin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara që mund të përfitojnë financimin e caktuar;
- c) kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- ç) listën e dokumenteve të nevojshme për t'u paraqitur;
- d) afatin e përfundimit të thirrjes;
- dh) të dhëna për mënyrën e dorëzimit të aplikimeve;
- e) udhëzime të tjera të nevojshme për plotësimin e aplikimit, të cilat përcaktohen me urdhër të drejtorit të Ndhmës Juridike Falas dhe që publikohet së bashku me thirrjen.

6. Për t'u kualifikuar për të përfituar financime, organizatat jofitimprurëse të autorizuara duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, si më poshtë vijon:

- a) Kriteret e përgjithshme:
 - i. të kenë marrë autorizimin nga ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

- ii. të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;
- iii. të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi që cenon zhvillimin e drejtë të procesit të përzgjedhjes me drejtorin e Ndhmës Juridike Falas.

b) Kriteria të veçanta:

- i. projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-inanciare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;
- ii. të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;
- iii. të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën, nëse kjo është e domosdoshme, sipas thirrjes përkatëse;
- iv. kërkesa të tjera specifike që mund të jenë të nevojshme për ofrimin e ndihmës juridike parësore, sipas thirrjes publike të veçantë.

7. Dokumentacioni për vërtetimin e plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta depozitohet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e veçanta duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas pikës 6, të këtij vendimi, dhe thirrjes publike. Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve të veçanta, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

8. Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas ngrihet dhe funksionon, me kohë të pjesshme:

- a) Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuar;
- b) Komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit.

9. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) 2 (dy) përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, që mbulojnë çështjet juridike;
- b) 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, që mbulon çështjet e financës dhe buxhetit;
- c) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e të miturve;
- ç) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, që mbulon çështjet e

financës dhe buxhetit.

10. Komisioni i ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, prej të cilëve 1 (një) përfaqësues nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe 2 (dy) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë. Në komisionin e ankimit nuk mund të marrin pjesë anëtarët të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e aplikimeve, në kuadër të komisionit vlerësues.

11. Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit krijohen gjatë kohës që thirrja publike për aplikim është e hapur dhe emrat e anëtarëve nuk bëhen publikë deri para shpalljes së rezultateve të shqyrtimit të ankesave. Në komisione nuk mund të marrin pjesë subjekte që gëzojnë statusin e funksionarit politik.

12. Për të siguruar nevojat administrative dhe mbështetjen organizative për veprimtarinë e komisionit vlerësues dhe të komisionit të ankimit, me urdhër të drejtorit të Ndihmës Juridike Falas, ngrihet sekretariati teknik, i përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

13. Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

14. Komisioni vlerësues shqyrton aplikimet dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe cakton masën financiare përfituese brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e mbylljes së thirrjes publike.

15. Rezultatet e verifikimit publikohen në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, brenda 3 (tri) ditëve nga dita e përfundimit të procesit të shqyrtimit.

16. Vendimi i komisionit vlerësues mund të ankimohet pranë komisionit të ankimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i rezultateve për shkelje të procedurave, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

17. Ankesa shqyrtohet nga komisioni i ankimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes.

18. Komisioni i ankimit nxjerr vendim të arsyetuar për pranimin ose mospranimin e ankesës. Vendimi i arsyetuar i komisionit të ankimit i njoftohet organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka bërë ankimin, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga marrja e vendimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

19. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas lidh kontratën e shërbimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me organizatën jofitimprurëse të autorizuar të përzgjedhur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes.

20. Kontrata e shërbimit lidhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare dhe përmban:

- a) të dhëna lidhur me vlerën e financimit të përfituar;
- b) shtrirjen territoriale të shërbimit të ofruar të ndihmës juridike parësore;
- c) target - grupet e përfituesve të ndihmës juridike të synuar;
- ç) mënyrën dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit;
- d) përcaktime të qarta lidhur me:
 - i. qëllimin e përfitimit financiar dhe ndalimin e përdorimit të vlerës së përfituar për qëllime të tjera jashtë kontekstit të ndihmës juridike parësore;
 - ii. mënyrën e kryerjes së pagesës dhe të transaksioneve financiare nëpërmjet institucioneve bankare, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;
 - iii. shmangien e konfliktit të interesit gjatë përdorimit të masës financiare të përfituar.
- dh) rastet kur kontrata e shërbimit mund të zgjidhet para përfundimit të saj;
- e) mënyrën e kthimit të vlerës financiare në rast të ndërprerjes së kontratës së shërbimit për shkaqe që lidhen me mospërbushjen e detyrimeve nga organizata jofitimprurëse e autorizuar.

21. Çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga organizatat jofitimprurëse.

22. Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përfituese e financimit, raporton pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas periodikisht çdo 3 (tre) muaj mbi përdorimin e fondeve të financuara dhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në kontratën e shërbimit.

23. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen mbikëqyrje nëpërmjet vizitës në terren të paktën 1 (një) herë në vit gjatë kohëzgjatjes së kontratës së shërbimit për të verifikuar standardet e shërbimit të ofruar nga organizata jofitimprurës e autorizuar, përfituese e financimit.

24. Në rast të konstatimit të shkeljes së kontratës së shërbimit nga organizata jofitimprurëse e autorizuar përfituese e financimit, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas verifikon rastin dhe merr masa në raport me shkeljen e kryer, duke urdhëruar deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës së shërbimit dhe revokimin e autorizimit nga ministri i Drejtësisë.

25. Në përfundim të zbatimit të kontratës së shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas harton raportin e monitorimit të përdorimit të fondeve nga organizata jofitimprurëse gjatë periudhës 1-vjeçare. Raporti i monitorimit i përcillet ministrit të Drejtësisë dhe përmban:

- a) të dhënat e organizatës jofitimprurëse të autorizuar që ka përfituar financim;
- b) masën financiare të përfituar;
- c) mënyrën e alokimit të masës financiare të përfituar;
- ç) kohëzgjatjen dhe statusin e zbatimit të kontratës së shërbimit;
- d) shërbimet e ndihmës juridike parësore të ofruara;
- dh) numrin dhe kategorinë e përfituesve të shërbimeve të ofruara;
- e) shtirjen gjeografike/territoriale të shërbimeve të ofruara;
- ë) rezultatet e arritura përmes shërbimeve të ofruara;
- f) ndikimet në përmirësimin e trajtimit të përfituesve nga ndihma juridike parësore e ofruar.

Formati i raportit të monitorimit miratohet me urdhër të drejtorit të Ndhmës Juridike Falas.

26. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I
EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDESKRYEMINISTRI
ERION BRAÇE

Aneks 14

Udhëzim i përbashkët nr. 17, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 9, shkronja “b”, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë,

UDHËZOJNË:

KREU I

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PËRGATITJEN E LISTAVE DHE RENDITJEN E AVOKATËVE NË LISTA

1. Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e rregullave të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore në proceset civile dhe administrative, për çdo vit kalendarik, në përputhje me parimin e rotacionit i cili garanton një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.
2. Thirrja për shprehjen e interesit shpallet në faqen zyrtare të Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë, brenda datës 20 dhjetor të vitit paraardhës. Avokatët paraqesin shprehjen e interesit nëpërmjet plotësimit të formularit të aplikimit, sipas modelit të përcaktuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë. Thirrja përmban afatin, brenda të cilit duhet të dorëzohet shprehja e interesit, adresën postare ose elektronike ku duhet të dorëzohet shprehja e interesit dhe dokumentet përkatëse.
3. Listat e avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike dytësore përgatiten të ndara për çdo dhomë avokatie vendore. Në lista renditen vetëm anëtarët aktivë të dhomës vendore të avokatisë përkatëse.
4. Për organizimin e procedurave të hedhjes së shortit dhe dokumentimin e çdo fazë krijohet një Sekretariat Teknik. Përbërja e Sekretariatit Teknik dhe numri i anëtarëve caktohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.
5. Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, jo më vonë se data 20 janar e çdo viti kalendarik, cakton datën për organizimin e shortit në një ambient të përshtatshëm, dhe njofton paraprakisht Kryetarët e Dhomave Vendore të Avokatisë, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, Ministrinë e Drejtësisë,

Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Njoftimi përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shortit.

6. Mosparaqitja e përfaqësuesve të institucioneve të përcaktuara në pikën 5 të këtij udhëzimi, nuk pezullon procedurat e hedhjes së shortit.

7. Renditja e avokatëve në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore për çdo dhomë kryhet me short. Hedhja e shortit për renditjen e avokatëve i nënshtrohet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të këtij procesi.

8. Shorti organizohet në tre kuti transparente. Në njërin vendosen goglat bosh, në kutinë tjetër vendosen shiritat ku janë shënuar emrat e avokatëve që do të ushtrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore. Në enën e tretë vendosen goglat pasi në to janë futur shiritat me emrat e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike.

9. Radha e futjes së goglave në kuti dhe radha e hedhjes së shortit për çdo dhomë vendore të avokatisë përcaktohet duke filluar me hedhjen e shortit për dhomat vendore që kanë numrin më të madh të avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, ose një përfaqësues i Sekretariatit Teknik i caktuar prej tij, drejton procesin dhe lexon me zë të lartë emrin e avokatit që është i shënuar në të dhe ia tregon Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës. Shiriti i letrës që gjendet brenda saj i dorëzohet Sekretariatit Teknik.

11. Avokati, emri i të cilit është shënuar në shiritin e letrës renditet i pari në listën e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, për dhomën në të cilën është hedhur shorti.

12. Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, të parashikuar në pikën 10, të këtij udhëzimi, caktohet renditja në listë e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, për dhomën në të cilën është hedhur shorti.

13. Rezultatet e shortit dhe renditja e avokatëve që do të ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, për çdo dhomë shpallen nga Kryetari i Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë.

14. Procedura e hedhjes së shortit regjistrohet në audio dhe video. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së organizimit dhe hedhjes së shortit sipas parashikimeve të këtij udhëzimi mbahet procesverbal. Rezultatet e shortit së bashku me një relacion për procesin e organizimit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të

Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

15. Miratimi i listave përfundimtare të avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike dytësore, realizohet nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, brenda datës 1 Shkurt të çdo viti kalendarik, nëpërmjet shortit.

16. Lista e avokatëve për çdo dhomë përmban edhe informacionin mbi specializimin e avokatit në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të përcaktuara në ligj.

17. Pas miratimit përfundimtar të listave, ato përcillen për publikim në faqen zyrtare të DHASH, të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të Drejtorisë së Ndhmës Juridike. Kopje e listave u dërgohet dhomave vendore të avokatisë.

18. Lista e miratuar e avokatëve që do të ofrojnë shërbimet të ndihmës juridike dytësore, sipas dhomave vendore të avokatisë, është e vlefshme deri me 31 janar të vitit pasardhës.

KREU II PROCESI I CAKTIMIT TË AVOKATËVE

19. Dhoma vendore e avokatisë, brenda 8 orëve nga marrja e vendimit të gjykatës për pranimin e kërkesës për dhënie e ndihmës juridike dytësore, cakton një avokat nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në juridiksionin e dhomës, sipas radhës në listë, duke filluar nga avokati i renditur i pari sipas procedurave të shortit. Përzgjedhja e avokatëve me rotacion realizohet në mënyrë të njëpasnjëshme nga lista, duke filluar nga avokati i renditur i pari e me radhë në rend zbritës. Dhoma vendore menjëherë njofton Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas për caktimin e avokatit.

20. Në rast se numri i vendimeve të gjykatave për pranimin e kërkesave për dhënie e ndihmës juridike dytësore është më i madh se numri i avokatëve që ofrojnë këtë shërbim, Dhoma Vendore e Avokatisë cakton avokatët duke rifilluar nga avokati i renditur i pari në listë, e me radhë në rend zbritës.

21. Në rast se shërbimi që do të kryhet kërkon njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj, Dhoma Vendore e Avokatisë cakton avokatin më të parë, të renditur në listë, i cili është i specializuar në fushën e së drejtës përkatëse. Për çdo çështje tjetër që kërkon njohuri të specializuara në të

njëjtën fushë të së drejtës, caktohet avokati i renditur më poshtë në listë, që është i specializuar në atë fushë të së drejtës.

22. Në rast se lista e miratuar e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore nën juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë që kanë njohuri të specializuara, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj, Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë pas njoftimit të marrë nga dhoma vendore cakton, një nga avokatët nga radha e avokatëve që janë të specializuar në fushën e kërkuar nga lista e miratuar e Dhomës Vendore të Avokatisë më të afërt me të. Në këtë rast, për caktimin e avokatit njoftohet edhe Dhoma Vendore e Avokatisë që ka nën juridiksion avokatin.

23. Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë kryen trajnime të posaçme për avokatët në ato fusha ku specializimi është i nevojshëm, në rast se lista e miratuar e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, nën juridiksionin e një dhome, nuk ka avokatë me njohuri të specializuara.

24. Dhoma Vendore e Avokatisë i cakton avokatët nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore nën juridiksionin e dhomës, sipas radhës në listë, sipas parashikimeve të pikës 19 dhe 20, të këtij udhëzimi. Për çështjet që kërkojnë njohuri të specializuara avokatët caktohen sipas parashikimeve të pikave 21 dhe 22, të këtij udhëzimi.

25. Dhoma Vendore e Avokatisë kontakton me telefon dhe nëpërmjet postës elektronike me avokatin e caktuar në detyrë, sipas radhës në listë. Në rast se avokati pas njoftimit të tij, refuzon marrjen përsipër të detyrës, vijohet me kontaktimin e avokatit të radhës në listë. Refuzimi për marrjen përsipër të detyrës kryhet nga avokati me shkrim, duke përcaktuar edhe shkaqet e refuzimit.

26. Në rast se avokati nuk i përgjigjet telefonatës/postës elektronike, atij i lihet një kohë e arsyeshme, por në çdo rast jo më shumë se 24 orë, për të kthyer përgjigje. Në rast të mos kthimit të telefonatës/postës elektronike dhoma vendore e avokatisë, telefonon menjëherë avokatin e radhës në listë.

27. Me marrjen e konfirmimit nga avokati sipas procedurës së mësipërme, dhoma vendore e avokatisë merr vendim për caktimin e avokatit. Format i vendimit për caktimin e avokatit bëhet sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

28. Për dokumentimin e çdo faze të procedurës së njoftimit të avokatit të caktuar në detyrë, sipas radhës në listë, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari

i Dhomës Vendore të Avokatisë si dhe nëpunësi i Dhomës përgjegjës për njoftimin e avokatëve të caktuar në detyrë.

29. Dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit edhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

30. Nëse avokati i caktuar për të ofruar ndihmën juridike ka pengesa ligjore sipas parashikimeve të nenit 9, të ligjit nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i drejtohet me një kërkesë të arsyetuar dhomës vendore të avokatisë.

31. Nëse dhoma vendore e avokatisë vlerëson se kërkesa përmban shkaqe të arsyeshme, bën zëvendësimin e avokatit që ka hequr dorë nga përfaqësimi duke njoftuar menjëherë Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. Avokati zëvendësues caktohet referuar numrit të parë të lirë në listën e avokatëve.

32. Kur dhoma vendore e avokatisë e vlerëson kërkesën të pabazuar, refuzon zëvendësimin e avokatit. Në rast se avokati refuzon përsëri të ndjekë çështjen, dhoma vendore e avokatisë fillon procedurën e zëvendësimit dhe njofton Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për fillimin e procedimit disiplinor.

33. Avokati do të vazhdojë të qëndrojë në detyrë derisa ai të zëvendësohet me një avokat tjetër nga dhoma vendore e avokatisë.

KREU III DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

34. Dhoma e Avokatisë të Shqipërisë mbikëqyr zbatimin e parimit të rotacionit nga dhomat vendore të avokatisë.

35. Dhomat vendore të avokatisë mbajnë regjistër me të dhënat e ofrimit të ndihmës juridike dytësore sipas formateve të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.

36. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, dhomat vendore të avokatisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)

**KRYETARI I DHOMËS SË
AVOKATISË TË SHQIPËRISË**

Maksim Haxhia

SHTOJCA Nr.1
(Formati i vendimit për caktimin e avokatit)

DHOMA VENDORE E AVOKATISË _____

NR. _____ VENDIMI

DATA __.__.__

VENDIM

Në _____ sot, më datë __.__.20__, unë _____, përfaqësues për ndihmën juridike pranë Dhomës së Avokatisë _____, pasi u njoha me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____ nr.____, datë _____, konstatova se kërkuesi _____ në bazë të vendimit është përfitues i ndihmës juridike dytësore.

Në mbështetje të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe në bazë të Udhëzimit nr.____, datë _____, “Për Rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike”:

VENDOSA

- Caktimin e avokatit _____, me nr. licence _____ për të ofruar shërbimin juridik për kërkuesin _____, sipas vendimit të gjykatës, bashkangjitur këtij vendimi.
- Një kopje e vendimit do ti dërgohet avokatit të caktuar dhe një kopje kërkuesit.

Përfaqësuesi

Aneks 15

Udhëzim i përbashkët nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 7 shkronja “g”, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë,

U D H Ë Z O J N Ë:

I. Objekti

Ky udhëzim përcakton kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore, në përputhje me ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

II. Kriteret e shpërblimit për shërbimin e ofruar nga avokati

1. Me përfundimin e procedurave të dhënies së ndihmës juridike, avokati duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas formularin për shpërblimin për ndihmën e ofruar në përputhje me kontratën vjetore të lidhur midis avokatit dhe kësaj Drejtorie.
2. Formulari për shpërblimin për ndihmën juridike shoqërohet me:
 - a) faturën tatimore të shërbimit të ofruar;
 - b) kopje të vendimit të gjykatave të dhëna për çështjen ose kopje të akteve të tjera të përpiluara sipas Shtojcës 1;
 - c) raportin për përfundimin e punës sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.
3. Pagesa e shërbimit bëhet përmes llogarisë bankare dhe sipas kushteve të vendosura në kontratën tip të miratuar, siç përcaktohet në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
4. Në rast se avokati heq dorë nga dhënia e ndihmës juridike dytësore, atij nuk i takon shpërblim për shërbimin e dhënë, sipas kontratës vjetore shërbimi të lidhur me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, përcaktuar në nenin 24, pika 1, shkronja “b”, të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike

të garantuar nga shteti". Në çdo rast, dhoma vendore menjëherë njofton Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

5. Në rastet e heqjes dorë për raste të ndryshme nga ato të parashikuara në pikën 4, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas njofton Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë për vlerësimin e inicimit të një procedimi disiplinor.

III. Tarifat e shpërblimit

Masa e shpërblimit për ndihmën juridike dytësore të ofruar nga avokati, përcaktohet në Shtojcën 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

IV. Kompensimi i shpenzimeve

Avokati ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për shërbimin juridik të kryer. Kompensimi i shpenzimeve bëhet në përputhje me legjislacioni në fuqi "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit".

V. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike në varësi të Ministrisë së Drejtësisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTRI

Anila Denaj

SHTOJCA 1
TARIFAT E SHËRBIMEVE JURIDIKE TË AVOKATËVE TË
NDIHMËS JURIDIKE

Lloji i shërbimit


Tarifa në lekë

	<u>I. MBROJTJA JURIDIKE NË FUSHËN PENALE</u>	Tarifat
	-	
1	<u>Përfaqësimi në çështjet penale</u>	
	= Shërbim për ndalimet dhe arrestimet deri në dhënien dhe ndryshimin e masës së sigurimit	15,000
2	<u>Ndihmë juridike për hetimet paraprake deri në dërgimin e çështjes për gjykim</u>	
	= Për kundërvajtjet penale	20,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim deri 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	50,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	60.000
3	<u>Ndihmë juridike për gjykimet në shkallë të parë</u>	
	= Për kundërvajtjet penale	20,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim deri 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	30,000
	= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	80,000
	= Për krimet që gjykohen në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	96.000
4	<u>Ndihmë juridike për gjykimet në gjykatat e apelit dhe ajo e Lartë dhe Kushtetuese</u>	
	= Për gjykimet në gjykatat e Apelit	40,000
	= Për gjykimet në gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese	50,000

	<u>II. MBROJTJA JURIDIKE NE FUSHEN CIVILE DHE ADMINISTRATIVE</u>	
1	<u>Përfaqësimi në Shkallë të Parë</u>	
	= Përfaqësimi në shkallë të parë, pa palë	15,000
	= Përfaqësimi në shkallë të parë, me pale	40,000
2	<u>Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit, atë të Lartë dhe Kushtetuese</u>	
	= Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit	45,000
	= Përfaqësimi në Gjykatën Lartë dhe Kushtetuese	60,000
3	<u>Shërbime juridike jashtëgjyqësore</u>	
	= Përgatitje kërkesa ankimore	15,000
	= Përgatitje rekursi për në GJ. Lartë si dhe kërkesë në GJ. Kushtetuese	25,000
	= Ofrim ndihmë juridike në formë këshillimi	500-1500 lek/ora
	<u>III. TË TJERA SHËRBIME AVOKATIE</u>	
	<u>Të tjera shërbime avokatie që mund të mos jenë përfshirë në zërat e mësipërm</u>	



FINANCUAR
NGA BASHKIMI EVROPIAN



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS



Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
Rr. Barrikadave, Nd. 18
Hyrja 6, Zyra nr. 10 - ||| Tiranë
dnjf@drejtesia.gov.al
www.ndihmajuridike.gov.al